




# STUDIM MBI AKSESIN NË DREJTËSI NË SHQIPËRI



*Empowered lives.  
Resilient nations.*





**STUDIM MBI  
AKSESIN NË  
DREJTËSI NË  
SHQIPËRI**

## **AUTOR**

Dr. Sinisa Milatovic

## **EKIPI KËRKIMOR DHE KONTRIBUESIT**

Instrumentet kërkimore u krijuan nga Dr. Sinisa Milatovic, Dr. Marsela Dauti, Agustela Nini-Pavli, Dr. Arta Vorpsi, Gent Ibrahimimi dhe Manuela Murthi.

Komponenti cilësor i studimit u realizua nga Dr. Marsela Dauti, Agustela Nini-Pavli, Dr. Arta Vorpsi, Gent Ibrahimimi dhe Manuela Murthi.

Komponenti sasior i studimit u mbikëqyr nga Manuela Murthi dhe Blerina Balilaj dhe u realizua nga Era Zizo, Erol Zguro, Jonida Ukperaj, Ina Luli, Ramazan Kola, Dorentina Hysa, Bekim Alija, Elsa Dautaj, Klejn Ngracani, Sokol Baki, Klodi Peshkatari, Erjeta Dobi dhe Leonat Luli.

Drejtuese e punës kërkimore ishte Dr. Edlira Papavangjeli, e cila ofroi sugjerime editoriale dhe kontribute të rëndësishme në lidhje me përmbajtjen.

## **FAQOSJA DHE DIZAJNI GRAFIK**

Henrik Lezi

## **PËRKTHIMI NË GJUHËN SHQIPE**

Majlinda Nishku

## **FALËNDERIME**

Studimi "Aksesi në Drejtësi në Shqipëri" ka pasur mbështetjen e Qendrës Rajonale të PNUD-it në Stamboll, në veçanti nga Isabelle Tschan dhe Ainura Bekkoenova. Ai ka përfituar shumë edhe nga mbështetja e shumë prej organizatave partnere të PNUD-it në Shqipëri, si dhe përfaqësues të insitucioneve të ndryshme dhe individë ndër të cilët Qendra Komunitare, Selitë, Tiranë; Lëvizja Rinore, Rome dhe Egjiptiane, Elbasan; Sidita Zaja (UNDP), Tiranë; Marsida Çela, Strehë LGBT, Tiranë; Ferdiola Tare, Romina Sefa, dhe Bradi Xhavara, Fondacioni Soros, Tiranë; Ines Leskaj dhe Irena Shtraza, Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, Tiranë; Kristi Pinderi, PRO LGBT, Tiranë; Xheni Karaj dhe Juni Plaku, Aleanca kundër Diskriminimit të LGBT, Tiranë; Violeta Neziri dhe Luljeta Alibali, Hapa të Lehtë, Shkodër; Kristi Kola, Atila Deda, dhe Fabjola Thana, Gruaja tek Gruaja, Shkodër; Suela Lala, aktiviste e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara; Florjan Rojba, Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë; Siditia Fortuzi, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara; Ledia Muraku, Avokate; Aurela Bozo dhe Iris Aliaj, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare; Dorian Matlija, ResPublica; Ermir Kapedani dhe Mimoza Morina, Zyra e Avokatit të Popullit; Irma Baraku, Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Ornela Naqellari, Gjykata e Rrethit Lezhë; Valbona Durraj, Gjykata Administrative Shkodër; personeli i Institucionit Rezidencial të Përkujdesjes për Fëmijë, Shkodër; personeli i Institucionit Rezidencial të Përkujdesit për Fëmijë, Tiranë; Jeta Xhabija, Bashkia Shkodër;

Së fundi, ky studim u bë i mundur përmes mbështetjes së Dolores Karriqi Petritaj (PNUD).

Dëshirojmë të falënderojmë të gjithë personat që iu përgjigjën pyetësorit në komponentin sasior, si dhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë në studim, të cilët dhanë kohën e tyre për të ndarë me ne historitë dhe përvojat e tyre.

## **MOHIM PËRGJEGJËSIE**

Ky studim u krye me porosi të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Shqipëri dhe u mbështet nga UNDP RBEC Catalytic and Scaling-up Facility (Instrumenti Lehtësues i Katalizimit dhe Përshkallëzimit të Zyrës Rajonale të Evropës dhe Komonuelthit të Vendeve të Pavarura) dhe u financua nga qeveria e Turqisë. Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë vetëm të autorit dhe të kontribuesve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimin zyrtar të PNUD-it në Shqipëri.

# Pasqyra e Lëndës

<b>Shkurtesat</b>	<b>6</b>
<b>Përmbledhje ekzekutive</b>	<b>7</b>
<b>Hyrje</b>	<b>10</b>
<b>1. Njohuritë dhe njohja e ligjit dhe opinionet mbi drejtësinë</b>	<b>16</b>
<b>2. Niveli i besimit në sistemin e drejtësisë</b>	<b>28</b>
<b>3. Klasifikimi i mosmarrëveshjeve të qytetarëve</b>	<b>34</b>
<b>4. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe sistemi i drejtësisë</b>	<b>40</b>
4.1 Faza e parë	43
4.2 Faza e dytë	59
4.3 Faza e tretë	70
4.4 Rezultatet përfundimtare	73
4.5 Përmbledhje e trajektoreve të ndjekura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve	76
<b>5. Aksesit në drejtësi për grupet e pafavorizuara</b>	<b>78</b>
5.1 Popullata LGBTI	80
5.2 Personat me aftësi të kufizuara	83
5.3 Viktimat e dhunës në familje	86
5.4 Fëmijët në institucione rezidenciale	89
<b>6. Gjetjet kryesore</b>	<b>92</b>
<b>7. Rekomandime</b>	<b>98</b>
<b>Shtojca 1 – Metodologjia</b>	<b>104</b>

# SHKURTESAT

**ANAD** – Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë

**AWEN** – Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

**FSHDKPAK** – Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

**KDKPAK** – Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

**LGBTI** - Lesbike, Gej, Biseksual, Trans, dhe/ose Interseks

**OJQ** – Organizatë jo qeveritare

**PNUD** – Program për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

**QNLO** – Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në Shqipëri nevojat për drejtësi janë të mëdha dhe ato mbeten përgjithësisht të paplotësuara. Në bazë të studimit tonë, i përbërë nga një pyetësor i cili iu shpërnda 1758 personave (dhe nga intervistat dhe grupet e fokusit), kemi arritur në përfundimin se pothuaj gjysma e popullatës ka pasur probleme ligjore gjatë pesë viteve të fundit dhe se, në pjesën më të madhe, këto probleme kanë mbetur të pazgjidhura për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit ligjor të shoqërisë dhe performancës së ulët të institucioneve në sektorin e drejtësisë. Kjo është sidomos e vërtetë për anëtarët e grupeve të pafavorizuara, si të varfrit, personat me nivel të ulët arsimor, romët, anëtarët e komunitetit LGBTI, viktimat e dhunës në familje, e të tjerë. Megjithatë, popullata shqiptare ka arsye të shpresojë se në të ardhmen aksesimi në drejtësi do të mund të rritet dhe do t'i përgjigjet nevojave të tyre për drejtësi. Kjo nisur nga fakti që shumë prej mosmarrëveshjeve nuk janë të kushtueshme për t'u zgjidhur, rezultatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve në gjykata janë pak a shumë të drejta, si dhe përmirësimeve të kohëve të fundit në legjislacion.

## KËRKESAT PËR AKSES NË DREJTËSI JANË MJAFT TË MËDHA

**Pothuaj gjysma e popullatës (48,7%) ka pasur probleme ligjore gjatë pesë viteve të fundit.** Mosmarrëveshjet shpesh kanë në qendër çështje të pronave, truallit ose tokës, si dhe përfitimet sociale. Personat me më shumë mosmarrëveshje janë zakonisht meshkuj dhe anëtarë të komunitetit rom, ndërsa banorët e zonave rurale kanë më pak mosmarrëveshje se sa banorët e Tiranës dhe të zonave të tjera urbane. Pjesa më e madhe e mosmarrëveshjeve të qytetarëve kanë si palë kundërshtarë, ose kanë të bëjnë, me shtetin.

Rezultatet e studimit nxjerrin në pah **kërkesën e madhe për akses në drejtësi nga individët në Shqipëri.** Nisur nga fakti që pothuaj gjysma e popullatës kanë pasur nevoja lidhur me drejtësinë këto pesë vitet e fundit, ekziston nevoja për një sistem drejtësie të drejtë e të paanshëm që t'u përgjigjet këtyre nevojave.

### Njohuri të kufizuara dhe qëndrime të diskutueshme

**Individët kanë nivel mjaft të ulët njohurie për të drejtat e tyre:** më se një e katërta e personave të anketuar nuk ishin në gjendje të përmendnin emrin e asnjë prej të drejtave dhe lirive kushtetuese. Po kështu, ka mangësi njohurish për sa i përket të drejtave të grave, si dhe të drejtave të personave LGBTI dhe grupeve të tjera të pafavorizuara. Për shembull, pak më shumë se një e treta e personave të anketuar janë të mendimit se një grua e martuar që ka marrë pajë nuk ka të drejtë trashëgimie nga prindërit e saj pas martese. **Niveli i ulët i njohjes dhe njohurive ligjore është më i theksuar në radhët e popullatës rome, personat me nivel arsimor të ulët, dhe nivel të ardhurash më të ulta.**

**Përveç mungesës së njohurive dhe njohjes së ligjit, opinionet e personave të anketuar mbi drejtësinë përfshijnë disa qëndrime të diskutueshme.** Toleranca ndaj korrupsionit është e rrënjësuar mjaft thellë, po kështu edhe toleranca ndaj dhunës në familje, me 22,5% e personave të anketuar që besonin se “i takon bashkëshortit të dispijnojë bashkëshorten e tij”. Po kështu, një pakicë relativisht e madhe në numër mendojnë se është e pranueshme që anëtarët e komunitetit LGBTI të diskriminohen, ngaqë besojnë se punëdhënësi duhet të jetë në gjendje ta pushojnë nga puna një homoseksual/homoseksuale në qoftë se nuk ndihet rehat me të.

**Pothuaj tri të katërtat e popullatës besojnë se sistemi shqiptar i drejtësisë nuk i mbron të drejtat e tyre.** Arsyeja kryesore për këtë mungesë besimi – që u përmend nga pothuaj gjysma e personave të anketuar – është korrupsioni në sistemin e

drejtësisë. Është shqetësuese që personat të cilët kanë pasur përvoja me sistemin e drejtësisë, kanë shumë më pak gjasa të besojnë se ai i mbron të drejtat e tyre, krahasuar me personat që nuk kanë pasur kontakt me të gjatë pesë viteve të fundit.

**Këta tre faktorë – mungesa e njohurive për ligjin, qëndrimet e dyshimta ndaj drejtësisë, dhe mungesa e besimit në sistemin e drejtësisë – paraqesin një pamje të brishtë të aksesit në drejtësi në Shqipëri.**

## **Performanca në nivelin e duhur e sistemit të drejtësisë**

Kjo kornizë dobësohet më tej nga paraqitja e dobët e institucioneve të sektorit të drejtësisë në Shqipëri; në këtë studim me këto kuptohen të gjitha institucionet, si qeveria vendore, gjykatat, policia, dhe organe të tjera, që kanë një rol për të luajtur në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ligjore të qytetarëve. Në fakt, **performanca në nivelin e duhur e institucioneve të sektorit të drejtësisë është ndoshta pengesa madhore ndaj aksesit në drejtësi në Shqipëri.**

Ky përfundim vërtetohet edhe nga shifrat. Për shembull, vetëm pak më shumë se një e pesta (21,8%) e personave të anketuar kishin arritur t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre ligjore, ndërsa pak më pak se gjysma (43%) e të anketuarve mendonin se rezultati ishte *shumë* i padrejtë.

Performanca në nivelin e duhur ulët e institucioneve në ofrimin e aksesit në drejtësi manifestohet në një varg mënyrash të ndryshme. Së pari, punonjësit dhe institucionet në sistemin e drejtësisë kanë aftësi të dobëta komunikuese, nuk ndërveprojnë në mënyrë të hapur me qytetarët që kërkojnë drejtësi, dhe nuk i respektojnë ata – sidomos në organet e qeverisjes vendore dhe qendrore. Së dyti, qytetarët mendojnë se në sistemin e drejtësisë mungon drejtësia dhe paanshmëria, si në proces, ashtu edhe në rezultat. Së treti, ndonëse gjykatat dhe avokatët ofrojnë shërbime me cilësi më të lartë, shumë individë nuk arrijnë të kenë akses në to për shkak të shpenzimeve më të mëdha. Dhe së katërti, aksesit në drejtësi kërkon shumë kohë.

## **Grupet e pafavorizuara**

**Disa grupe të pafavorizuara e kanë edhe më të vështirë të kenë akses në drejtësi dhe t'i zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë të drejtë.** Në këto grupe përfshihen romët, personat me të ardhura të ulta, ata me nivel arsimor të ulët, anëtarët e komunitetit LGBTI, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje, dhe fëmijët në institucione rezidenciale.

Këto grupe përballen me pengesa të shumëllojshme, të cilat ua bëjnë aksesin në drejtësi edhe më të vështirë se sa pjesës tjetër të qytetarëve shqiptarë. Shumë prej tyre, si romët, personat me aftësi të kufizuara, personat nga komuniteti LGBTI dhe të tjerë, janë viktimat e një diskriminimi të përhapur. Ndodh shpesh që këta persona janë edhe në gjendje të vështirë ekonomike, çka i pengon të kenë akses në shërbime më cilësore. Si pasojë, disa prej tyre as nuk marrin mundimin t'u drejtohen institucioneve, duke i lënë çështjet e tyre ligjore të pazgjidhura. Për më tepër, këta persona shpesh kanë njohuri më të kufizuara mbi ligjin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë se sa njerëzit e tjerë, çka i bën të mos kenë mundësi të gëzojnë të drejtat e tyre.

## **Përparimi në të ardhmen**

Ndonëse rezultatet e studimit ilustrojnë pengesat me të cilat përballen qytetarët lidhur me aksesin në drejtësi, ato tregojnë gjithashtu se ka pasur edhe arritje të cilat mund të shërbejnë si themele për ecjen përpara në të ardhmen.

**Aksesi në drejtësi duhet të përmirësohet përmes një vargu masash të ndryshme**

**Së pari, duhet të prezantohet ndihma juridike falas, ndërmjetësimi dhe mekanizma të tjerë, në mënyrë që këshillimi ligjor dhe gjykatat të bëhen më të aksesueshme.** Rezultatet tregojnë se gjykatat dhe avokatët ofrojnë procese dhe rezultate më të drejta se sa institucionet e tjera të drejtësisë. Problemi kryesor është se ato janë më pak të aksesueshme dhe më të kushtueshme se institucionet e tjera, gjë që mund të korrigjohet më së miri përmes krijimit të një sistemi funksional të ndihmës juridike. Sistemi duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që të marrë parasysh rezultatet e këtij studimi: për shembull, ai duhet



të pasqyrojë faktin se shumica e njerëzve duan t'i zgjidhin mosmarrëveshjet që kanë jashtë gjykatës, se ata u drejtohen në fillim institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore, se mosmarrëveshjet e tyre përgjithësisht nuk kushtojnë shumë për t'u zgjidhur, dhe se kryesisht janë çështje që lidhen me pronat ose truallin/tokën. Sistemi i ri i ndihmës juridike duhet të ketë dispozita të veçanta për t'i shtrirë shërbimet tek qytetarët që nuk zotërojnë njohuritë ose mjetet e nevojshme për t'iu drejtuar vetë sistemit: të tilla mund të jenë masat për ndërgjegjësim dhe informim të qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve lëvizëse, caktimi i orareve kur njerëzit nga komunitetet e zonave të thella mund të vinë në zyra për t'u këshilluar, dhe shërbimet telefonike dhe në internet për t'u lidhur me personat me të ardhura më të ulta dhe me nivel arsimor më të ulët. Ekzistenca e një sistemi dhe strukture ndërmjetësimi do të plotësonte nevojat për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve.

Në krijimin e këtyre mekanizmave shteti duhet të bashkëpunojë me organizatat e shoqërisë civile që kanë arritur suksese në këtë fushë. Përveç këshillimit ligjor, edhe përfaqësimi ligjor dhe aksesit në gjykata duhet të bëhen më të arritshëm përmes vendosjes së tarifave më të ulta gjyqësore dhe për ekspertët, përshtatjeve në infrastrukturë, vënies në dispozicion të përkthyesve në gjuhën e shenjave, dhe një vargu masash të tjera.

### **Së dyti, duhet të prezantohen masa të veçanta për të përmirësuar aksesin në drejtësi për grupet e pafavorizuara.**

Përpjekjet për reformë duhet të përqendrohen në korigjimin e një prej problemeve më madhore të identifikuar në këtë studim, përmes rritjes së ndërgjegjësimit të nëpunësve të qeverisjes vendore, punonjësve të policisë dhe aktorëve të ndryshëm në sistemin e drejtësisë për të drejtat e personave LGBTI, personave me aftësi të kufizuara, viktimave të dhunës në familje dhe grupeve të tjera të pafavorizuara. Përpjekjet duhet të përqendrohen gjithashtu edhe në plotësimin e mangësive legislative, duke harmonizuar legjislacionin shqiptar me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për çështje si të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe dhuna në familje.

### **Së treti, duhen bërë përmirësime për të rritur njohuritë ligjore të popullatës dhe nivelin e shërbimeve në sistemin e drejtësisë.**

Gjetjet e këtij studimi vënë në pah nevojën për rritjen e nivelit të njohurive dhe njohjes së ligjit si dhe të mënyrës së funksionimit të sistemit të drejtësisë nga ana e popullatës. Programe të tilla duhet të përfshijnë nxitjen e të drejtave të grupeve të pafavorizuara, jo vetëm thjesht brenda këtyre grupeve, por edhe në të gjithë popullatën në tërësi, sepse rezultatet tregojnë për qëndrime diskriminuese ndaj personave LGBTI, grave dhe pakicave kombëtare, çka përbën shqetësim. Kjo lidhet me nevojën për përmirësim të nivelit të shërbimeve që i ofrojnë nëpunësit e sektorit të drejtësisë popullatës në tërësi dhe grupeve të pafavorizuara në veçanti, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre.

### **Së katërti, aktorët e sektorit të drejtësisë duhet të jenë novatorë dhe shkencorë në qasjen e tyre.**

Është e domosdoshme që përpjekjet e reformës të testohen dhe të maten përpara se të përhapen në shkallë vendi; po kështu, përpjekjet të cilat janë provuar se kanë pasur sukses – si linjat telefonike të ndihmës, klinikat lëvizëse, dhe veprimtaritë pranë qytetarëve – duhet të huazohen gjerësisht gjatë reformës.

– HYRJE –

# FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI I STUDIMIT

Ky raport paraqet rezultatet e një studimi të kryer në vitin 2017, i cili shqyrtoi aksesin në drejtësi në Shqipëri. Qëllimi i studimit ishte të eksploronte dhe maste nevojat dhe përvojat e shqiptarëve me aksesin në drejtësi. Për ta bërë këtë, studimi u përqendrua në katër aspekte kyçe të aksesit në drejtësi në Shqipëri.



**Aspekti i parë shqyrton njohuritë dhe njohjen e ligjit dhe opinionet mbi drejtësinë:** popullatës iu bënë pyetje për të kuptuar se sa mirë i njihin dispozitat kryesore ligjore dhe se çfarë kërkon drejtësia për sa i përket të drejtave të qytetarëve. Këto krijojnë bazën për të kuptuar se si i qasen individët problemeve të tyre që lidhen me drejtësinë.

**Aspekti i dytë ka të bëjë me nevojat e popullatës shqiptare në fushën e drejtësisë.** Studimi përcaktoi mosmarrëveshjet e popullatës shqiptare dhe i klasifikoi ato sipas temës dhe palës kundërshtare.

**Aspekti i tretë ka të bëjë me përvojat e personave të anketuar me aksesin në drejtësi.** Studimi shqyrton proceset e marrjes së vendimeve nga qytetarët e zakonshëm në përpjekje për të gjetur zgjidhje për mosmarrëveshjet dhe çështjet e tyre ligjore. Të tilla përvoja mund të jenë, për shembull, dorëzimi i një kërkesë pranë organeve vendore për marrjen e lejes së ndërtimit, bërja e një denoncimi penal në polici për ngacmim, kërkimi i këshillave nga një mik ose jurist lidhur me të drejtat e punës dhe punësimit, ose hedhja në gjyq e një fqinji. Studimi përqendrohet në atë se sa **të drejta, respektuese dhe transparente** ishin këto përvoja me institucionet dhe personat në sistemin e drejtësisë. Gjithashtu, ai shqyrton edhe **koston, kohëzgjatjen, dhe efikasitetin** e këtyre përpjekjeve. Së fundi, ai shqyrton edhe nëse **rezultatet e trajektoreve të ndjekura për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve** ishin **të drejta**, nëse qytetarët **kishin mbetur të kënaqur**, dhe nëse vendimet e marra ishin **vënë në zbatim**.

Për tri aspektet e para matjet u bënë me anë të një pyetësoi i cili iu shpërnda një kampioni të madh përfaqësues të popullatës shqiptare. Megjithëse nga pyetësoi dolën rezultate domethënëse dhe të hollësishme, të cilat nxjerrin në pah pengesat kryesore ndaj aksesit në drejtësi në Shqipëri, në shoqërinë shqiptare ka edhe disa grupe të caktuara përvojat e të cilave nuk ky studim nuk arrin t'i ngërthejë – ose sepse grupet janë shumë të vogla, ose sepse është shumë e vështirë që përvojat e tyre të regjistrohen në këtë mënyrë.

Si rrjedhojë, **aspekti i katërt lidhet me përvojat e veçanta të disa grupeve të caktuara të pafavorizuara, si popullata LGBT, viktimat e dhunës në familje, të miturit në konflikt me ligjin, komunitetet rome dhe egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara, dhe grupe të tjera.** Identiteti i anëtarëve të këtyre grupeve, si dhe kushtet apo rrethanat e jetës së tyre, i bëjnë ata të përballen me disa kufizime dhe vështirësi të ndryshme nga ato të pjesës tjetër të popullatës, në përpjekjet e tyre për të pasur akses në drejtësi. Si rrjedhim, studimi i kushtoi vëmendje të veçantë përvojave të tyre me aksesin në drejtësi. Për ta bërë këtë, studimi përdori metoda të tjera kërkimore, si intervistat dhe grupet e fokusit.

## **Çështjet kyçe dhe grupet kryesore**

**Identifikimi i çështjeve kyçe dhe i grupeve kryesore të pafavorizuara lidhur me aksesin në drejtësi në shoqërinë shqiptare ishte një proces i dyfishtë:** nga njëra anë, **këto çështje**

# PËRBËRJA

KOMPONENTI SASIOR I STUDIMIT

## 1758

PERSONA TË MOSHËS 16 VJEÇ E LART, U INTERVISTUAN GJITHSEJ GJATË PERIUDHËS NDËRMJET MARSIT DHE MAJIT 2017




## 50.3%


ISHIN NGA ZONAT RURALE

## 49.7%


ISHIN NGA ZONAT URBANE



## ARSIMIMI



## PUNËSIMI



## 13.6%

DEKLARUAN SE I PËRKISIN NJË GRUPI TË PAKICAVE

## 75.6%

E PERSONAVE TË ANKETUAR ISHIN TË MARTUAR

**u gjeneruan nga pyetësi i përmendur më lart**, pra nga poshtë-lart. Kjo bëri të mundur që rezultatet të pasqyronin nevojat e vërteta për drejtësi, mosmarrëveshjet dhe ankesat e qytetarëve, edhe pse këto rrallë mund të kishin qenë objekt shqyrtimi gjyqësor. Pra, pyetësi u hartua në mënyrë të tillë që të gjeneronte në mënyrë të hapur nevojat për drejtësi dhe trajektoren e ndjekur nga qytetarët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

**Nga ana tjetër**, siç u përmend më lart, ishte e nevojshme të nxirrej në pah gjendja e vështirë e disa grupeve të pafavorizuara, e cila nuk mund të trajtohej nga studimi sasior (i administruar në formën e pyetësorit). Për ta bërë këtë, **ekipi kërkimor identifikoi grupet e pafavorizuara tek të cilat do të përqendrohej komponentit cilësor i studimit**. Në to u përfshinë grupe çështjet e të cilave nuk mund të ngërtheheshin në mënyrë të besueshme nga studimi sasior, për shkak të madhësisë së tyre të vogël (si personat me aftësi të kufizuara); për shkak se anëtarët e tyre mund të ngurrojnë t'ia tregojnë përvojat e tyre një anketuesi anonim (si popullata LGBT ose viktimat e dhunës në familje) si dhe grupe tek të cilat është e vështirë të arrihet përmes një studimi me bazë familjen (si fëmijët në institucione rezidenciale, ose të miturit në konflikt me ligjin). Për të bërë një portretizim gjithëpërfshirës të vështirësive të hasura nga këto grupe lidhur me aksesin në drejtësi, në kuadrin e studimit u zhvilluan edhe intervista me ofrues të shërbimeve të drejtësisë, si me gjykatës, juristë, dhe të tjerë.

## VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI METODOLOGJINË

Përmes kombinimit të metodave cilësore dhe sasore, studimi bëri të mundur kryerjen e një analize të gjerë e të thelluar mbi aksesin në drejtësi dhe çështjet që lidhen me të. Komponentët sasiorë dhe cilësorë të studimit, që plotësonin njëri-tjetrin, prodhuan gjetjet e paraqitura në këtë raport. Për një përshkrim të plotë të metodologjisë, ju lutem shihni Shtojcën 1.

## Përbërja e kampionit të komponentit sasior të studimit

- Gjatë periudhës ndërmjet marsit dhe majit 2017 u intervistuan gjithsej 1758 persona të moshës 16 vjeç e lart.

- Personat e intervistuar ishin nga zonat e Tiranës, Shkodrës, Vlorës, Përmetit dhe Matit. 595 persona të anketuar (33,8%) ishin nga Tirana, 575 nga Shkodra dhe Vlora (32,7%) dhe 588 nga Përmeti dhe Mati (33,4%). Nga ky numër, 874 (49,7%) ishin nga zonat urbane dhe (50,3%) nga zonat rurale.

- 896 (51,1%) e të anketuarve ishin burra dhe 854 (48,7%) gra.

- Grupmosha më e përfaqësuar ishte ajo e personave 45 deri 54 vjeç (22,8%), ndjekur me radhë nga grupmosha 55 deri 64 (21,6%), grupmosha 35-44 vjeç (15,9%), grupmosha 65 vjeç e lart (14,9%), grupmosha 25-34 vjeç (13,6%), grupmosha 18-24 vjeç (10,3%) dhe grupmosha 16 dhe 17 vjeç (0,7%).

- Pothuaj një në shtatë të anketuar (13,6%) deklaruan se i përkisnin një grupi të pakicave. Nga

këta, 6% thanë se ishin anëtarë të komunitetit rom, 1,3% thanë se ishin egjiptianë, dhe 6,3% që u përkisnin pakicave të tjera.

- Kualifikimi arsimor më i zakonshëm ndër personat e anketuar (39,4%) ishte përfundimi i shkollës së mesme; 27,1% kishin përfunduar arsimin fillor; 17,3% kishin përfunduar arsimin të lartë; 8,2% kishin diploma ose certifikata të formimit profesional; 5,7% nuk kishin përfunduar arsimin fillor; dhe 1,6% kishin kryer studime pasuniversitare.

- Pothuaj dy ndër pesë pjesëmarrës thanë se ishin në marrëdhënie pune, nga të cilët 21% u deklaruan si të vetëpunësuar, 12,3% punonin në sektorin privat dhe 6,4% në sektorin publik. Pjesa tjetër e popullatës së anketuar në këtë studim ishte ose e papunë por në kërkim të një vendi pune (25,8%); ose ekonomikisht jo-aktive, sepse nuk po kërkonin aktivisht një vend pune (23,7%); ose gra shtëpiake (10,2%).

- Pjesa mbizotëruese e personave të anketuar ishin të martuar/a (75,6%), ndërsa më pak se një ndër gjashtë persona (15,6%) ishin beqarë/e, 5,4% ishin të ve/veja, 2,1% të divorcuar/a dhe 1% në marrëdhënie bashkëjetese.

- Shumica e të anketuarve në studim (59,6%) nuk kishin fëmijë, 20% kishin një fëmijë, 15,8% kishin dy fëmijë, dhe vetëm 3,2% kishin tre ose më shumë fëmijë.

- Më shumë se një ndër dhjetë personat e intervistuar përfitonin ndihma nga shteti, nga të cilët 6,5% përfitonin ndihmë ekonomike dhe 4% merrnin pagesa të aftësisë së kufizuar.

## **Përbërja e kampionit të komponentit cilësor të studimit**

- Në **grupet e fokusit**, që u zhvilluan në periudhën midis muajve mars dhe maj 2017, morën pjesë gjithsej 55 individë.

- Si pjesë e punës kërkimore për studimin, në të njëjtën periudhë u intervistuan edhe 32 persona të tjerë.

- **Pjesëmarrësit në grupet e fokusit dhe personat e intervistuar ishin nga radhët e grupeve të pafavorizuara, si persona me aftësi të kufizuara, viktimat të dhunës në familje, fëmijë në institucione rezidenciale, të mitur në konflikt me ligjin, anëtarë të komunitetit rom, dhe anëtarë të komunitetit LGBT.** Po kështu u intervistuan edhe individë nga radhët e **ofruesve të shërbimeve, si ofrues të shërbimeve ligjore, OJQ** që ofrojnë ndihmë dhe mbrojnë të drejtat e viktimave të shkeljeve të të drejtave të njeriut, **punonjës të shërbimit social**, kryetarë **gjykatash**, personeli i **institucioneve rezidenciale për fëmijë**, si dhe punonjës nga institucionet e **Avokatit të Popullit dhe të Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi**.

- Intervistat me pjesëmarrësit u zhvilluan kryesisht në Tiranë, ku kanë selitë e tyre kryesore shumë prej ofruesve të shërbimeve të përmendura më lart. Përveç këtyre, intervista u zhvilluan edhe me pjesëmarrës në Shkodër, Vlorë, dhe në zona rurale.

# NJOHURITË DHE NJOHJA E LIGJIT DHE OPINIONET MBI DREJTËSINË

Njohuritë dhe njohja e ligjit dhe opinionet mbi drejtësinë

janë elementë të rëndësishëm të aksesit në drejtësi.

Ndonëse nuk pritet që qytetarët të kenë të njëjtin nivel njohurish ligjore si profesionistët e fushës, njohja nga ana e tyre e dispozitave bazë dhe parimeve kyçe të ligjit është parakusht për të pasur akses në drejtësi. Për të përcaktuar nivelin e njohurive të qytetarëve shqiptarë për ligjin, atyre iu bënë pyetje që lidheshin me njohjen e ligjit dhe opinionet mbi drejtësinë.









## 1.1 Njohuritë dhe njohja e ligjit

Çfarë të drejtash mbron Kushtetuta e Shqipërisë? Përmendni të gjitha të drejtat për të cilat jeni në dijeni (%)



Rezultatet flasin për një nivel të ulët ndërgjegjësimi të qytetarëve për të drejtat e tyre. As edhe një prej të drejtave ose lirive nuk u përmend nga më shumë se një e katërta e personave të anketuar, dhe vetëm tri të drejta dhe liri (e drejta për të jetuar (22.9%),<sup>1</sup> e drejta për të punuar (17.3%)<sup>2</sup> dhe liria e shprehjes (17%)<sup>3</sup> u përmendën nga më shumë se një e dhjeta e popullatës. Kushtetuta është dokumenti ligjor themelor i Shqipërisë dhe nëse njerëzit nuk e njohin përmbajtjen e saj, ajo bëhet e pavlefshme, çka do të thotë se qytetarët do ta kenë shumë të vështirë të kërkojnë t'u mbrohen këto të drejta. Edhe pasi të anketuarve iu bënë pyetje më të hollësishme, rezultatet në pjesën më të madhe pasqyruan një nivel po aq modest të ndërgjegjësimi ligjor.

Kompetencat e policisë për ndalim dhe arrest



Vetëm pak më tepër se një e treta (36,1%) e popullatës identifikoi përgjigjen 'A' si përgjigjen e drejtë.<sup>4</sup> Përqindja e personave që identifikuan përgjigjen e saktë ishte edhe më e ulët në radhët e popullatës rome (18,4%), ndër personat që nuk kishin përfunduar arsimin e detyrueshëm (27,3% e personave që nuk kishin përfunduar arsimin fillor, krahasuar me 47,4% të atyre me arsim universitar) dhe personat me të ardhura më të ulta (17,4% e atyre me të ardhura ndërmjet 2001 dhe 5000 lekë në muaj, në kontrast me 49,8% të atyre që kishin të ardhura ndërmjet 50 001 dhe 100 000 lekë në muaj). Në të njëjtën kohë, plot një e gjashta e personave të anketuar mendonin se personat e arrestuar nga policia mund të mbaheshin të ndaluar për sa kohë që konsiderohej e nevojshme.

Ky grafik ilustron gjithashtu modelin e kudogjendshëm që shihet në shoqërinë shqiptare: pra që niveli arsimor, niveli i të ardhurave dhe përkatësia në komunitetin rom janë tre faktorët më të spikatur dhe më të rëndësishëm përcaktues të nivelit të njohurive ligjore. Me fjalë të tjera, nëse dikush i përket etnisë rome, ka nivel të ulët arsimor dhe të ardhura të

1. Shih Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 21, <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/docuburratts/untc/unpan013810.pdf>, aksesuar për herë të fundit më 26 qershor 2017.

2. Po aty, neni 49.

3. Po aty, neni 22.

4. Po aty, neni 28(2).

**Një person i arrestuar nga policia duhet të nxirret para gjykatës brenda 48 orësh – JAM DAKORD**

**Arsimimi**

**27.3%**

Arsim fillor i papërfunduar

**29.1%**

Arsim fillor i përfunduar

**35.4%**

Arsimi i mesëm i përfunduar

**43.4%**

Arsim dhe formim profesional

**47.4%**

Arsim universitar

**Të ardhurat mujore në lekë**

**17.4%**

2001-5000

**32.9%**

5001-10,000

**32.4%**

10,001-20,000

**37.7%**

20,001-50,000

**49.8%**


50,001-100,000

ulta, gjasat që ai ose ajo të ketë dijeni për dispozitat ligjore janë më të ulta. Ky motiv përsëritet shpesh dhe ilustrohet edhe nga rezultatet e marra nga pyetjet e mëtejshme.

Po kështu, mendimet e personave të anketuar ishin të ndryshme për sa i përket të drejtës së gruas për të bërë zgjidhje martesë. Vetëm **dy nga pesë të anketuar (40,9%) thanë se gruaja mund të kërkojë divorcin pa pasur miratimin e bashkëshortit**,<sup>5</sup> ndërsa pjesa tjetër nuk kishin dijeni për këtë dispozitë, nga të cilët një e gjashta (16,7%) besonin se gruaja duhet të ketë miratimin e bashkëshortit për të bërë divorcin.

Edhe në këtë rast, niveli arsimor ishte faktor i rëndësishëm përcaktues i nivelit të njohjes së ligjit. Koncretisht, ndër personat që nuk kishin përfunduar arsimin fillor, më pak se një e treta (32,3%) thanë se një grua mund të marrë divorcin pa marrë pëlqimin e bashkëshortit; por kjo përqindje ngrihej në më shumë se gjysma (53,6%) në radhët e atyre që kishin përfunduar arsimin universitar.

**Një grua mund të marrë divorcin**



**Një grua mund të marrë divorc pa miratimin e bashkëshortit – JAM DAKORD**

**32.3%**

Arsim fillor i papërfunduar

**35.4%**

Arsim fillor i përfunduar

**40%**

Arsimi i mesëm i përfunduar

**40.7%**


Arsim dhe formim profesional

**53.6%**

Arsim universitar


5. Neni 132 i Kodit të Familjes.

**Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të ndjekin:**



Kur u pyetën nëse, sipas ligjit, fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të përfshihen në shkolla të zakonshme, apo shkolla të veçanta, **vetëm një e katërta (25.6%) identifikuan me saktësi se ligji parashikon mundësinë e përfshirjes së këtij grupi fëmijësh në shkollat e zakonshme,**<sup>6</sup> ndërsa pothuaj gjysma (46,3%) mendonin se sipas ligjit këta fëmijë duhet të shkojnë në shkolla të veçanta. Në përputhje me prirjen e përgjithshme, edhe në këtë rast, personat me kualifikime më të ulta arsimore, qytetarët romë dhe ata me të ardhura më të ulta kishin më pak gjasa të kishin njohuri për legjislacionin lidhur me këtë pikë (vetëm 15,2% e personave me të ardhura mujore nga 2001 deri në 5000 lekë dhe 21,5% e atyre me të ardhura mujore nga 5001 deri në 10 000 lekë).


**Personave të akuzuar për vrasje:**



Kur u pyetën në lidhje me të drejtat e personave të akuzuar për vrasje, **vetëm pak më shumë se gjysma e personave të anketuar (51,7%) kishin dijeni se atyre duhet t'u ofrohet avokat mbrojtës nga shteti,** nëse është e nevojshme.<sup>7</sup> Kjo shifër ishte edhe më e ulët ndër romët (42,9%), dhe personat me nivel më të ulët arsimor: ndërkohë që vetëm pak më shumë se një e treta (37.4%) e atyre që nuk kishin përfunduar arsimin fillor e dinin se shteti ka detyrimin t'u ofrojë ndihmë juridike falas personave të akuzuar për vrasje, pothuaj tri të pestat (58.2%) e atyre me arsim universitar kishin dijeni se ligji i parashikon këto garanci.


6. Neni 3 dhe 63 i Ligjit nr. 69/2012 mbi arsimin parauniversitar.  
7. Neni 31(ç) i Kushtetutës dhe Neni 6 i Kodit të Procedurës Penale.

**Një grua e martuar që ka marrë pajë:**



Publiku shqiptar nuk është i mirë-informuar as për të drejtat e grave. Rezultatet e studimit tregojnë se sa i përhapur është një koncept i gabuar për të drejtat e grave të martuara. Konkretisht, më se një e treta (35.1%) e pjesëmarrësve në studim besojnë se sipas ligjit, një grua e martuar që ka marrë pajë nuk ka të drejtë trashëgimie nga prindërit e saj, ndërsa vetëm pak më tepër se gjysma (55,6%) e personave të anketuar identifikuan dispozitën përkatëse – pra që një grua e martuar ka të drejtën e trashëgimisë nga prindërit e saj, pavarësisht nëse ka marrë pajë apo jo.<sup>8</sup>


**Komuniteti rom – Një grua e martuar që ka marrë pajë:**



Komuniteti rom, individët me të ardhura të ulta, dhe ata me nivel më të ulët arsimor, përsëri janë ndër personat më pak të informuar për sa i përket ligjit për këtë çështje. Ndërkohë që më shumë se gjysma (51,5%) e atyre që nuk kanë përfunduar arsimin fillor mendojnë se gratë e martuara nuk kanë të drejtën e trashëgimisë nëse kanë marrë pajë, ky numër përgjysmohet (në 24,7%) tek personat me arsim të lartë. Përveç kësaj, numri i romëve që mendojnë se ligji i ndalon gratë e martuara të marrin trashëgimi (42,9%) është më i madh se numri i atyre që kanë dijeni se ligji nuk e ndalon një gjë të tillë (35,2%). Së fundi, ndërsa 43.5% e personave me të ardhura nga 2001 deri në 5000 lekë në muaj besojnë se gratë që kanë marrë pajë nuk kanë të drejtën trashëgimie, kjo përqindje bie në 24,6% në radhët e atyre me të ardhura mujore më të larta.

8. Neni 360 i Kodit Civil.


Të ardhurat mujore në lekë



Është shqetësues fakti që ky nocion i rremë është po aq i përhapur tek gratë sa edhe tek burrat. Këtë e vërtetuan edhe intervistat e bëra si pjesë e këtij studimi; Ines Leskaj, e Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN), u shpreh: “Gratë nuk e dinë që kanë të drejtën e pronës; ato nuk e dinë që kanë të drejtë të marrin 50% të pasurisë (pas divorcit)<sup>9</sup>. Kjo është pjesë e një prirjeje së përgjithshme, për shkak se grave “u mungon informacioni”,<sup>10</sup> siç argumentojnë edhe Kristi Kola dhe Atila Deda të organizatës “Gruaja tek Gruaja”.

Popullata shqiptare u anketua gjithashtu edhe lidhur me njohuritë që kishin për moshën minimale ligjore për lidhje martesë. Vetëm 44,3% e personave të anketuar identifikuan drejt moshën 18 vjeç si moshën minimale të ligjshme për martesë (pavarësisht dispozitës përjashtimore të parashikuar në Kodin e Familjes për “shkaqe me rëndësi”).<sup>11</sup>

Mosha minimale ligjore për lidhje martesë është:




Kërkimi i informacionit për çështje që kanë të bëjnë me ligjin

Pothuaj tri të katërtat (73,4%) e popullatës nuk kishin kërkuar informacione për ligjin.

Nga personat që kishin kërkuar informacion për çështje që kanë të bëjnë me ligjin, pjesa më e madhe (79,3%) e kishin bërë këtë për të gjetur zgjidhje për mosmarrëveshjet e tyre. Përveç kësaj, prirja më mbizotëruese ishte se, sa më i lartë niveli arsimor i personit të anketuar, aq më të mëdha gjasat që ai ose ajo të kërkonte të informohej për ligjin. Kështu, personat me arsim universitar kishin pothuaj dy herë më shumë gjasa (39,1%) të bënin përpjekje për të zhvilluar më tej njohuritë e tyre për ligjin se ata që nuk kishin përfunduar (20,2%) ose që kishin përfunduar (17,5%) arsimin fillor. Ky rezultat mund të na shpjegojë pjesërisht rezultatet e mësipërme, që flasin për një lidhje të fortë ndërmjet nivelit arsimor dhe nivelit të njohjes së ligjit.

Burrat (29,6%) kishin më shumë gjasa se gratë (23,2%) të kërkonin informacion për çështje që lidhen me ligjin.



E POPULLATËS NUK KISHIN KËRKUAR INFORMACIONE PËR LIGJIN

Kam kërkuar informacion për çështje që kanë të bëjnë me ligjin




9. Intervistë me Ines Leskaj dhe Irena Shtraza, nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri; Tiranë, 10 shkurt 2017

10. Intervistë me Kristi Kola and Atila Deda, Gruaja tek Gruaja; Shkodër, 22 shkurt 2017.

11. Neni 7 i Kodit të Familjes.

Fushat kryesore të mosmarrëveshjeve të popullatës shqiptare janë ato që lidhen me të drejtat e tokës dhe pronës; për rrjedhojë, këto ishin edhe temat më kryesore për të cilat të anketuarit kishin kërkuar informacion, ndjekur nga çështje që lidheshin me punësimin, çështje administrative, e kështu me radhë.

**Për çfarë çështjesh ligjore keni kërkuar informacion? %**




Burimet e informacionit të konsultuara më shpesh ishin organet e qeverisjes vendore (8,2%), ndjekur nga qeveria qendrore (6,4%), avokatët/juristët (4,9%), interneti dhe mediat sociale (4,9%), si dhe miqtë e të afërmit (4,3%).

Numri i personave të anketuar që kishin mbetur të pakënaqur me informacionin e marrë ishte më i madh se i atyre që kishin mbetur të kënaqur. Ndërkohë që afërsisht një e treta (32,1%) u shprehën se ishin të kënaqur, dy të pestat (40,2%) nuk kishin mbetur të kënaqur. Vihen re dallime të theksuara brenda Shqipërisë për sa i përket shkallës së kënaqësisë me informacionet e marra. Për shembull, banorët e Tiranës përfaqësonin përqindjen më të ulët personave të kënaqur (24.1%) dhe përqindjen e dytë më të madhe të personave më të pakënaqur (45.8%) nga të gjitha rajonet e përfshira në studim.

**Popullata rome ishte veçanërisht e pakënaqur:** tri të katërtat (75,9%) e tyre u shprehën se ishin të pakënaqur dhe vetëm 17,2% deklaruan të kundërtën. Po kështu, u vunë re dallime të theksuara ndërmjet personave me nivele më të ulta dhe më të larta arsimore për sa i përket nivelit të kënaqësisë me informacionin e marrë, ku personat që nuk e kishin përfunduar arsimin fillor, ose që kishin përfunduar vetëm arsimin fillor, ishin më të pakënaqurit me këshillat e dhëna. Cilësia e këshillave dhe informacionit do të shqyrtohet më tej në kapitujt për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.


Vlen të theksohet gjithashtu se nuk kishte ndonjë dallim të dukshëm ndërmjet personave që kishin pasur dhe atyre që nuk kishin pasur përvoja të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në sistemin e drejtësisë për sa i përket njohjes dhe njohurive të tyre për ligjin.

**Ku e keni kërkuar informacionin për çështje që kanë të bëjnë me ligjin?**



## 1.2 Opinionet mbi drejtësinë


Nëpunësit e shtetit nuk paguhen mjaftueshëm, kështu që:



toleronin korrupsionin në krahasim me ata me të ardhura nga 2001 deri në 5000 lekë (17,4%) në muaj.

Nëpunësit e shtetit nuk paguhen mjaftueshëm, kështu që duhet të jetë e pranueshme që ata të kërkojnë tarifa shtesë për shërbim të mirë – JAM DAKORD

Të ardhurat mujore në lekë



Ekziston një nivel i ngjashëm tolerance ndaj dhunës në familje tek popullata në tërësi. Pothuaj një e katërta e popullatës (22,5%) beson se “i takon bashkëshortit të disiplinohet bashkëshorten e tij”, ndërsa më pak se gjysma (46,4%) thonë se “Fqinjët duhet t’i raportojnë policisë rastet e dhunës në familje” dhe një grup tjetër, që përbën një të pestën, (20,8%) i beson të dyja. Ndër personat që besojnë pohimin e parë, nuk ka dallime ndërmjet burrave dhe grave, dhe plot një e treta e grave shtëpiake (33,7%) janë të këtij mendimi. Disa aktivistë dhe aktiviste shprehën se ndonëse “dhuna në familje mbahej fshehur dhe quhej ‘normale’” në të kaluarën, gjendja është përmirësuar dhe dhuna në familje tani dënohet më shumë nga shoqëria në përgjithësi.<sup>12</sup> Pavarësisht nga ky përmirësim i mundshëm, ka prova të shumta që mbështesin rezultatet e studimit të paraqitura më lart: niveli i ndërgjegjësimit ndër qytetarët në përgjithësi dhe në institucionet zyrtare nuk është i mjaftueshëm për të siguruar një reagim gjithëpërfshirës dhe të njëtrajtshëm ndaj rasteve të dhunës në familje në të gjithë vendin. Kështu, një psikologe nga një prej OJQ-ve më në zë, thotë se gratë “nuk i njohin të drejtat e tyre [dhe] u mungon informacioni” dhe në të njëjtën kohë vë në dukje se edhe qendrimit zyrtarë luajnë një rol në këtë drejtim: “punonjësit e policisë tallen ose ua vënë fajin vetë grave ... ata thonë gjëra si ‘mirë ta bën që të rreh. Të kishe qenë gruaja ime, edhe më keq do të të kisha rrahur’”.<sup>13</sup> Toleranca ndaj dhunës në familje është më e lartë ndër romët (dy të pestat (40%) e të cilëve

12. Intervistë me Violeta Nezirin, Hapa të Lehtë; Shkodër, 22 shkurt 2017


13. Intervistë me Fabjola Thanën, Gruaja tek Gruaja; Shkodër, 28 shkurt 2017



mbështesnin të parin nga pohimet e mësipërme), si dhe tek personat me nivel të ulët arsimor. **Për më tepër, të drejtat pronësore dhe familjare të grave nuk njihen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë Shqipërinë.** Për shembull, vetëm 67,7% e burrave dhe 61,9% e romëve janë të mendimit se një grua e ve ka të drejtën të marrë gjysmën e pasurisë së bashkëshortit pas vdekjes së tij. Po kështu, vetëm pak më shumë se gjysma e popullatës rome (50,5%) mendon se pas divorcit gjykata duhet të caktojë se cilit prind t'i jepet kujdestaria e fëmijës duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës, dhe jo thjesht t'ia japë fëmijët babait.

**Popullata shqiptare është edhe më pak e përgatitur t'i zgjerojë opinionet e saj për drejtësinë për të përfshirë edhe popullatën LGBT.** Koncretisht, është shumë më i madh (37,4%) numri i qytetarëve që mendojnë se punëdhënësit duhet të jenë në gjendje ta pushojnë nga puna një homoseksual/homoseksuale në qoftë se nuk ndihen rehat me të, se sa ata që mendojnë se një homoseksual/homoseksuale duhet të ketë mundësi të shprehet hapur për seksualitetin e vet në punë (26,9%).



**Në lidhje me dhunën në familje:**




**I takon bashkëshortit të disiplinojë bashkëshorten e tij – JAM DAKORD**



Dallimet janë më të theksuara ndërmjet niveleve të ndryshme të të ardhurave si dhe ndërmjet të anketuarve me nivele arsimimitë ndryshme. Koncretisht, ndërsa 43,1% e atyre me të ardhura nga 2001 deri në 5000 lekë në muaj dhe 47,5% e atyre që nuk kishin përfunduar arsimin fillor, ishin në favor që punëdhënësit të lejoreshin t'i pushonin nga puna personat homoseksualë nëse nuk ndiheshin rehat me ta; këto përqindje binin në 25,1% tek ata me të ardhura ndërmjet 50 001 dhe 100 000 lekë në muaj dhe në 27,6% tek ata që kishin kryer studimet universitare.



**Të drejtat e personave LGBT**





# GJETJET KRYESORE

## LIDHUR ME NJOHURITË DHE NJOHJEN E LIGJIT DHE OPINIONET MBI DREJTËSINË

Rezultatet tregojnë:

- **REZULTATET FLASIN PËR NJË NIVEL TË ULËT NDËRGJEGJËSIMI TË QYTETARËVE PËR TË DREJTAT E TYRE.**

Asnjë e drejtë apo liri kushtetuese nuk u përmend nga më shumë se sa një e katërta e pjesëmarrësve në studim, (tri të drejtat të përmendura më shpesh ishin: e drejta për jetë, (22,9%), e drejta për të punuar (17,3%) dhe liria e shprehjes (17%).

- **PO KËSHTU, EKZISTON NJË NIVEL PO AQ MODEST I NDËRGJEGJËSIMIT PËR DISPOZITA TË TJERA LIGJORE.**

Për shembull, vetëm 36,1% e popullatës e di se një person i arrestuar nga policia duhet të nxirret para gjykatës brenda 48 orësh nga arrestimi, ndërsa vetëm 40,9% e dinin se një grua mund të kërkojë dhe marrë divorcin pa miratimin e bashkëshortit.

- **PUBLIKU SHQIPTAR NUK ËSHTË I MIRË-INFORMUAR PËR TË DREJTAT E GRUPEVE TË PAFAVORIZUARA.**

Për shembull, vetëm 25,6% mundën të identifikonin saktë se ligji parashikon përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme, ndërsa 35,1% mendonin se sipas ligjit një grua e martuar që ka marrë pajë nga familja nuk ka të drejtë trashëgimie mbi pronat e prindërve të saj.

- **POTHUAJ TRI TË KATËRTAT (73,4%) E POPULLATËS NUK KISHIN KËRKUAR INFORMACION PËR LIGJIN.**

Ishin më të shumtë të anketuarit e pakënaqur me informacionin e marrë, nga të cilët popullata rome, personat me nivel arsimor më të ulët dhe banorët e Tiranës, ishin ndër më të pakënaqurit.

- **NIVELI ARSIMOR, NIVELI I TË ARDHURAVE, SI DHE PËRKATËSIA NË KOMUNITETIN ROM SPIKATNIN SI TRI NGA FAKTORËT MË PËRCAKTUES TË NIVELIT TË NJOHURIVE DHE NJOHJES SË LIGJIT.**

Me fjalë të tjera, në qoftë se një person i përket etnisë rome, ka nivel të ulët arsimor dhe të ardhura të ulta, gjasat që ai ose ajo të njohin dispozitat ligjore dhe të kenë kërkuar informacion për ligjin janë më të pakta.

- **NUK KISHTE NDONJË DALLIM TË DUKSHËM NDËRMJET PERSONAVE QË KISHIN PASUR DHE ATYRE QË NUK KISHIN PASUR PËRVOJA ME ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË PËR SA I PËRKET NJOHURIVE DHE NJOHJES SË LIGJIT.**

Një përfundim i mundshëm që mund të nxirret nga kjo është se qytetarët kanë mësuar pak ose aspak pak për ligjin si rezultat i përvojave të tyre. Kjo thekson nevojën për të bërë ndryshime në këto ndërveprime, për të siguruar që ato të jenë njëkohësisht edhe edukuese, edhe me natyrë transaksionale dhe të orientuara nga shërbimi.

- **PËR SA I PËRKET OPINIONEVE MBI DREJTËSINË, REZULTATET TREGOJNË SE POPULLATA NË PËRGJITHËSI – DHE SIDOMOS TË RINJTË E TË REJAT, PERSONAT ME NIVEL TË LARTË ARSIMOR DHE ME TË ARDHURA TË LARTA**

kanë nivel të lartë tolerance ndaj korrupsionit, me 24,5% të tyre që thanë se është e pranueshme për nëpunësit e shtetit të kërkojnë tarifa shtesë. Pra, duket se toleranca ndaj korrupsionit është e rrënjësor relativisht thellë, madje edhe tek shtresat më të privileguara dhe më të arsimuara të shoqërisë. Një shpjegim i mundshëm për këtë është se të varfrit nuk mund t'i përballojnë tarifat shtesë dhe, si pasojë, janë kundër kësaj ideje. Megjithatë, është disi e çuditshme kur sheh se si personat e anketuar me nivel më të lartë arsimor, të cilët duhet të ishin më të mirë-informuar për të këqijat që sjell korrupsioni, janë kaq tolerantë ndaj tij.

- **EKZISTON NJË NIVEL I NGJASHËM TOLERANCE EDHE NDAJ DHUNËS NË FAMILJE,**


sepse 22,5% (ku përfshihen edhe gra të anketuara) mendojnë se "i takon bashkëshortit të disiplinohet bashkëshorten e tij."

- **POPULLATA SHQIPTARE NUK ËSHTË E PËRGATITUR T'I ZGJEROJË OPINIONET E SAJ PËR DREJTËSINË, PËR TË PËRFSHIRË EDHE POPULLATËN LGBT**

(37,4% mendojnë se punëdhënësi duhet të jetë në gjendje ta pushojë nga puna një homoseksual/e nëse nuk ndihet rehat me të).

- **REZULTATET FLASIN PËR NJË NIVEL MODEST TË NJOHURIVE DHE NJOHJES SË LIGJIT NGA ANA E POPULLATËS SHQIPTARE.**

Mungesa e ndërgjegjësimit për të drejtat e garantuara nga Kushtetuta, së bashku me mungesën e njohurive për ligjet dhe dispozitat kryesore, tregojnë se sistemi i ndihmës juridike duhet t'i kushtojë një vëmendje të madhe proaktive rritjes së njohurive dhe ngritjes së ndërgjegjësimit për ligjin. Këto përpjekje duhet t'i drejtohen të gjithë popullatës në përgjithësi por – në përgjigje të rezultateve të përshkruara më lart – ato duhet të përqendrohen tek personat me nivel më të ulët arsimor e me nivel më të ulët të ardhurash, si dhe tek komuniteti rom - grupe të cilat duket se kanë mangësitë më të mëdha në njohjen e ligjit dhe, për rrjedhojë, hasin edhe pengesat më të mëdha për të pasur akses në drejtësi. Rritja e ndërgjegjësimit për ligjin, si në radhët e këtyre grupeve, ashtu edhe në përgjithësi, do të kërkojë përdorimin e metodave proaktive për t'i plotësuar mangësitë në njohuritë ligjore të personave që nuk dinë ku të drejtohen për të kërkuar informacion.




– KAPITULLI 2 –

# NIVELI I BESIMIT NË SISTEMIN E DREJTËSISË


Pjesa më e madhe e popullatës (73,4%)  
mendon se sistemi shqiptar i drejtësisë  
nuk i mbron të drejtat e tyre.







Kjo mungesë besimi është më e theksuar në Tiranë, ku 77,9% thanë se nuk kanë besim në sistemin drejtësisë, ndërkohë që banorët e zonave rurale kanë më shumë besim në sistemin e drejtësisë (68,4% thanë që nuk kishin besim). Mungesa e besimit është e pranishme edhe ndër personat me të ardhura të larta, nga të cilët 77,3% e atyre me të ardhura mujore nga 50 001 deri 100 000 lekë thanë se sistemi i drejtësisë nuk i mbron të drejtat e tyre.

Të ardhurat mujore në lekë




Gjithashtu vihet re se burrat dhe personat më të moshuar janë ata që kanë më pak besim në sistemin e drejtësisë. Konkretisht, burrat kanë 9% më pak besim në drejtësi se sa gratë. Përveç kësaj, tek personat me moshë 65 vjeç e lart, niveli i besimit në sistem është mjaft më i ulët se sa ndër të rinjtë: ndërsa 80,4% e qytetarëve më të moshuar thonë se sistemi shqiptar i drejtësisë nuk i mbron të drejtat e tyre, shifra për grupmoshën 18-24 vjeç është mjaft më e ulët (67%).

Megjithatë, dallimi më i theksuar kur bëhet fjalë për besimin në sistemin e drejtësisë, është edhe ai më domethënës. **Personat që kanë pasur përvoja me sistemin e drejtësisë kanë shumë më pak gjasa të mendonin se ai i mbron të drejtat e tyre, në krahasim me ata që nuk kanë pasur kontakte me të gjatë pesë viteve të fundit.** Më konkretisht, nga personat që nuk kanë pasur çështje ligjore gjatë kësaj periudhe, 66,1% nuk kanë besim tek sistemi i drejtësisë, ndërkohë që përqindja rritet në mënyrë të ndjeshme në 81% tek personat që kanë pasur çështje ligjore dhe kontaktet përkatëse me sistemin e drejtësisë.



Arsyet që japin qytetarët se pse mendojnë që sistemi shqiptar i drejtësisë nuk i mbron të drejtat e tyre janë nga më të ndryshmet. **Arsyeja kryesore ishte korrupsioni, me 49,5% të popullatës që u shpreh se sistemi nuk i mbron të drejtat e tyre për shkak të tij.** Shifra ishte edhe më e lartë ndër ata që kishin pasur përvoja me sistemin e drejtësisë, sepse 55,9% e këtyre qytetarëve u shprehën se korrupsioni e pengonte sistemin të mbron të drejtat e tyre. Gjithashtu, kjo bindje kishte më shumë gjasa të hasej ndër personat me të ardhura më të larta, të cilët – siç do të shikojmë edhe në pjesën tjetër të studimit – kishin pasur më shumë përvoja me sistemin e drejtësisë se sa personat me të ardhura më të ulta. Përveç kësaj, burrat kishin më shumë gjasa se gratë të mendonin se sistemi i drejtësisë është i korruptuar.

**Arsyet më kryesore për mungesën e besimit në sistemin shqiptar të drejtësisë**



Rezultatet e mësipërme mbështeten edhe nga komponenti kërkimor cilësor që u zhvillua në kuadër të studimit. Mungesa e aftësisë së sistemit të drejtësisë për të mbrojtur të drejtat ishte temë e përhershme në intervistat dhe grupet e ndryshme të fokusit që u zhvilluan në të gjithë Shqipërinë.

Për shembull, një pjesëmarrëse në një prej grupeve të fokusit u shpreh kështu, “Seancat gjyqësore nuk mbarojnë kurrë. I shtynjë, e i shtynjë, e i shtynjë, edhe kur i ke të gjitha dokumentet në rregull. **Pse e bëjnë këtë? E bëjnë sepse duan para. Unë nuk kam fare besim në sistemin e drejtësisë.**”<sup>14</sup>


Në një grup tjetër fokusi me personat LGBT, një pjesëmarrës tha: “sistemi i drejtësisë është i korruptuar... Si komunitet, ne e shohim korrupsionin kudo. Për çfarëdo shërbimi, na duhet të paguajmë. Po pagove, ai personi as nuk do t’ia dijë a je apo nuk je homoseksual. Vetëm për para duan t’ia dinë.”<sup>15</sup>

Një pjesëmarrës tjetër në studim përmendi korrupsionin dhe paaftësinë si shkaktarë të mungesës së besimit në sistemin e drejtësisë: “Në përgjithësi, personat me aftësi të kufizuara nuk kanë besim në sistemin e drejtësisë. Ata mendojnë se gjykatësit janë të paaftë, nuk e njohin legjislacionin për personat me aftësi të kufizuara dhe janë të korruptuar.”<sup>16</sup>

14. Grup fokusi me gra nga zonat rurale dhe urbane; Vau i Dejës, 3 mars 2017.

15. Grup fokusi me persona LGBT tek Aleanca; Tiranë, 23 shkurt 2017.

16. Grup fokusi me persona me aftësi të kufizuara; Tiranë, 31 mars 2017.



# GJETJET KRYESORE


## LIDHUR ME BESIMIN NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Rezultatet tregojnë se:

- **POTHUAJ TRI TË KATËRTAT (73,4%) E POPULLATËS BESOJNË SE SISTEMI SHQIPTAR I DREJTËSISË NUK I MBRON TË DREJTAT E TYRE.**
- **KJO MUNGESË BESIMI ËSHTË MË E THEKSUAR TEK TË MOSHUARIT (80,4%),**  
banorët e Tiranës (77,9%), burrat (77.7%) dhe personat me të ardhura më të larta (77,3% e personave me të ardhura nga 50 001 deri në 100 000 lekë).
- **PERSONAT QË KISHIN PASUR PËRVOJA ME SISTEMIN E DREJTËSISË KISHIN SHUMË MË PAK GJASA (66,1%) TË BESONIN SE AI I MBRON TË DREJTAT E TYRE, NË KRAHASIM ME PERSONAT QË NUK KISHIN PASUR KONTAKTE ME TË GJATË PESË VITEVE TË FUNDIT (81%).**
- **ARSYEJA MË KRYESORE PËR MUNGESËN E BESIMIT NË SISTEMIN E DREJTËSISË ISHTE KORRUPSIONI (49,5%).**

Ky mendim u shpreh nga më shumë se gjysma e personave me të ardhura më të larta dhe nga personat që kishin pasur përvoja me sistemin e drejtësisë (55.9%).








– KAPITULLI 3 –

# KLASIFIKIMI I MOSMARRËVESHJEVE TË QYTETARËVE

Ky kapitull përvijon mosmarrëveshjet ligjore të shqiptarëve dhe karakteristikat e këtyre mosmarrëveshjeve, si objekti i mosmarrëveshjes, pala kundërshtare e përfshirë dhe lloji i dëmit të shkaktuar. Ai bën një përshkrim të përgjithshëm të këtyre të dhënave, ndërsa kapitujt në vijim eksplorojnë mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe vështirësitë e veçanta që mund të kenë disa grupe të caktuara në gjetjen e zgjidhjeve.



**Kemi pasur mosmarrëveshje në lidhje me çështje ligjore:**



Pothuaj gjysma e popullatës (48,7%) ka pasur probleme ligjore gjatë pesë viteve e fundit, nga të cilët disa kanë pasur më shumë se sa një mosmarrëveshje ligjore.

Numri i mosmarrëveshjeve tek burrat (53,7%) ishte më i lartë se sa tek gratë (43,7%). Po kështu duhet vënë në dukje se banorët e zonave rurale kishin më pak mosmarrëveshje (43,5%) se banorët e Tiranës (51,6%) dhe ata të zonave të tjera urbane (51,1%), dhe romët (69,5%) kishin shumë më tepër mosmarrëveshje ligjore se popullata jo-pakicë (46,4%).

**Llojet e mosmarrëveshjeve të hasura më shpesh kanë në qendër pronat dhe tokën.** Konkretisht, **10% e popullatës ka pasur mosmarrëveshje për tituj pronësie mbi tokën (legalizimin)**, që janë kryesisht çështje midis dy individëve çdonjëri prej të cilëve pretendon se është pronar i ligjshëm i një trualli.


Po kështu, **9% e popullatës kishte mosmarrëveshje për çështje toke**, si për shembull, mosmarrëveshje lidhur me kthimin e pronës pas shpronësimit të truallit ose tokës nga regjimi komunist në të kaluarën. Përveç këtyre, **5,9% e popullatës kishte mosmarrëveshje për çështje të kompensimit të pronave**, qofshin këto lidhur me pagesat nga shitja e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, ose për pagimin e tatimeve, ndërsa **5,4% kishin mosmarrëveshje për të drejta pronësore të tjera.**

Një kategori tjetër e rëndësishme mosmarrëveshjesh ishin ato lidhur me përfitimin e ndihmave nga shteti, si për shembull përfitimi i asistencës sociale apo i ndihmës ekonomike, **ku 8,2% e popullatës kishin pasur mosmarrëveshje për këtë çështje.** Pothuaj të gjitha këto mosmarrëveshje ishin me qeverinë dhe 79,2% e tyre (ose 6,5% e popullatës në përgjithësi) kishin pësuar dëme financiare si pasojë e tyre.

Në kategoritë e tjera të mosmarrëveshjeve hyjnë ato që lidhen me të drejtën e punës, përfshirë edhe gjendjen e punësimit. **Një ndër njëzet e pesë persona, ose 4,1%, e popullatës, thanë se kishin pasur mosmarrëveshje ligjore lidhur me rekrutimin dhe pushimin nga puna gjatë pesë viteve të fundit.** Një grup tjetër, prej **1,8% të popullatës, kishin probleme me pagat** (si mospagimi i tyre) **ose orarin e punës.** Përveç këtyre, **0,7% e popullatës kishin pasur aksidente në punë dhe çështjet ligjore që rridhnin prej tyre.**

Krimi është një çështje ligjore shumë më pak e shpeshtë për popullatën në përgjithësi. Krimi më i përfaqësuar është korrupsioni: një grup prej **3,1% të popullatës ka pasur mosmarrëveshje lidhur me korrupsionin dhe ryshfetin.** Megjithatë, kjo shifër nuk pasqyron shkallën e korrupsionit në shoqërinë shqiptare, sepse, siç tregohet në kapitujt e ardhshëm, numri i qytetarëve që kanë paguar ryshfet ose janë përfshirë në korrupsion për të zgjidhur çështjet në favorin e tyre është më i madh.

## Objekti i mosmarrëveshjeve



Llojet e tjera të krimeve u raportuan si më pak të përhapura. Për shembull, një përqindje relativisht e vogël (2,3%) e popullatës thanë se kishin pasur probleme me vjedhjet gjatë pesë viteve të fundit. Përqindja e sulmeve të raportuara kundër personit ishte edhe më e ulët; vetëm 1,4% të popullatës kishte qenë viktimë e tyre gjatë kësaj periudhe. Edhe për dhunën në familje u raportua se ndodh shumë rrallë, me frekuencë të ngjashme, me vetëm 1,3% të popullatës që raportuan se kishin pasur çështje ligjore që lidheshin me të. Së fundi, edhe keqpërdorimi i drogave dhe trafikimi i qenieve njerëzore u raportuan si jashtëzakonisht të rralla. Sigurisht, duhet thënë se **këto lloje mosmarrëveshjesh janë më të nën-raportuara se disa të tjera** (për shembull, studime të tjera tregojnë se 23,7% e grave kanë përjetuar dhunë në familje gjatë jetës së tyre), çka flet për mundësinë se këto ndodhin disi më shpesh nga sa tregojnë rezultatet e lartpërmendura.<sup>17</sup>

Po kështu, sipas studimit, edhe rastet e qytetarëve që kanë pasur çështje ligjore të lidhura me të drejtat familjare (pra ato ndërmjet anëtarëve të familjes, por që mund të mos kenë në qendër pronën) janë relativisht të rralla. Kështu, vetëm **1,9% e personave të anketuar thanë se kishin pasur çështje ligjore divorcesh të kontestuara gjatë pesë viteve të fundit**, çka mund të sugjerojë se shumica e divorcesh kryhen pak a shumë miqësisht pa krijuar vështirësi ligjore. Përveç këtyre, **1,2% thanë se kishin hasur probleme me nxjerrjen e dokumenteve familjare** (si certifikatat e lindjes), ndërsa vetëm **0,7% e popullatës raportuan se kishin pasur çështje ligjore lidhur me kujdestarinë mbi fëmijën apo me detyrimin ushqimor dhe të mbajtjes së fëmijës**.


Së fundi, një përqindje e vogël e qytetarëve kishin pasur probleme që lidheshin me marrëdhënie tregtare private, si mosrespektimi i kushteve të marrëveshjeve të biznesit (1,4%) ose mospagimi i huave (1,2%).

Pra, **llojet më mbizotëruese të mosmarrëveshjeve që kishte pasur popullata ishin mosmarrëveshje për pronën: ose për çështje trualli dhe të pronave mbi atë truall, ose për çështje kompensimi dhe të drejta të tjera pronësore** që rrjedhin prej tij. Pas tyre vinin mosmarrëveshjet me punëdhënësit (paraqitur më lart), krimi, çështjet familjare dhe kontratat (marrëveshjet e biznesit, etj.)


17. Shih: [https://un.org.al/sites/default/files/UNW%20Gender%20Brief%20Albania%202016\\_EN\\_web.pdf](https://un.org.al/sites/default/files/UNW%20Gender%20Brief%20Albania%202016_EN_web.pdf) dhe <https://www.parliament.al/wp-content/uploads/2017/04/RAPORTI-PP-2016.pdf>, konsultuar për herë të fundit më 24 korrik 2017.

Pavarësisht nga shumëllojshmëria e tyre tematike, në pjesën më të madhe **mosmarrëveshjet ishin me një subjekt: shtetin** (term gjithëpërfshirës që nënkupton qeverinë vendore, qeverinë qendrore dhe organe të tjera shtetërore). Konkretisht, nga personat që raportuan se kishin mosmarrëveshje, 81,7% i kishin ato me shtetin (çka përfaqëson një total prej 39,8% të të gjithë personave të anketuar). Ky grup ishte shumë më i madh se ai i personave që kishin mosmarrëveshje me palë të tjera: 23,1% e atyre që thanë se kishin pasur mosmarrëveshje, i kishin pasur ato me individë të tjerë (disa mosmarrëveshje kishin palë të shumëfishta, si qeveria dhe persona të tjerë); 7,4% kishin pasur mosmarrëveshje me anëtarë të familjes, 6,3% me punëdhënësit dhe 2,1% me qytetarë privatë.

**Kush është pala tjetër në mosmarrëveshje**



Kjo gjetje ka rrjedhoja të rëndësishme për sistemin e ardhshëm të ndihmës juridike: pra që ai duhet të jetë mjaftueshmërisht i pavarur për të siguruar që personat që kanë nevojë për asistencë ligjore ta marrin atë, edhe kur kanë si palë kundërshtarë qeverinë. Në të kundërt, nëse ata që e drejtojnë sistemin nuk kanë pavarësi të mjaftueshme, ekziston rreziku që sistemi i ndihmës juridike të ketë në qendër një konflikt interesi dhe të mos u japë ndihmën e duhur atyre që duan të ngrenë padi kundër shtetit.



# GJETJET KYÇE

## LIDHUR ME MOSMARRËVESHJET E QYTETARËVE

Rezultatet tregojnë që:

- **POTHUAJ GJYSMA E POPULLATËS (48.7%) KA PASUR PROBLEME LIGJORE GJATË PESË VITEVE TË FUNDIT, DHE DISA PREJ TYRE KISHIN MË SHUMË SE SA NJË MOSMARRËVESHJE.**

- **BURRAT DHE ANËTARËT E KOMUNITETIT ROM SPIKASIN SI GRUPET ME MË SHUMË MOSMARRËVESHJE, KRAHASUAR PÛRKATËSISHT ME GRATË DHE POPULLATËN JO-PAKICË.**

Dhe e kundërta, banorët e zonave rurale kishin më pak mosmarrëveshje se banorët e Tiranës dhe të zonave të tjera urbane.

- **LLOJET MË TË PÛRHAPURA TË MOSMARRËVESHJEVE LIDHESHIN ME ÇËSHTJE TË PRONËS DHE TË PRONËSISË MBI TOKËN/TRUALLIN.**

10% e popullatës kishte pasur mosmarrëveshje për çështje të titujve mbi tokën (legalizimin), ndërsa një grup tjetër prej 9% të popullatës kishin pasur mosmarrëveshje për tokën, qoftë me familjen apo me shtetin. Mosmarrëveshje të tjera të zakonshme ishin ato lidhur me marrjen e përfitimeve sociale (8.2%).

- **MË PAK TË ZAKONSHME ISHIN MOSMARRËVESHJET LIDHUR ME TË DREJTËN E PUNËS DHE PUNËSIMIT**

(4,1% kishin pasur mosmarrëveshje për çështje rekrutimi dhe pushimi nga puna) dhe me krimin (më i përhapuri ishte krimi i korrupsionit (3,1%).

- **PJESA MBIZOTËRUESE E MOSMARRËVESHJEVE (81,7%) ISHIN ME SHTETIN.**


– KAPITULLI 4 –

# ZGJIDHA E MOSMARRËVESHJEVE DHE SISTEMI I DREJTËSISË


Siç u tha më lart, 48,7% e popullatës kishin pasur mosmarrëveshje me rrjedhoja ligjore gjatë pesë viteve të fundit. Nga këto, çështjet më të rëndësishme lidheshin me të drejtën e tokës dhe pronës, si dhe me problemet në marrjen e përfitimeve sociale dhe të drejtat e punësimit.







**Cili ka qenë objekti i mosmarrëveshjeve tuaja më kryesore gjatë pesë viteve të fundit?**




Kapitujt në vijim shërbejnë për t'i shpjeguar lexuesit mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nga popullata shqiptare. Ata do të paraqesin veçoritë e trajektores së ndjekur nga popullata shqiptare për zgjidhjen e tyre në katër faza – një për secilin hap të ndërmarrë nga popullata për zgjidhjen e problemeve të tyre ligjore.

**FAZA PARAPRAKE**



Hapi i parë i ndërmarrë nga shumica dërrmuese (89,2%) e popullatës ishte që t'i drejtoheshin drejtpërdrejt palës tjetër – qoftë ky shteti, qytetar privat, punëdhënësi, apo dikush tjetër. Kjo flet për gatishmërinë e shqiptarëve për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet pa shumë shpenzime dhe pa përfshirjen e autoriteteve.

Megjithatë, këto përpjekje ishin pothuaj gjithmonë të pasuksesshme. Bisedimet e drejtpërdrejta ishin të suksesshme vetëm në 14,8% të rasteve kur ishte ndërmarrë një kontakt i tillë.

**Kur ndodhi problemi, i jeni afruar palës tjetër drejtpërdrejt për ta zgjidhur atë? A u zgjidh problemi plotësisht?**




Përveç faktit që në pjesën më të madhe ishin të pasuksesshme, këto ndërveprime ndërmjet palëve jo gjithmonë ishin paqësore. Në një ndër tetë raste (12.5%), të paktën njëra prej palëve e kishte kërcënuar palën tjetër me dhunë. Kjo ishte më e theksuar në Tiranë, ku 18,5% e banorëve kishin kërcënuar me dhunë (krahasuar me zonat urbane jashtë Tiranës, ku kjo kishte ndodhur vetëm në 8,2% të rasteve). Përveç kësaj, ky problem ishte më i përhapur në radhët e të rinjve se sa të të moshuarve: kërcënime me dhunë kishte pasur në 22,2% të mosmarrëveshjeve ku ishin përfshirë persona të grupmoshës 18-24 vjeç dhe në 15,5% të rasteve kur në to ishin përfshirë persona të grupmoshës 25-34 vjeç.



## KAPITULLI 4.1 – FAZA E PARË

Rezultatet tregojnë se shumica dërrmuese e problemeve (86,8%) nuk ishin zgjidhur me anë të bisedimeve të drejtpërdrejta me palën tjetër. **Atëherë, kujt iu drejtuan pas kësaj personat që kishin probleme ligjore për të zgjidhur? Shumica (52,2% gjithsej) u ishin drejtuar organeve të qeverisjes vendore dhe qendrore për problemin e tyre.**


**Kujt iu drejtuat së pari (përveç/pas kontaktimit të palës tjetër) për ta zgjidhur mosmarrëveshjen?**



Pothuaj një e treta (33,1%) i ishin drejtuar nëpunësve të qeverisjes vendore. Kjo ishte sidomos e vërtetë për personat me nivel më të ulët arsimor: ndërkohë që 35,4% e personave që nuk kishin përfunduar arsimin fillor dhe 39,9% e atyre që kishin përfunduar atë u ishin drejtuar nëpunësve vendorë, vetëm 22,5% e atyre me arsim universitar kishin bërë të njëjtën gjë. Institucioni i dytë më i parapëlqyer për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ishte qeveria qendrore, ku ishin drejtuar gati një e pesta (19,1%) e personave me mosmarrëveshje për të zgjidhur. Në të njëjtën kohë, sa më i lartë niveli i tyre arsimor, aq më të mëdha gjasat që personat t'i drejtoheshin në fillim organeve të qeverisjes qendrore: ndërsa 14,6% e personave që nuk kishin përfunduar arsimin fillor iu drejtuan fillimisht institucioneve të qeverisë qendrore, kjo përqindje rritej në 21,9% në radhët e personave që kishin mbaruar universitetin.


Është gjithashtu e rëndësishme të vihet në dukje se mbi gjysma e personave me mosmarrëveshje, u ishin drejtuar institucioneve qeveritare, dhe jo miqve, fqinjëve, gjykatave, policisë, avokatëve, OJQ-ve apo institucioneve të tjera. Kur u pyetën pse, 74,1% u përgjigjën se u ishin drejtuar disa institucioneve ose individëve të caktuar sepse ata ishin 'me autoritet'. E vetmja arsye tjetër që spikati ishte se personat në kërkim të zgjidhjes së mosmarrëveshjes e kishin zgjedhur këtë rrugë sepse donin t'u drejtoheshin personave që kishin "aftësi dhe/ose informacion" (8,9%). Po kështu, bie në sy që sa më i arsimuar personi, aq më të mëdha gjasat që t'i drejtohet fillimisht gjykatës si instancë e parë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

**U jam drejtuar së pari këtyre institucioneve (përveç/pas palës tjetër) për të zgjidhur mosmarrëveshjen**



Popullata rome kishte edhe më shumë gjasa (42,5%) t'u drejtohej organeve vendore se sa popullata e përgjithshme, **ndërkohë që asnjë qytetar rom nuk kishte shkuar në fillim në gjykatë si instancë e parë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.** Një gjyqtar që u intervistua si pjesë e studimit, tha se romët zakonisht "i zgjidhin mosmarrëveshjet me njëri-tjetrin dhe nuk shkojnë në gjykatë".<sup>18</sup> Arsyet për këtë mund të jenë të shumfështa, që nga shpjegimi se kjo mund të jetë një normë e kulturës së tyre, deri tek fakti se për pjesën më të madhe të anëtarëve të komunitetit rom kostot janë të papërballueshme.


**U jam drejtuar së pari këtyre institucioneve (përveç/pas palës tjetër) për të zgjidhur mosmarrëveshjen – komuniteti rom**



**Të ardhurat janë faktor i rëndësishëm parashikues i mënyrës se si përpiqen njerëzit t'i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre.** Sa më të ulta të ardhurat e një personi, aq më të mëdha gjasat që ai ose ajo t'i drejtohej qeverisjes vendore në përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Dhe e kundërta, gjasat që personat me të ardhura të ulta të shkonin në gjykatë, edhe pasi nuk kishin arritur ta zgjidhin mosmarrëveshjen përmes bisedimeve me palën tjetër, ishin jashtëzakonisht të ulta. **Kështu, asnjë nga personat e anketuar me të ardhura ndërmjet 2001 dhe 5000 lekë në muaj nuk zgjodhi t'i drejtohej gjykatës për të kërkuar zgjidhje; krahasuar kjo me personat me të ardhura mujore nga 50 000 deri në 100 000 lekë, 17,3% e të cilëve i ishin drejtuar gjykatës.**

18. Intervistë me Kryetarin e Gjykatës Administrative të Shkodrës; Shkodër, 22 shkurt 2017.

**U jam drejtuar së pari këtyre institucioneve (përveç/pas palës tjetër) për të zgjidhur mosmarrëveshjen – sipas të ardhurave**




**Komunikimi dhe respekti gjatë fazës së parë**


Afërsisht tre ndë dhjetë (29.3%) persona të anketuar në fazën e parë thanë se nuk kishin pasur pothuaj aspak mundësi t’i shprehnin mendimet dhe ndjenjat e tyre gjatë komunikimit me institucionin të cilit i ishin drejtuar (që ishin kryesisht nëpunës të qeverisjes vendore ose qendrore). Personat e ndikuar më shumë nga kjo ishin banorët e Tiranës, romët, dhe personat me nivel të ulët arsimor dhe me të ardhura të ulta. Ndër banorët e Tiranës, 40,5% mendonin se nuk u ishte dhënë mundësia të shprehnin mendimet dhe ndjenjat e tyre gjatë komunikimit me institucionin të cilit i ishin drejtuar në këtë fazë; kjo shifër rritet në 55,2% për anëtarët e komunitetit rom. Përveç kësaj, sa më i ulët niveli arsimor dhe sa më të ulta të ardhurat, aq më të mëdha gjasat që personat e anketuar të mos kishin pasur mundësi t’ia shprehnin mendimet dhe ndjenjat e tyre institucionit të cilit iu drejtuan.

**Në ç’masë patët mundësinë t’ia shprehnit mendimet dhe ndjenjat tuaja institucionit të cilit iu drejtuat? (sipas nivelit arsimor)**

**Pak mundësi**




**Mundësi të plotë**




**Në ç'masë patët mundësinë t'ia shprehnit mendimet dhe ndjenjat tuaja institucionit të cilit iu drejtuat? (sipas t'ardhurave)**

**Pak mundësi**




**Mundësi të plotë**



Më konkretisht, kur u bë klasifikimi sipas institucioneve, organet e qeverisjes vendore dhe qendrore rezultuan se ishin më pak hapura për t'u dhënë klientëve mundësinë të shprehnin mendimet dhe ndjenjat e tyre (34,9% e personave të anketuar që iu drejtuan organeve vendore dhe 31,5% e atyre që iu drejtuan qeverisë qendrore, mendonin se kishin pasur shumë pak mundësi t'i shprehnin mendimet dhe ndjenjat e tyre). Nga ana tjetër, gjykatat rezultuan shumë më mirëpritëse (19,1% e personave të anketuar mendonin se kishin pasur shumë pak mundësi, ndërsa 44,9% mendonin se u ishte dhënë mundësi e plotë).

**To what extent did you have an opportunity to express your opinions to the institution you addressed?**

**Pak mundësi**



Kjo mund të sugjerojë që nëpunësit e qeverisjes vendore dhe qendrore, të cilëve iu drejtuan shumica e shqiptarëve në fazën e parë në përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre, në përgjithësi nuk tregojnë shumë respekt dhe nuk i dëgjojnë klientët, veçanërisht personat nga komuniteti rom, ata me nivel arsimor të ulët dhe me të ardhura të ulta, si dhe banorët e Tiranës. Ndonëse gjykatat u paraqitën më mirë në këtë drejtim, intervistat e zhvilluara me punonjës socialë tregojnë se "personat nga komunitetet e pafavorizuara jo gjithmonë trajtohen me respekt nga gjyqtarët dhe punonjësit e tjerë në sistemin e drejtësisë."<sup>19</sup>

Personat e anketuar u pyetën gjithashtu nëse mendimet dhe ndjenjat e tyre ishin kuptuar nga personi apo institucioni tek i cili u paraqitën. Plot 27,1% e të anketuarve mendonin se nuk i kishin kuptuar aspak. Përsëri, më të pakënaqurit nga ky komunikim me institucionet ishin banorët e Tiranës (35,5% thanë se opinionet e tyre nuk ishin kuptuar), romët (46.6%), personat me nivel më të ulët arsimor (nga 42.9% tek personat që nuk e kishin përfunduar arsimin fillor, përqindja ulej në 22,9% tek personat me arsim universitar) dhe personat me të ardhura të ulta (36% e atyre me të ardhura nga 2001 dhe 5000 lekë në muaj), ndërkohë që tek personat me të ardhura mujore nga 50 001 deri në 100 000 kjo përqindje ishte 20,3%.

19. Intervistë me Drejtorin e Sektorit të Shërbimit Social, Departamenti i Shërbimit të Përkujdesit Social, Strehimi dhe Shërbimi i SHëndetit Publik, Bashkia Shkodër; Shkodër, 22 shkurt 2017.


Rezultatet janë pjesë e një modeli të përsëritur: kur u pyetën a ishin të kënaqur me respektin e dhënë nga personeli në institucionin ku kishin paraqitur mosmarrëveshjen e tyre, 30,1% e personave të anketuar thanë se ishin krejtësisht të pakënaqur, ndërsa vetëm 11,3% thanë se ishin plotësisht të kënaqur. Ndër më të pakënaqurit ishin banorët e Tiranës (35,9 ishin krejtësisht të pakënaqur), qytetarët romë (50%) dhe ata me nivel arsimor të ulët (48,6% për ata që nuk kishin përfunduar arsimin fillor dhe 31,3% për ata që kishin diplomë universitare).

Siç u shpreh edhe një prej të intervistuarve nga komuniteti rom: "Distanca [midis nesh dhe nëpunësve] është shumë e madhe. Kemi shkuar në zyra, institucione shtetërore, por asnjëherë nuk kemi gjetur shërbimin që gjenim dikur në kohën e komunizmit. Në atë kohë, po të trokisje në derën e institucioneve shtetërore, ata merrnin masa menjëherë. Tani kjo mungon. Mungon plotësisht. Bashkia, zyra e regjistrimit të tokave, na kanë harruar ... Ata iu përgjigjën kërkesave tona pas nëntë vjetësh dhe na i prishën shtëpitë."<sup>20</sup>

Pas klasifikimit sipas institucioneve, shihet përsëri se për sa i përket respektit të treguar ndaj tyre, qytetarët janë më të pakënaqur me organet e qeverisjes vendore (42,7%) dhe qendrore (33,9%). Nga ana tjetër, vetëm 19,1% e qytetarëve u shprehën se ishin krejtësisht të pakënaqur me respektin e treguar ndaj tyre në gjykatë.

#### A mbetet i kënaqur me nivelin e respektit të dhënë nga personi ose institucioni të cilit iu paraqit mosmarrëveshja?

##### Krejtësisht i pakënaqur



##### Plotësisht i kënaqur



## Drejtësia dhe paanshmëria e procesit

Gjatë kësaj faze të parë pothuaj dy të tretat (64,2%) e personave të anketuar mendonin se kjo fazë e procesit ishte shumë e padrejtë, ndërsa vetëm 12,2% mendonin se ishte shumë e drejtë. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë për anëtarët e komuniteteve romë (74,1%) dhe egjiptiane (87,5%), krahasuar me rezultatet e popullatës jo-pakicë (63,4%).

Pasja e një diplome universitare ishte gjithashtu faktor i rëndësishëm përcaktues: ndërsa 74,3% e atyre që nuk kishin përfunduar arsimin fillor mendonin se kjo pjesë e procesit ishte shumë e padrejtë, përqindja binte në 60,8% për personat me diplomë universitare.


Së fundi, edhe të ardhurat kanë rol kyç në përcaktimin se sa me drejtësi trajtohet dikush nga autoritetet: ndërsa 56% e personave me të ardhura nga 2001 deri në 5000 lekë në muaj dhe 71,4% e atyre me të ardhura ndërmjet 5001 dhe 10 000 lekë në muaj mendonin se kjo fazë e procesit ishte shumë e padrejtë, përqindja binte përkatësisht në 52,7% dhe 52,6% për personat me të ardhura nga 20 001 deri në 50 000 dhe 50 001 deri në 100 000 lekë në muaj. Ofruesit e ndihmës juridike të intervistuar në kuadrin e studimit e mbështetën këtë gjetje: "Në përgjithësi, sistemi gjyqësor shqiptar bën dallim ndërmjet atyre që janë të fuqishëm ekonomikisht dhe atyre që nuk janë."<sup>21</sup>

20. Grupi fokus me anëtarë të komuniteteve romë dhe egjiptiane; Qendra Komunitare, Selitë, Tiranë, 24 shkurt 2017.

21. Intervistë me Qendrën Res Publica, ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike; Tiranë, 13 prill 2017.


### Kjo fazë e procesit ishte shumë e drejtë

Të ardhurat mujore në lekë



Personat që mendonin se kjo fazë ishte më pak e drejtë ishin ata që u ishin drejtuar organeve të qeverisjes për të gjetur zgjidhje për mosmarrëveshjen e tyre: një përqindje shumë e madhe, 76,5% të të anketuarve, që u ishin drejtuar organeve të qeverisjes vendore (që, siç e tregojnë rezultatet e përmendura më lart, zakonisht janë më të varfër dhe me nivel më të ulët arsimor) thanë se kjo fazë e procesit ishte shumë e padrejtë, ndërsa vetëm 8,9% thanë se ishte shumë e drejtë. Në mënyrë të ngjashme, 63% e personave që i ishin drejtuar qeverisë qendrore (të cilët gjithashtu zakonisht janë ndër më të varfrit dhe me nivel më të ulët arsimor) thanë se procesi ishte shumë i padrejtë, ndërsa 7,3% mendonin se ishte shumë i drejtë. Krahasuar me këtë, gjykatat (ku kishin paraqitur kërkesat e tyre kryesisht persona me të ardhura të larta), ofronin një trajtim disi më të mirë: 61,8% thanë se proceset në gjykatë ishin shumë të padrejta, ndërsa 25% thanë se ishin shumë të drejta. Nga institucionet e tjera, bie në sy që policia ka rezultate më të larta (ndonëse edhe këto nuk janë fort të mira), me 50,8% të të anketuarve që mendonin se ishin trajtuar shumë padrejtësisht dhe 21,3 që thanë se ishin trajtuar në mënyrë të drejtë. Ndërsa rezultatet më të mira i kishin avokatët, me vetëm 25% të klientëve të tyre që mendonin se trajtimi kishte qenë i padrejtë, ndërsa 37.5% mendonin se ishte shumë i drejtë.


### Kjo fazë e procesit ishte shumë e drejtë



Gjatë kësaj faze të parë, pothuaj një e katërta e personave të anketuar (24,1%) thanë se rregullat ishin zbatuar në mënyrë krejt të pabarabartë për palët, ndërsa 12,7% thanë se ishin zbatuar në mënyrë disi të pabarabartë, dhe 46,7% thanë se ishin zbatuar në mënyrë krejtësisht të barabartë. Më të pakënaqurit ishin banorët e Tiranës (34,7% e të cilëve mendonin se rregullat ishin zbatuar në mënyrë krejtësisht të pabarabartë, krahasuar me 19,8% në zona të tjera urbane dhe 16% në fshatra), anëtarët e komunitetit rom (58,6%), personat me nivel më të ulët arsimor, dhe me të ardhura më të ulta.

### Rregullat u zbatuan në mënyrë të pabarabartë për ju dhe palët e tjera - ASPAK


Të ardhurat mujore në lekë





Përsëri, më të pakënaqur ishin personat që u ishin drejtuar me problemet e tyre organeve të qeverisjes vendore, nga të cilët afërsisht një të treta (33,5%) mendonin se në rastin e tyre rregullat ishin zbatuar në mënyrë krejtësisht të pabarabartë. Këto rezultate ishin më të pafavorshme se sa ato të institucioneve të tjera, për të cilat të anketuarit mendonin se i kishin zbatuar rregullat në mënyrë më të barabartë.

#### Rregullat u zbatuan në mënyrë të pabarabartë për ju dhe palët e tjera? - ASPAK




Kur u pyetën për rolin e faktorëve të jashtëm në rezultatin e mosmarrëveshjes së tyre, pothuaj një e treta (33,2%) e personave të anketuar shprehën mendimin se institucionet ku ishin drejtuar ishin tërësisht nën ndikime të jashtme, ndërsa një numër tri herë më i vogël (11,1%) mendonin se ato ishin krejtësisht të pandikuara. Ky mendim ishte më i theksuar tek komuniteti rom (47,4% thanë se institucionet ku ishin paraqitur kishin qenë tërësisht nën ndikim të jashtëm) dhe personat me nivel arsimor më të ulët (45,7% e atyre që nuk kishin përfunduar arsimin fillor).

#### Sipas mendimit tuaj, në ç'masë ishin nën ndikime të jashtme institucionet të cilave iu drejtuat?

##### Aspak




##### Plotësisht



Qeveria vendore dhe ajo qendrore mendoheshin si më të ndikuarat nga forcat e jashtme në trajtimin dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve. Për sa i përket së parës, 43,8% e personave të anketuar mendonin se ajo ishte plotësisht e ndikuar nga forca të jashtme, ndërsa për të dytën kjo shifër ishte 41,2%.

#### Institucionet të cilave iu drejtuar ishin plotësisht nën ndikime të jashtme




Përveç ndikimeve të jashtme, personat e anketuar shprehën bindjen se paragjykimi dhe njëanshmëria e institucioneve luan rol të madh në mënyrën se si zgjidhen mosmarrëveshjet e tyre. Konkretisht, **28,3% thanë se institucionet të cilave iu drejtuan kishin marrë vendime nën ndikimin e paragjyqimeve dhe njëanshmërisë**, ndërkohë që 27% thanë se këto institucione nuk ishin paragjyquese dhe të njëanshme. **Më se dy të tretat e popullatës rome** (68,4%, krahasuar me 25,5% tek popullata jo-pakicë) dhe mbi shtatë nga dhjetë persona që nuk kishin përfunduar arsimin fillor (70,6%, krahasuar me 20% të atyre me diplomë universitare) e shprehën këtë mendim. Banorët e Tiranës (34,9%) gjithashtu kishin mendimin se paragjykimi dhe njëanshmëria luanin rol më të madh në mënyrën si kishin shkuar mosmarrëveshjet e tyre, krahasuar me banorët e zonave të tjera urbane (25.5%) apo ata të zonave rurale (23.1%).


Personat me të ardhura të ulta gjithashtu pretendonin se institucionet të cilave iu drejtuan ishin paragjyquese dhe të njëanshme në trajtimin e mosmarrëveshjeve të tyre. Ndërsa 40% e atyre me të ardhura nga 2001 deri në 5000 lekë në muaj thanë se institucionet ku u drejtuan për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre ishin paragjyquese, më pak se gjysma (19,5%) e atyre në grupin me të ardhura nga 50 001 deri në 100 000 lekë në muaj ishin të këtij mendimi.

**Sipas mendimit tuaj, në ç' masë ishin paragjyquese dhe të njëanshme institucionet të cilave iu drejtuat?**

Aspak



Plotësisht




Vlen të vihet në dukje se burrat kishin më shumë gjasa se gratë të besonin se institucionet ku i kishin paraqitur mosmarrëveshjet e tyre ishin paragjyquese. Kjo përputhet me rezultatet nga pyetjet e tjera, të cilat përgjithësisht tregojnë se gratë mendojnë se institucionet janë më të drejta dhe më respektuese se sa burrat.


Institucionet që mendohej se ishin treguar më paragjyquese ose të njëanshme ishin organet e qeverisjes vendore dhe qendrore, me përkatësisht 37,4% dhe 32,7% të personave të anketuar që thanë se ato kishin vepruar në mënyrë paragjyquese dhe të njëanshme. Përkundër kësaj, personat e anketuar i mendonin gjykatat si më pak paragjyquese se çdo institucion tjetër në marrjen e vendimeve, me përjashtim të avokatëve, të cilët në këtë front shiheshin pozitivisht nga klientët e tyre.

Sipas mendimit tuaj, në çfarë mase ishin paragjyquese dhe të njëanshme institucionet të cilave iu drejtuat?

Aspak




Plotësisht



**Koha e shpenzuar dhe kostot personale në fazën e parë të procesit**

Studimi kishte për qëllim të maste edhe kohën që u ishte dashur qytetarëve të shpenzonin me mosmarrëveshjet e tyre. **Gjatë fazës së parë mosmarrëveshjet zgjasnin mesatarisht 20 muaj.** Për afërsisht një të dhjetën (10,2%) e mosmarrëveshjeve kohëzgjatja në institucionet ose personat përkatës ishte më pak se një muaj, pothuaj një e treta e tyre (31,7%) zgjatën deri në një vit, dhe pak më shumë se një e treta (35,1%) zgjatën më shumë se një vit, nga të cilat 2,8% kishin zgjatur nga gjashtë muaj deri në dhjetë vjet. Ndërsa 1,3% kishin zgjatur mbi dhjetë vjet.<sup>22</sup>

Sa zgjati faza e parë e procedurës?




Studimi mati gjithashtu edhe kohëzgjatjen e procedurës në çdo institucion. **Ai konstatoi se procedurat që zgjasnin më shumë ishin ato të paraqitura në organet e qeverisë qendrore (2 vjet e 5 muaj), ndjekur nga gjykatat (2 vjet e tre muaj) dhe organet e vendore (1 vit e 9 muaj).** Dhe e kundërta, kohëzgjatjen më të shkurtër e kishin mosmarrëveshjet e paraqitura pranë OJQ-ve (3 muaj, në bazë të një kampioni shumë të vogël), policia (4 muaj) dhe kryepoleqtë e fshatit (8 muaj, edhe kjo në bazë të një kampioni shumë të vogël).

22. Pjesa tjetër prej 23%, ose nuk iu përgjigjën pyetjes, ose nuk e dinin përgjigjen e kësaj pyetjeje.

Koha e shpenzuar për këtë fazë të procedurës kishte kostot e veta për personat e anketuar, punën dhe familjet e tyre. Pothuaj gjysma (46,8%) thanë se procedurat ua kishin marrë tërësisht kohën që përndryshe do t'ia kishin kushtuar punës dhe familjes; kjo ishte më e theksuar në Tiranë (54%) se sa në zonat urbane jashtë Tiranës (44%) dhe në zonat rurale (41,2%).

**Në ç'masë ju ka marrë kjo fazë e procedurës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga koha e dedikuar punës/familjes?**




Po kështu, afërsisht tri të katërtat (77%) e personave të anketuar thanë se procedurat u kishin shkaktuar tension dhe zemërim (73%). Edhe në këtë rast, banorët e Tiranës ishin ata që kishin pasur koston më të madhe (për sa i përket stresit) ndërsa procedurat i kishin shkaktuar më tepër zemërim anëtarëve të popullatës rome (83%) dhe atyre që nuk kishin përfunduar arsimin fillor (82,9%).

**Kostot financiare të procedurave dhe cilësia e shërbimit të ofruar**


Studimi mati gjithashtu edhe kostot totale të procedurës (tarifat për avokatët, shpenzimet e udhëtimit, dhe elementë të tjerë) për qytetarët gjatë fazës së parë. Mbi dy të tretat e personave të anketuar (68,8%) nuk kishin pasur asnjë kosto gjatë fazës së parë të procedurës. Nga ata që kishin pasur shpenzime, një total prej 13,8% kishin paguar më pak se 10 000 lekë gjatë gjithë kohëzgjatjes së fazës së parë, ndërsa 11,9% të tjerë kishin paguar nga 10 000 deri në 100 000 lekë dhe 5,4% kishin paguar më shumë se 100 000 lekë gjithsej.

**Sa ju ka kushtuar kjo fazë në total?**




Kostot varionin në mënyrë të ndjeshme nga një institucion në tjetrin. Ndërsa kostot e përgjithshme për t'iu drejtuar organeve të qeverisjes vendore dhe qendrore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ishin relativisht të ulta, kjo nuk ishte e vërtetë për rastet kur qytetarët u ishin drejtuar avokatëve apo gjykatave. Më konkretisht, ndërkohë që vetëm 1,8% e atyre që iu drejtuan qeverisë vendore dhe asnjë prej atyre që iu drejtuan qeverisë qendrore nuk kishin nevojë të paguanin më shumë se 100 000 lekë gjithsej, këto përqindje rriteshin përkatësisht në 25% dhe 20,6% për personat që iu drejtuan avokatëve dhe gjykatave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Nga ana tjetër, ndërsa mbi tri të katërtat (76.5%) e atyre që kishin bërë kërkesa pranë qeverisë vendore dhe mbi gjysma (52,1%) e atyre që kishin bërë kërkesa pranë qeverisë qendrore nuk kishin paguar asgjë, vetëm një në 16 të atyre që kishin shkuar tek avokatët (6,3%) dhe më pak se një e pesta (17,6%) e atyre që kishin shkuar në gjykatë, mund të thoshin të njëjtën gjë.

#### Sa ishte kostoja totale në para për këtë fazë në secilin institucion?



Nuk është për t'u çuditur që kostot më të mëdha i kishin pasur personat me të ardhura më të larta. Pothuaj dy të tretat (64%) e atyre që kishin paguar 100 000 ose më shumë lekë gjithsej, kishin të ardhura mbi 50 000 lekë në muaj. Në mënyrë të ngjashme, nga personat që kishin shpenzuar gjithsej ndërmjet 50 001 dhe 100 000 lekë, 85,7% kishin të ardhura mujore prej 20 000 lekë e lart, ndërsa nga personat që kishin shpenzuar ndërmjet 20 001 dhe 50 000 lekë, 78,2% kishin të ardhura mujore prej më shumë se 20 000 lekë. Kjo tregon se vetëm personat me të ardhura më të larta ishin në gjendje t'i përballonin kostot më të larta, gjë që u krijonte mundësinë të përdornin shërbimet e avokatëve apo të kërkonin drejtësi në gjykatë.

#### Marrëdhënia ndërmjet madhësisë së pagave dhe madhësisë së kostos totale




Kur u pyetën se sa e përballueshme ishte kjo fazë nga pikëpamja financiare, përafërsisht një ndër gjashtë të anketuar (16,5%) e përshkruan atë si krejt të papërballueshme. Kjo ishte e vërtetë për një ndër pesë (19,9%) banorë të Tiranës dhe vetëm për një

ndër tetë të anketuar nga zonat rurale (12,6%).

**Përgjithësisht, sa më të larta të ardhurat e të anketuarve, aq më e përballueshme ishte kjo fazë nga ana financiare.** Kështu, ndërsa për 33,3% të atyre me të ardhura mujore nën 2000 lekë dhe 25% të atyre me të ardhura mujore ndërmjet 2001 dhe 5000 lekë kjo fazë ishte e papërballueshme, këto përqindje uleshin me rritjen e nivelit të pagave (me përjashtim të grupit me të ardhura ndërmjet 50 001 dhe 100 000 lekë në muaj, për të cilët kjo fazë mund të ketë qenë e papërballueshme për shkak të shpenzimeve të mëdha për tarifën e avokatëve dhe tarifën gjyqësore).

Niveli i kënaqësisë me shërbimet ligjore të ofruara në këtë fazë ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në varësi të nivelit arsimor të personave të anketuar: **sa më i lartë niveli arsimor i tyre, aq më të pakta gjasat që të kishin mbetur të kënaqur nga shërbimet e ofruara.**

#### Nuk mbeta aspak i/e kënaqur nga cilësia e shërbimeve ligjore që m'u ofruan - ASPAK



## Korrupsioni

Një nga synimet e këtij studimi ishte të shqyrtonte edhe rolin që luan korrupsioni lidhur me aksesin në drejtësi. **Në fazën e parë, 5,1% e atyre që i dhanë përgjigje kësaj pyetjeje (4,3% e kampionit të përgjithshëm të personave që kishin mosmarrëveshje), pranuan se kishin paguar rryshfet.**<sup>23</sup>

Nga këta, 1% (nëntë persona) thanë se kishin paguar ndërmjet 10 000 dhe 100 000 lekë, që u ishin paguar si rryshfet nëpunëve të qeverisjes vendore, punonjësve të policisë, gjykatave dhe qeverisjes qendrore. Një grup tjetër prej 0,9% (8 persona) thanë se kishin paguar mbi 100 000 lekë (shuma më e madhe e regjistruar e paguar si rryshfet ishte 2 000 000 lekë), nga të cilat katër u ishin paguar gjykatave, dy policisë, një nëpunësve të qeverisjes vendore dhe një i ishte paguar një avokati.

## Rezultatet e fazës së parë


Vetëm 13,7% e personave të anketuar që hynë në fazën e parë arritën t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre, kurse 85,9% jo. Më pak gjasa për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre kishin anëtarët e komunitetit rom (8,9%) dhe personat me nivel më të ulët arsimor (11,4% e atyre që nuk kishin përfunduar arsimin fillor, krahasuar me 20,9% të atyre me arsim universitar).

#### A u zgjidh mosmarrëveshja gjatë kësaj faze të procesit? - PO




23. Duhet përmendur se korrupsioni shpesh nën-raportohet në studime të tilla, çka lë të hapur mundësinë që përqindja e vërtetë e atyre që kanë paguar rryshfet të jetë më e madhe.

#### A u zgjidh mosmarrëveshja gjatë kësaj faze të procesit? - PO



Personat e anketuar kishin më shumë sukses në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre në gjykatë, ku pothuaj një e treta (32,4%) kishin mundur të gjenin zgjidhje atje. Përveç kësaj, edhe 21,3% e atyre që shkuan në polici kishin arritur t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre. Dhe e kundërta, me gjithë numrin e madh të personave të anketuar që iu drejtuan si qeverisjes vendore ashtu edhe asaj qendrore, këta shumë rrallë kishin pasur sukses në zgjidhjen e problemeve të tyre ligjore, me përkatësisht vetëm 8,5% dhe 10,9% që kishin gjetur zgjidhje atje. Edhe rruga më pak e përdorur, shkuarja tek kryeplaku i fshatit, ishte më frytdhënëse, me 22,2% që kishin arritur t'i mbyllnin mosmarrëveshjet e tyre atje.

#### A u zgjidh mosmarrëveshja gjatë kësaj faze të procesit? - PO




Të anketuarit më të suksesshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas nivelit të të ardhurave, ishin ata me të ardhura nga 50 000 në 100 000 lekë në muaj. Kjo tregon se duke qenë se këta persona kishin më shumë gjasa të përdornin sistemin e gjykatave, ata kishin gjithashtu më shumë gjasa t'i mbyllnin çështjet e tyre atje se sa qytetarët e tjerë. Duhet thënë se rezultatet e tjera nuk flasin për ndonjë korrelacion të drejtpërdrejtë e të saktë ndërmjet sasisë së të ardhurave dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Në studim personat e anketuar u pyetën nëse kishin kërkuar ndihmë të mëtejshme pas përfundimit të fazës së parë (në pjesën më të madhe pa gjetur zgjidhje për mosmarrëveshjet). Ndonëse 85,7% nuk kishin arritur t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet, vetëm pak më shumë se një e treta (35,5%) kishin kërkuar ndihmë të mëtejshme. Personat me më pak gjasa të vazhdonin më tej ishin ata me nivel arsimor më të ulët, anëtarët e komunitetit rom, gratë dhe banorët e zonave jashtë Tiranës.

Vetëm 12,9% e personave që nuk kishin përfunduar arsimin fillor kishin kërkuar ndihmë të mëtejshme për gjetjen e zgjidhjes që donin. Kjo është në kontrast me rreth gjysmën (45,5%) e atyre që kishin diplomë universitare, çka nënvizon dallimet ndërmjet këtyre dy grupeve në mënyrën se si i qasen sistemit të drejtësisë.

A kërkuat ndihmën e ndonjë personi apo institucioni tjetër për ta zgjidhur këtë problem? - PO



Po kështu, gratë kishin më pak gjasa (30%) të kërkonin ndihmë më tej për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në krahasim me burrat (35,5%).

A kërkuat ndihmën e ndonjë personi apo institucioni tjetër për ta zgjidhur këtë problem? - PO




Qytetarët romë (21,6%) kishin pothuaj dy herë më pak gjasa të kërkonin ndihmë të mëtejshme në krahasim me popullatën jo-pakicë (37,6%).

A kërkuat ndihmën e ndonjë personi apo institucioni tjetër për ta zgjidhur këtë problem? - PO



Po kështu, banorët e Tiranës kishin shumë më tepër gjasa (46,2%) t'i ndiqnin më tej çështjet e pazgjidhura se sa qytetarët nga zona të tjera urbane (28,2%) ose nga zonat rurale (30,4%).

A kërkuat ndihmën e ndonjë personi apo institucioni tjetër për ta zgjidhur këtë problem? - PO



Rezultatet flasin gjithashtu edhe për prirjen që sa më larta të ardhurat e tyre, aq më të mëdha gjasat që personat e anketuar të vazhdonin përpjekjet për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre me sukses duke kërkuar ndihmë gjetkë. Pothuaj gjysma (47.4%) e atyre me të ardhura mujore nga 50 001 deri në 100 000 lekë e bënë një gjë të tillë, dhe përqindjet uleshin me uljen e nivelit të pagës (përveç pagave më të ulta në këtë tabelë, që duket se janë përjashtim nga rregulli).



## GJETJET KYÇE lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fazën e parë

Rezultatet tregojnë se:

- Pothuaj nëntë nga dhjetë (89,7%) qytetarë me mosmarrëveshje për të zgjidhur ishin të gatshëm t'i zgjidhin ato në mënyrë miqësore dhe efektive, duke iu drejtuar palës tjetër. Por këto përpjekje rrallë ishin të suksesshme (në 13,7% të rasteve) dhe pengoheshin nga kërcënimet e herëpashershme me dhunë (12,5%) që shkëmbeheshin mes palëve. Kjo thekson nevojën për një sistem efektiv ndërmjetësimi i cili do ta kanalizonte dëshirën për të gjetur zgjidhje paqësore për mosmarrëveshjet në mënyrë konstruktive.
- Shumica e qytetarëve me mosmarrëveshje zgjodhën t'i drejtoheshin qeverisë vendore (33,1%) ose qendrore (19,1%). Ata iu drejtuan shumë më rrallë gjykatave (8,2%), avokatëve (1,9%), OJQ-ve (0,1%), policisë (7,2%) dhe miqve e fqinjëve (5,5%). Ndonëse një pjesë e këtyre rezultateve mund të shpjegohet nga fakti që qeveria vendore dhe qendrore kanë juridiksion mbi mosmarrëveshjet në fjalë, qytetarët i bënë këto zgjedhje edhe ngaqë besonin (74,1%) se këto janë instanca "me autoritet". Duhet përmendur fakti që, në vend që t'u drejtoheshin personave me aftësitë dhe informacionin e duhur dhe në vend që të pyesnin për koston dhe të kërkonin këshilla nga persona të besuar, pjesa më e madhe e popullatës shqiptare mendonin se është e rëndësishme t'u drejtoheshin në radhë të parë personave më të fuqishëm e me më shumë pushtet.
- Këto rezultate duket se tregojnë që pjesa më e madhe e popullatës beson më shumë tek organet qeveritare se sa tek gjyqësori, shoqëria civile, apo organizata të tjera, si ndërmjetëset më me pushtet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Kjo pavarësisht nga gjetjet e tjera që tregojnë se këto institucione (qeveria vendore dhe qendrore) i trajtojnë njerëzit me më pak respekt dhe në mënyrë më pak të drejtë se institucionet dhe individët e tjerë të sipërpërmendur. Rezultati tregon se kjo shkaktohet, të paktën pjesërisht, nga kostot e procedurave gjyqësore dhe tarifat e avokatëve, që për shumë qytetarë janë të papërbalueshme. Këto gjetje sugjerojnë gjithashtu se individët shpesh mund të mos e dinë se cili institucion është më i përshtatshmi për t'i dhënë zgjidhje mosmarrëveshjes së tyre. Për më tepër, rezultatet mund të interpretohen edhe si një shenjë e dobësisë dhe e mungesës së efektivitetit të shoqërisë civile dhe gjyqësorit, dhe/ose si tregues i tendencës së krijuar ndër vite për t'iu drejtuar qeverisë për zgjidhjen e problemeve.
- Qytetarët që kishin pasur përvojat më të vështira në fazën e parë ishin romët, personat që nuk kishin përfunduar arsimin fillor, ata me të ardhura më të ulta, dhe banorët e Tiranës. Për shembull, këta qytetarë kishin marrë shërbimin më të dobët – për sa i përket qartësisë së komunikimit, trajtimit të hapur dhe me respekt - sepse 40,5% e banorëve të Tiranës dhe 55,2% e anëtarëve të komunitetit rom mendonin se nuk kishin pasur mundësi t'i shprehnin mendimet e tyre gjatë ndërveprimit me institucionin të cilit i ishin drejtuar, krahasuar me 29,3% që ishte mesatarja kombëtare.
- Anëtarët e këtyre grupeve gjithashtu besonin se ishin trajtuar në mënyrë më pak të drejtë dhe të paanshme: 34,7% e banorëve të Tiranës, 58,6% e komunitetit rom, 36% e atyre me të ardhura mujore ndërmjet 2001 dhe 5000 lekë dhe 54,3% e atyre që nuk kishin përfunduar arsimin fillor, mendonin se rregullat ishin zbatuar në mënyrë krejtësisht të pabarabartë, krahasuar me mesataren kombëtare prej 24,1%.
- Institucionet që u paraqitën më dobët në fazën e parë ishin organet e qeverisjes vendore dhe qendrore. Për shembull, ato kishin ofruar shërbimet më të dobëta, sepse qytetarët ishin shumë të pakënaqur me respektin që u kishin dhënë organet e qeverisjes vendore dhe qendrore.
- Po kështu, mendimi për qeverinë vendore dhe qendrore ishte se ato ishin më pak të drejta në trajtimin e qytetarëve. Për shembull, këto institucione kishin treguar më shumë paragjykim dhe njëanshmëri, me përkatësisht 37,4% dhe 32,7%, krahasuar me mesataren kombëtare prej 28,3%.
- Më se dy të tretat e personave të anketuar (68,8%) nuk kishin pasur ndonjë kosto gjatë fazës së parë të procedurës. Nga ata që kishin pasur shpenzime, 11,9% kishin paguar ndërmjet 10 000 dhe 100 000 lekë, ndërsa 5,4% kishin paguar më shumë se 100 000 lekë gjithsej.


- **Kostot financiare ndryshonin shumë nga një institucion në tjetrin.** Paraqitja në organet e qeverisjes vendore dhe qendrore ishte relativisht jo e kushtueshme. Asnjë prej atyre që u paraqitën në organet e qeverisjes qendrore dhe 25% dhe 20,6% e atyre që i paraqitën mosmarrëveshjet e tyre përkatësisht tek avokatët dhe gjykatat, kishin pasur kosto prej më shumë se 100 000 lekë gjithsej.
- **Në fazën e parë, 4,3% e të gjithë kampionit të personave që kishin mosmarrëveshje (por 5,1% e atyre që i dhanë përgjigje kësaj pyetjeje) e pranuan që kishin paguar rryshfet<sup>24</sup>, ku shuma më e madhe e paguar si rryshfet ishte 2 000 000 lekë.**
- **Vetëm 13,7% e personave të anketuar që hynë në fazën e parë të procesit arritën t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre.** Grupet me më pak gjasa për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet ishin anëtarët e komunitetit rom (8,9%) dhe personat me nivel më të ulët arsimor (11,4% e atyre që nuk kishin përfunduar arsimin fillor), së bashku me personat me të ardhura më të ulta.
- **Personat e anketuar kishin pasur më shumë sukses në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në gjykata,** ku pothuaj një e treta (32,4%) e kishin arritur këtë, ndërsa **kishin pasur shumë më pak sukses kur ishin paraqitur në organet e qeverisjes vendore dhe qendrore, me përkatësisht vetëm 8,5% dhe 10,9% që kishin arritur ta bënin një gjë të tillë.**
- **Të anketuarit më të suksesshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas nivelit të të ardhurave, ishin ata me të ardhura nga 50 000 deri në 100 000 lekë në muaj,** të cilët e kishin përdorur më shumë sistemin e gjykatave se sa të anketuarit me të ardhura më të ulta - **asnjë prej të anketuarve me të ardhura nga 2001 deri në 5000 lekë në muaj nuk kishte zgjedhur të shkonte në gjykatë për të kërkuar drejtësi.**
- **Gjatë fazës së parë, kohëzgjatja mesatare e mosmarrëveshjeve ishte 20 muaj. Procedurat zgjatnin më shumë nëse paraqiteshin pranë qeverisë qendrore (2 vjet e 5 muaj), ndjekur nga gjykatat (2 vjet e tre muaj) dhe organet vendore (1 vit e 9 muaj).** Ndonëse organet e qeverisjes vendore ishin pak më të shpejta se gjykatat, ky dallim duhet parë në kontekstin e rezultateve të mëparshme, të cilat tregojnë në mënyrë të qëndrueshme se qytetarët që i drejtoheshin nëpunësve vendorë kishin shkallën më të ulët të kënaqësisë për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nga ana e tyre.
- **Megjithëse 85,7% nuk kishin arritur t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet në fazën e parë, vetëm 35,5% kishin kërkuar ndihmë të mëtejshme diku tjetër. Personat me më pak gjasa ta bënin këtë ishin ata me nivel arsimor më të ulët, anëtarët e komunitetit rom, gratë, dhe personat që banonin jashtë Tiranës.** Përveç kësaj, sa më të larta të ardhurat e personit të anketuar, aq më shumë gjasa kishte që ai ose ajo të vazhdonte përpjekjet për t'i zgjidhur me sukses mosmarrëveshjet përmes kërimit të ndihmës diku gjetkë. Trajektorja e ndjekur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga personat që vazhduan të kërkonin zgjidhje më tej shqyrtohet në kapitullin në vijim.
- **Për ata që vendosën të mos vazhdonin më tej në fund të kësaj faze, kjo faktikisht shënonte fundin e përpjekjeve për të kërkuar drejtësi për ankesat e tyre – të cilat në pjesën më të madhe nuk kishin qenë të suksesshme. Personat që nuk kishin pasur sukses dhe e ndërprejnë procesin në këtë fazë kishin shumë më tepër gjasa të kishin paga më të ulta, nivel më të ulët arsimor, të ishin anëtarë të komunitetit rom, dhe të jetonin në Tiranë. Këto ishin pikat e dobëta më kryesore për sa i përket aksesit në drejtësi në Shqipëri.**

24. Duhet përmendur se korrupsioni shpesh nën-raportohet në studime të tilla, çka lë të hapur mundësinë që përqindja e vërtetë e atyre që kanë paguar rryshfet të jetë më e madhe.

## KAPITULLI 4.2 – FAZA E DYTË


Siç u përmend më lart, rezultatet tregojnë se vetëm 35,5% e personave të anketuar që kaluan fazën e parë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve thanë se kishin kërkuar ndihmën e një personi apo institucionit tjetër. Ky kapitull shqyrton përpjekjet e tyre për të pasur akses në drejtësi në fazën e dytë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

### Kujt tjetër i kërkuat ndihmë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (pas fazës së parë)?



Rezultatet janë mjaft të ndryshme nga faza e parë, në të cilën të anketuarit kishin parapëlqyer qeverinë vendore dhe qendrore si institucionet që mund të zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre. **Ndryshe nga më parë, ata që vazhduan më tej në fazën e dytë, parapëlqenin gjykatat (10,2%), qeverinë qendrore (9,1%) dhe avokatët (5,3%), ndërkohë që vetëm 2,8% iu drejtuan organeve të qeverisjes vendore.** Sa më e mirë gjendja ekonomike e një personi, aq më të mëdha gjasat që ai ose ajo të përdorte shërbimet e gjykatës (dhe, në një shkallë më të vogël, ato të avokatëve dhe të qeverisë qendrore) në fazën e dytë. Në të kundërt, sa më i varfër personi, aq më shumë gjasë kishte të kërkonte shërbime nga pushteti vendor. Së fundi, personat me të ardhura më të ulta (deri në 2000 lekë në muaj) ishin tejet të varfër dhe nuk ishin në gjendje të paraqitnin kërkesa pranë ndonjë personi ose institucionit në fazën e dytë.

### Cilit person/institucion i është paraqitur mosmarrëveshja në fazën e dytë (sipas të ardhurave)?



Përveç kësaj, sa më i arsimuar personi, aq më shumë gjasa kishte të përdorte shërbimet e avokatëve dhe gjykatave në këtë fazë.

Qytetarët romë kishin veçanërisht më pak gjasa (23,3%) se popullata jo-pakicë (33,4%) ta ndiqnin mosmarrëveshjen më tej në fazën e dytë. Për më tepër, personat që e bënë këtë kishin shumë më pak gjasa të përpiqeshin t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre në gjykatë, apo të përdomin shërbimet e një avokati. Përqindja e burrave (36.2%) që vazhduan ta ndiqnin më tej mosmarrëveshjen e tyre në fazën e dytë ishte mjaft më e lartë se sa ajo e grave (24%).


A i keni kërkuar ndihmë ndonjë personi apo institucioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (pas fazës së parë)?



## Komunikimi dhe respekti i treguar në fazën e dytë


Pak më shumë se një në dhjetë (10,4%) persona që u anketuan në fazën e dytë thanë se nuk kishin pasur pothuaj asnjë mundësi të shprehnin mendimet e tyre gjatë ndërveprimit me institucionin të cilit i ishin drejtuar, ndërsa pothuaj tre në pesë persona (59%) thanë se kishin pasur mundësi të plotë. Kjo shënon një ndryshim të madh me fazën e parë, në të cilën vetëm 29,3% thanë se kishin pasur pak mundësi dhe 51,1% thanë se kishin pasur mundësi të plotë.

Në ç'masë patët mundësinë t'i shprehni mendimet tuaja institucionit të cilit iu drejtuat?




Në ç'masë patët mundësinë t'i shprehni mendimet tuaja institucionit të cilit iu drejtuat?

Shumë pak mundësi



Mundësi të plotë




Përsëri, personat me të ardhura më të ulta kishin më shumë gjasa të mendonin se kishin pasur më pak mundësi, siç tregohet në tabelën e mëposhtme. Megjithatë, përmirësimi i vënë re në krahasim me fazën e parë është pjesërisht për shkak të institucionit të cilit i ishin drejtuar personat e anketuar. **Konkretisht, duke qenë se gjykatat dhe avokatët luajnë një rol më të madh në fazën e dytë, edhe mundësia e qytetarëve për t'i shprehur mendimet e tyre rritet.** Lidhur me përvojat në gjykatë, 6,9 % e qytetarëve mendonin se kishin pasur pak mundësi, ndërsa 57,5% mendonin se kishin pasur plotësisht mundësi të shprehnin mendimet e tyre. Ndërsa lidhur me përvojat me avokatët, 2,2% thanë se kishin pasur shumë pak mundësi dhe 91,1% thanë kishin pasur plotësisht mundësi të shprehnin mendimet e tyre.

Në ç'masë patët mundësinë t'i shprehni mendimet tuaja institucionit të cilit iu drejtuat?

Shumë pak mundësi



Mundësi të plotë



Kur iu bë pyetja nëse mendimet e tyre ishin kuptuar nga personi apo institucioni të cilit iu drejtuan, 11,2% e të anketuarve mendonin se nuk i kishin kuptuar aspak, ndërsa 43,5% thanë se i kishin kuptuar plotësisht. Kjo përsëri përbën një përmirësim të rëndësishëm në krahasim me fazën e parë (siç tregohet në tabelën e mëposhtme), ku bien në sy përmirësimet e shënuara në Tiranë.


**Për aq sa jeni në dijeni, u kuptua mendimi juaj nga personi/institucioni të cilit ju paraqit mosmarrëveshja në këtë fazë të procesit?**



Këto përmirësime në krahasim me fazën e parë janë pjesë e një tendence; në fazën e dytë përqindja e personave të anketuar që kishin mbetur të kënaqur me respektin e dhënë nga personi apo institucioni ku paraqitën mosmarrëveshjen (29.3%) ishte më e madhe se sa në fazën e parë (11.3%). Rezultatet tregojnë se 23,1% e personave të anketuar thanë se ishin krejtësisht të pakënaqur, ndërsa 29,1% thanë se ishin plotësisht të kënaqur. Ndër personat që përsëri nuk ndiheshin të respektuar sa duhet në fazën e dytë ishin qytetarët romë (35,3% të pakënaqur) dhe personat me nivel të ulët arsimor (40% për ata me arsim fillor të papërfunduar, dhe 23,3% për personat që kishin mbaruar universitetin).

**A jeni i/e kënaqur me respektin që ju është dhënë nga personi/institucioni të cilit i është paraqitur mosmarrëveshja?**

I/e pakënaqur



I/e kënaqur




Avokatët (68,9%) ishin personat ose institucionet me të cilët qytetarët ishin më të kënaqur për sa i përket respektit të treguar, ndjekur nga qeveria qendrore (26,9%) dhe gjykatat (19,5%).

## Drejtësia dhe paanshmëria e procesit

Gjatë fazës së dytë, pothuaj gjysma (45,5%) e personave të anketuar mendonin se kjo fazë e procesit ishte shumë e padrejtë, ndërsa 27,6% mendonin se ishte shumë e drejtë. Anëtarët e komunitetit rom (52,9%) dhe personat me nivel më të ulët arsimor (80% e atyre që nuk kishin përfunduar arsimin fillor dhe 33,9% e atyre me arsim universitar) ishin disa nga grupet që mendonin se ishin trajtuar më ashpër në këtë fazë. Megjithatë, kjo përsëri shënon një përmirësim nga faza e parë, në të cilën 64,2% e personave të anketuar mendonin se procesi ishte shumë i padrejtë, ndërsa vetëm 12,2% mendonin se ishte shumë i drejtë.

Përveç kësaj, sa më të ulta të ardhurat, aq më të pakta gjaset që personi të trajtohej në mënyrë të drejtë nga institucionet/individët në këtë fazë: ndonëse 55,6% e atyre me paga mujore nga 2001 në 5000 lekë mendonin se kjo fazë e procesit ishte shumë e padrejtë, vetëm 33,3% e personave me paga ndërmjet 50 001 dhe 100 000 lekë e mendonin këtë.

### Kjo fazë e procesit ishte shumë e padrejtë



Në të gjitha institucionet u shënuan përmirësime nga faza e parë në të dytën. Organet e qeverisjes vendore përsëri kishin shifrat më të ulta, por 58,3% e personave të anketuar që u paraqitën tek to thanë se kjo fazë e procesit ishte shumë e padrejtë (në krahasim me 76,5% në fazën e parë). Edhe gjykatat shënuan përmirësime: ndonëse 48,3% thanë se procesi para gjykatës ishte shumë i padrejtë, kjo shifër përbënte përmirësim krahasuar me 61,3% në fazën e parë.

Gjatë fazës së dytë, një numër i vogël personash të anketuar (8,6%) thanë se rregullat ishin zbatuar në mënyrë krejtësisht të pabarabartë për palët, ndërsa 13,4% thanë se ato ishin zbatuar disi barabar dhe 56,7% thanë se ishin zbatuar në mënyrë plotësisht të barabartë. Banorët e zonave urbane jashtë Tiranës mendonin se i kishin trajtuar më keq (15,8% thanë se rregullat ishin zbatuar në mënyrë krejtësisht të pabarabartë, në krahasim me 5,6% në Tiranë dhe 5,9% në fshatra). Mendimet e anëtarëve të komunitetit rom pësuan përmirësim të ndjeshëm, sepse nuk pati asnjë përgjigje nga persona që mendonin se rregullat ishin zbatuar në mënyrë krejtësisht të pabarabartë, nga 58,6% që e kishin shprehur këtë mendim në fazën e parë. Ndonëse romët janë ende mbrapa nga popullata jo-pakicë në këtë drejtim, përsëri ky shënon një përmirësim të ndjeshëm nga një fazë në tjetrën.

### Në ç'masë u zbatuan rregullat në mënyrë të barabartë për ju dhe palët e tjera?





Tabela në vijim paraqet një pikë tjetër krahasimi që tregon se në të gjitha kategoritë e të ardhurave u shënuar rritje në numrin e personave që mendonin se rregullat ishin zbatuar në mënyrë të barabartë. Personat e anketuar mendonin se qendrimet paragjyquese dhe të njëanshme të institucioneve dhe personave të cilëve iu paraqitën mosmarrëveshjet vazhdonin të luanin një rol të rëndësishëm në vendimmarrje. Mbi një e gjashta (17,5%) e tyre thanë se ishin trajtuar në mënyrë paragjyquese dhe të njëanshme, ndërsa 45,7% thanë që jo. Anëtarët e komunitetit rom që kishin të njëjtin mendim ishin shumë të paktë (11,8% krahasuar me 48,3% tek popullata jo-pakicë).

**Institucionet të cilave iu drejtova nuk ishin aspak paragjyquese dhe të njëanshme**




**Institucionet të cilave iu drejtova nuk ishin aspak paragjyquese dhe të njëanshme**



Përsëri, personat me të ardhura më të ulta kishin më tepër gjasa të mendonin se ndaj tyre kishte paragjykime, në krahasim me personat me të ardhura më të larta (shih tabelën në vijim), por marrëdhënia ndërmjet tyre nuk është aq e qartë dhe e drejtpërdrejtë sa në fazën e parë.

Ashtu si në fazën e parë, burrat kishin më shumë gjasa se gratë të mendonin se institucionet ku kishin paraqitur mosmarrëveshjet e tyre ishin paragjyquese. Kjo përputhet edhe me rezultatet e tjera, sipas të cilave gratë kishin më shumë gjasa se burrat të mendonin se mekanizmat ekzistuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve janë më të drejta dhe më respektuese.

**Institucionet të cilave iu drejtova nuk ishin aspak paragjyquese dhe të njëanshme**



Në tërësi, rezultatet shënojnë një përmirësim nga shifrat e mëparshme për sa i përket drejtësisë dhe paanshmërisë së procesit, krahasuar me fazën e parë. Më paragjyquese dhe të njëanshme në këtë fazë ishin institucionet e qeverisë vendore dhe qendrore, me përkatësisht 41,7% dhe 21,8%. Nga ana tjetër, personat e anketuar mendonin se gjykatat kishin qenë institucionet më pak paragjyquese në vendimmarrjen e tyre, pas avokatëve, që shiheshin pozitivisht nga klientët në këtë front. Në krahasim me fazën e parë u shënuar përgjithësisht një rënie në numrin e personave që mendonin se institucionet dhe personat përkatës në sistemin e drejtësisë ishin paragjyques dhe të njëanshëm.




## Koha e shpenzuar dhe kostot personale në fazën e dytë të procesit

Kohëzgjatja mesatare e mosmarrëveshjes gjatë fazës së dytë ishte **16 muaj**, ose katër muaj më pak se në fazën e parë. Pothuaj **dy të tretat (64%)** thanë se procedurat ua kishin marrë tërësisht kohën që përndryshe do t'ia kishin kushtuar punës dhe familjes, çka shënon një ngritje nga 46,8% në fazën e parë. Ashtu si në fazën e parë, **afërsisht tri të katërtat (76,4%) e personave të anketuar ishin ndjerë të tensionuar dhe zemëruar (71,6%)**.

## Kostot financiare të procedurave dhe cilësia e shërbimit të ofruar


**Kostoja totale e procedurave për qytetarët (tarifat e avokatëve, shpenzimet e udhëtimit dhe elementë të tjerë) u rrit ndjeshëm nga faza e parë në të dytën.** Ndërsa më se dy të tretat e personave të anketuar (68,8%) nuk kishin pasur ndonjë kosto gjatë fazës së parë, në fazën e dytë kjo shifër pothuaj u përgjysmua, me vetëm 34,3% të të anketuarve që nuk kishin pasur kosto financiare. Përveç kësaj, për personat që kishin paguar, kostot ishin më të larta: 38,8% kishin paguar nga 10 001 deri në 100 000 lekë (nga 11,9% në fazën e parë) dhe 7,3% kishin paguar më shumë se 100 000 lekë gjithsej (nga 5,4% në fazën e parë).

### Sa ishte kostoja totale në para (nëse pati kosto) në këtë fazë?




**Kostot financiare ndryshonin shumë nga një institucion në tjetrin.** Shkuarja në gjykatë është e kushtueshme: 12,6% të personave që iu drejtuan gjykatës për mosmarrëveshjet e tyre iu ishte dashur të paguanin më shumë se 100 000 lekë, ndërsa një grupi tjetër prej 19,5% u ishte dashur të paguanin ndërmjet 50 001 dhe 100 000 lekë. Marrja e një avokati po kështu kushton shumë: 6,7% e atyre që kishin marrë avokat, kishin paguar më shumë se 100 000 lekë, ndërsa 17,8% kishin paguar ndërmjet 50 001 dhe 100 000 lekë. Në kontrast me këtë, 62,5% e atyre që i kishin paraqitur mosmarrëveshjet e tyre në organet e qeverisjes vendore dhe 41% e atyre që i kishin bërë kërkesë qeverisë qendrore, nuk kishin paguar asgjë, çka ndodhte shumë më rrallë në gjykata (14,9%) dhe me avokatët (11,1%).

### Sa ishte kostoja totale në para në çdo institucion?



Edhe në këtë fazë, përsëri personat me paga më të larta kishin shpenzimet më të mëdha. Mbi tri të katërtat (77%) e atyre që kishin pasur kosto totale prej 100 000 ose më shumë lekë, merrnin të ardhura mbi 50 000 lekë në muaj. Po kështu, nga personat që kishin pasur kosto totale ndërmjet 50 001 dhe 100 000 lekë, 77,7% kishin të ardhura mujore prej 20 000 ose më shumë lekë, ndërsa nga personat që kishin pasur kosto ndërmjet 20 001 dhe 50,000 lekë, 74.3% merrnin paga mujore mbi 20 000 lekë. Kjo tregon se vetëm personat me të ardhura më të larta ishin në gjendje t'i përballonin kostot më të larta, gjë që u jepte mundësinë të përdornin shërbimet e një avokati, apo të kërkonin drejtësi në gjykatë. Personat me të ardhura të ulta nuk ishin në gjendje t'i merrnin këto shërbime dhe, si rrjedhojë – siç tregojnë rezultatet e fazës së parë dhe rezultatet e diskutuara më poshtë – nuk kishin të njëjtat gjasa të mbeteshin të kënaqur apo të gjenin drejtësi për dëmet që kishin pësuar.

#### Cilat ishin të ardhurat e personave që paguan?



Kostot më të larta gjatë fazës së dytë, si dhe kostot e përgjithshme të të dyja fazave të marra së bashku, bënë që numri i personave të anketuar (24%, nga 16.5% në fazën e parë) që deklaruan se kjo fazë ishte krejtësisht e papërbalueshme të ishte më i madh. Në përgjithësi, përbalueshmëria e kostos në këtë fazë rritej me rritjen e të ardhurave të personave të anketuar, ndonëse korrelacioni i drejtpërdrejtë nuk është aq i fortë sa në fazën e parë.

## Korrupsioni

Në fazën e dytë, 7,9% e atyre që morën pjesë në këtë fazë dhe i dhanë përgjigje kësaj pyetjeje (2,3% të kampionit total të atyre që kishin mosmarrëveshje) thanë se u kishin paguar rryshfet institucioneve ose personave që ishin marrë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre.<sup>25</sup>


Nga këta, 2,75% (shtatë persona) thanë se kishin paguar nga 10 000 deri në 100 000 lekë, të cilët u kishin paguar rryshfet nëpunësve të qeverisë qendrore, politikanëve, dhe gjykatave. Një grup tjetër prej 2,4% (gjashtë persona) thanë se kishin paguar mbi 100 000 lekë (ku shuma më e madhe e regjistruar e paguar si rryshfet ishte 2 000 000 lekë), që u ishin paguar punonjësve të pushtetit vendor, gjykatave, policisë dhe një avokati. Shuma më e madhe e paguar si rryshfet ishte 500 000 lekë.

25. Duke qenë se numri i personave që morën pjesë në fazën e dytë është shumë më i vogël se i atyre që morën pjesë në të parën, shqyrtimi i të dyja përqindjeve së bashku krijon një ide më të qartë.

## Rezultatet e fazës së dytë

Pothuaj një e katërta (24,4%) e personave të anketuar që morën pjesë në fazën e dytë i kishin zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre. Personat e anketuar kishin pasur më shumë sukses në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në gjykata, me 42,5% prej tyre që kishin arritur të gjenin zgjidhje atje. Përveç këtyre, 22,2% e atyre që kishin marrë avokat dhe 20% e atyre që i ishin drejtuar policisë, kishin arritur t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre. Ashtu si në fazën e parë, personat e anketuar që i ishin drejtuar organeve të qeverisjes vendore dhe qendrore patën pak sukses në zgjidhjen e çështjeve të tyre ligjore, ku përkatësisht vetëm 12,5% dhe 6,4% e të anketuarve kishin gjetur zgjidhje atje.

Arrita ta zgjidh mosmarrëveshjen në këtë fazë? - PO




Përsëri, sa më të larta të ardhurat e personave të anketuar, aq më të mëdha gjasat për ta zgjidhur mosmarrëveshjen edhe në këtë fazë: 37,5% e personave me të ardhura nga 50 001 deri në 100 000 lekë në muaj kishin arritur sukses në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, çka përfaqëson përqindjen më të lartë nga të gjitha nivelet e të ardhurave. Nga ata që e përfunduan fazën e dytë, 36,4% thanë se kishin kërkuar ndihmë të mëtejshme nga një person tjetër për ta zgjidhur problemin. Më shpesh këtë e kishin bërë personat që kishin mbaruar universitetin (56,8%, krahasuar me 31,6% të atyre që kishin përfunduar arsimin fillor), si dhe personat nga Tirana (46,2%). Në çka përbën një përmbyesje të rezultateve nga faza e parë, gratë (40,9%) kishin më shumë gjasa të kërkonin ndihmë të mëtejshme se sa burrat (33,9%) për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Qytetarët romë (22,2%) kishin shumë më pak gjasa të kërkonin ndihmë më tej se sa popullata jo-pakicë (36,7%).

A kërkuat ndihmë nga ndonjë person/institucion tjetër për të zgjidhur problemin? - PO




Po kështu, banorët e Tiranës përsëri ishin më të prirur (46,2%) të vazhdonin të kërkonin drejtësi se qytetarët nga zona të tjera urbane (29%), ose nga zonat rurale (25,6%).

A kërkuat ndihmë nga ndonjë person/institucion tjetër për të zgjidhur problemin? - PO



Së fundi, sa më të larta të ardhurat, aq më të mëdha gjasat që personat të vazhdonin të kërkonin drejtësi dhe ndihmë nga institucione ose persona të tjerë. Më se dy në pesë (42,2%) persona me të ardhura nga 50 001 dhe 100 000 lekë thanë se kishin kërkuar ndihmë në fund të fazës së dytë; kjo përqindje ulej vazhdimisht me uljen e nivelit të të ardhurave.

#### Pagat



## GJETJET KRYESORE lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fazën e dytë

Rezultatet tregojnë se:

- **Ka një ndryshim të madh nga faza e parë** për sa i përket institucioneve tek të cilat u paraqitën mosmarrëveshjet: ata që vazhduan në fazën e dytë parapëlqenin gjykatat (10.2%), qeverinë qendrore (9.1%) dhe avokatët (5.3%), ndërsa vetëm 2,8% iu drejtuan organeve të qeverisjes vendore.
- **Sa më e mirë gjendja ekonomike dhe sa më të arsimuar personat e anketuar, aq më shumë gjasa kishte të përdornin shërbimet e gjykatave (dhe në një shkallë më të vogël, shërbimet e avokatëve dhe të qeverisë qendrore) në fazën e dytë.**
- **Gjasat që qytetarët romë t'i ndiqnin mosmarrëveshjet më tej në fazën e dytë ishin ndjeshëm më të pakta (23,3%) se sa ato të popullatës jo-pakicë (33,4%).** Për më tepër, edhe ata që e ndoqën çështjen më tej kishin shumë më pak gjasa të bënin përpjekje për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre në gjykata apo të merrnin avokat.
- **Ndonëse romët, personat me nivel arsimor më të ulët dhe me të ardhura më të ulta kishin pasur përvoja jo aq të mira për sa i përket komunikimit, respektit të treguar dhe drejtësisë, përsëri rezultatet e tyre ishin disi më të mira se sa në fazën e parë.** Për shembull, ndërkohë që 36% e atyre me të ardhura nga 2001 deri në 5000 lekë thanë se në fazën e parë rregullat nuk ishin zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjitha palët, në fazën e dytë kjo shifër ra ndjeshëm në 11,1%.
- **Organet e qeverisjes vendore dhe qendrore konsideroheshin si institucionet më paragjyquese ose të njëanshme në këtë fazë, me përkatësisht 41,7% dhe 21,8%.** Nga ana tjetër, për gjykatat, personat e anketuar mendonin se kishin qenë më pak paragjyquese në marrjen e vendimeve se sa të gjitha institucionet e tjera, me përjashtim të avokatëve, të cilët në këtë front shiheshin pozitivisht nga klientët e tyre.
- **Gjetjet lidhur me komunikimin, respektin, dhe drejtësinë e paanshmërinë, flasin qartë për një përmirësim të ndjeshëm nga faza e parë në të dytën në këto aspekte të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.** Për shembull, 10,4% personave të anketuar në fazën e dytë thanë se nuk kishin pasur pothuaj asnjë mundësi të shprehin mendimet e tyre në ndërveprimet me institucionet ku ishin drejtuar, krahasuar me 29,3% në fazën e parë.
- **Arsyet për këtë duket se janë të shumta; një prej tyre mund të jetë se qytetarët në gjendje më të mirë ekonomike dhe më të arsimuar, që përbëjnë edhe pjesën dërrmuese të këtij grupi, trajtohen më mirë nga institucionet.** Një tjetër arsye është se ky përmirësim nga faza e parë vjen pjesërisht nga fakti që gjykatat dhe avokatët luajnë një rol më të madh në fazën e dytë. Për shembull, vetëm 6,9% e personave që iu drejtuan

gjykatave dhe 2,2% e atyre që iu drejtuan avokatëve mendonin se kishin pasur pak mundësi të shprehnin mendimet e tyre. Megjithatë, nuk është aq e lehtë të shpjegohet se pse qytetarët me nivel jo aq të lartë ekonomik dhe arsimor u trajtuan disi më mirë se më parë nga institucionet, si për shembull nga organet e qeverisjes vendore.

- **Kohëzgjatja mesatare e mosmarrëveshjeve gjatë fazës së dytë ishte 16 muaj**, ose katër muaj më pak se sa në fazën e parë. Proceset zgjasnin më shumë kur i mosmarrëveshjet i drejtoheshin qeverisë qendrore (2 vjet e 5 muaj), ndjekur nga gjykatat (2 vjet e tre muaj) dhe organet vendore (1 vit e 9 muaj).
- **Kostoja totale e procesit për qytetarët (tarifat e avokatëve, shpenzimet e udhëtimit dhe elementë të tjerë) u rrit ndjeshëm nga faza e parë në të dytën.** Ndërsa më se dy të tretat e personave të anketuar (68,8%) nuk patën ndonjë kosto gjatë fazës së parë të procesit, në fazën e dytë kjo shifër pothuaj u përgjysmua, me 34,3% të të anketuarve që nuk kishin pasur kosto. Përveç kësaj, për personat që kishin paguar, kostot janë më të larta: 38,8% kishin paguar nga 10 001 deri në 100 000 lekë (nga 11,9% në fazën e parë) dhe 7,3% kishin paguar më shumë se 100 000 lekë gjithsej (nga 5,4% në fazën e parë).
- **Kostot financiare ndryshonin shumë nga një institucion në tjetrin.** Paraqitja në gjykatë është e kushtueshme: 12,6% të personave që iu drejtuan gjykatës për mosmarrëveshjet e tyre ishte dashur të paguanin më shumë se 100 000 lekë. Marrja e një avokati po kështu kushton shumë: 6,7% e atyre që kishin marrë avokat, kishin paguar më shumë se 100 000 lekë.
- **Kjo tregon se vetëm personat me të ardhura të larta mund t'i përballojnë kostot e një avokati apo të paraqitjes në gjykatë. Personat me të ardhura të ulta nuk ishin në gjendje t'i siguronin këto shërbime, çka do të thotë se ata nuk kishin të njëjtat gjasa të mbeteshin të kënaqur apo të gjenin drejtësi për dëmet e pësuar.**
- **Në fazën e dytë, 7,9% e atyre që morën pjesë në këtë fazë dhe që i dhanë përgjigje kësaj pyetjeje (2,3% e kampionit të përgjithshëm të personave me mosmarrëveshje) thanë se u kishin paguar ryshfet institucioneve ose personave që ishin marrë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre.** Shuma më e madhe e paguar si ryshfet ishte 500 000 lekë.
- **Pothuaj një e katërta (24,4%) e personave të anketuar që morën pjesë në fazën e dytë arritën t'i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre.**
- **Të anketuarit kishin pasur më shumë sukses në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në gjykatë,** me 42,5% prej tyre që kishin gjetur zgjidhje atje. Përveç këtyre, 22,2% e atyre që kishin marrë avokat dhe 20% e atyre që i ishin drejtuar policisë, kishin arritur t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre.
- **Po kështu, sa më të larta të ardhurat e personit të anketuar, aq më të mëdha gjasat për ta zgjidhur mosmarrëveshjen edhe në këtë fazë: 37,5% e personave me të ardhura nga 50 001 deri në 100 000 lekë në muaj kishin pasur sukses në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, që përfaqëson përqindjen më të lartë për të gjitha nivelet e të ardhurave. Kjo vërteton më tej hipotezën se qytetarët në gjendje më të mirë ekonomike arrijnë rezultate më të mira në sistemin e drejtësisë. Kjo sepse ata kanë më shumë gjasa të përdornin shërbimet e gjykatave dhe avokatëve, që janë mjet më i drejtë dhe më i paanshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve se sa institucionet e tjera, si organet e qeverisjes vendore dhe qendrore.**
- **Nga ata që e përfunduan fazën e dytë, 36,4% thanë se kishin kërkuar ndihmë të mëtejshme nga një person ose institucion tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.** Personat që e kishin bërë këtë më shpesh kishin përfunduar studimet universitare dhe ishin nga Tirana.


## KAPITULLI 4.3 – FAZA E TRETË

Në këtë kapitull do të përqendrohemi tek ata personat të që vazhduan përpjekjet për të marrë drejtësi dhe për të gjetur zgjidhje mosmarrëveshjet e tyre pas fazës së dytë.

**Ndërsa 90,4% e personave me mosmarrëveshje nuk e 'arritën' këtë fazë, nga ata që e arritën, shumica dërrmuese i ishin drejtuar gjykatës (7,8%) për të pasur akses në drejtësi.** Kampioni për institucionet e tjera ishte tepër i vogël për të nxjerrë ndonjë përfundim, ndaj faza e tretë ka të bëjë në një masë të madhe me cilësinë, drejtësinë, koston dhe shpejtësinë së procedurave në gjykata.

Meqë rezultatet e fazës së tretë janë të ngjashme ato të të anketuarve që i ishin drejtuar gjykatës në fazën e dytë, do të paraqesim një version të shkurtuar të rezultateve, duke vënë në pah fushat ku kishte ndryshime të imta.

**Kujt tjetër i kërkuat ndihmë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (pas fazës së dytë)?**



### Komunikimi dhe respekti gjatë fazës së tretë

Komunikimi i hapur dhe respekti i treguar ndaj të anketuarve është shumë i ngjashëm me rezultatet e atyre që i ishin drejtuar gjykatës në fazën e dytë. Për shembull, vetëm (8,4%) e të anketuarve në fazën e tretë deklaruan se nuk kishin pasur pothuaj asnjë mundësi të shprehin opinionet e tyre kur ndërvepruan me institucionin të cilit iu drejtuan, ndërsa 54,2% thanë se kishin pasur mundësi të plotë.


### Drejtësia dhe paanshmëria e procesit

**Drejtësia dhe paanshmëria e procesit shënoi përmirësim të dukshëm:** 30,5% e të anketuarve që besonin se kjo fazë e procesit ishte shumë e padrejtë, krahasuar me 45,5% në fazën e dytë (dhe 64,2% në fazën e parë).

Personat e anketuar gjithashtu mendonin se rregullat ishin zbatuar në mënyrë të qëndrueshme, dhe **vetëm 4,9% thanë se ato ishin zbatuar në mënyrë krejtësisht të pabarabartë për palët (përkundër 8,6% në fazën e dytë dhe 24,1% në fazën e parë).**

Gjithashtu u shënuar **rënie edhe në përqindjen e të anketuarve që besonin se institucionet ishin paragjyquese dhe të njëanshme (10,8% në fazën e tretë, 17,5% në të dytën dhe 28,3% në të parën).**

Sipas mendimit tuaj, në ç'masë ishin paragjyqese dhe të njëanshme institucionet të cilave iu drejtuat?




### Koha e shpenzuar dhe kostot personale në fazën e tretë të procesit

Kohëzgjatja mesatare e mosmarrëveshjeve të paraqitura para gjykatave gjatë fazës së tretë ishte 17 muaj, njësoj sa edhe gjatë fazës së dytë.

### Kostot financiare të procesit dhe cilësia e shërbimit të ofruar

Kostoja totale e procedurave për qytetarët (tarifat e avokatëve, shpenzimet e udhëtimit dhe elementë të tjerë) u rrit në mënyrë të ndjeshme nga faza e dytë në të tretën. Ndonëse një përqindje e njëjtë e të anketuarve – gati një e treta – nuk patën asnjë shpenzim, kostot e personave që duhej të paguanin u rritën: 27,5% paguan nga 50 001 në 100 000 lekë (15,2% në fazën e dytë) dhe 15,7% paguan më shumë se 100 000 lekë në total (7,3% në fazën e dytë).

Sa para kushtoi kjo fazë në total?



## Korrupsioni

Në fazën e tretë, 14,9% e atyre që morën pjesë në këtë fazë dhe që iu përgjigjën kësaj pyetjeje (1,2% e kampionit të përgjithshëm të personave me mosmarrëveshje) deklaruan se u kishin paguar ryshfet institucioneve dhe personave të përfshirë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre.

Nga këta, 9% (gjashtë persona) thanë se kishin paguar nga 20 001 deri në 100 000 lekë dhe 4,5% (tre persona) thanë se kishin paguar më shumë se 100 000 lekë (shuma më e madhe e regjistruar e dhënë si ryshfet ishte 700 000 lekë). Të gjitha këto ryshfete iu ishin paguar gjykatave.

## Rezultatet e fazës së tretë

Mbi dy të pestat (42,7%) e të anketuarve që morën pjesë në fazën e tretë i zgjidhën mosmarrëveshjet e tyre (një rritje e konsiderueshme nga 24,4% në fazën e dytë dhe 13,7% në fazën e parë). Të gjitha këto mosmarrëveshje u zgjidhën në gjykatë.

## GJETJET KRYESORE lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fazën e tretë

Rezultatet tregojnë se:

- Pothuaj që të gjithë personat që vazhduan në fazën e tretë iu drejtuan gjykatës. Këta persona zakonisht kishin të ardhura të larta dhe arsim të lartë.
- Megjithëse romët, personat me nivel më të ulët arsimor dhe me të ardhurat më të ulëta, përsëri kishin rezultatet më të ulta për sa i përket komunikimit, respektit dhe drejtësisë, në fazën e tretë këto rezultate ishin disi më të mira se në fazën e dytë.
- Pati një përmirësim të ndjeshëm në drejtësinë dhe paanshmërinë e procesit, edhe në krahasim me fazën e dytë.
- Megjithatë, kostoja totale e procedurave për qytetarët (tarifat e avokatëve, shpenzimet e udhëtimit dhe elementë të tjerë) u rrit në mënyrë të konsiderueshme nga faza e dytë në të tretën.
- 14,9% e atyre që morën pjesë në këtë fazë deklaruan se kishin paguar ryshfet.
- 42,7% e të anketuarve që morën pjesë në këtë fazë i zgjidhën mosmarrëveshjet e tyre.
- Individët që këmbëngulën (duke pasur burime të mjaftueshme financiare, kohë apo mundësi të tjera) të gjenin zgjidhje për mosmarrëveshjet dhe, duke perifrastuar një term ligjor, që kërkuan "t'i shteronin të gjitha mjetet juridike", gradualisht arritën një sistem më të mirë dhe më shumë akses në drejtësi.




## KAPITULLI 4.4 – REZULTATET PËRFUNDIMTARE

Pjesëmarrësve në studim iu bënë pyetje për disa nga karakteristikat e rezultateve përfundimtare të mosmarrëveshjeve të tyre. **Çështja e parë për të cilën u pyetën ishte drejtësia dhe paanshmëria e rezultatit përfundimtar** (rezultatet në kapitujt e mësipërm kanë të bëjnë më tepër me drejtësinë dhe paanshmërinë e procesit se sa me atë të rezultatit).


Rezultatet tregojnë se **vetëm 21,8% e personave të anketuar mundën t'i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre**. Rezultatet tregojnë se **43% e të anketuarve besonin se përfundimi ishte shumë i padrejtë**. Kjo është veçanërisht e vërtetë për ata me të ardhura më të ulta (66,7% e atyre me të ardhura nga 2 001 në 5 000 lekë), me nivel më të ulët arsimor (60% e atyre me arsim fillor të papërfunduar, përkundër 40,5% të atyre me arsim universitar), **anëtarët të komunitetit rom (70,6%) dhe banorët e Tiranës (49,1%)**.

### Në ç'masë besoni se vendimi përfundimtar për mosmarrëveshjen tuaj ishte i drejtë?




Rezultati përfundimtar rivendosi plotësisht gjendjen fillestare të **23,8% të personave të anketuar**, ndërsa nuk rivendosi gjendjen e **40,5% të tyre**. Përsëri, ishin ata me **kualifikime më të ulta arsimore** (55% e atyre me arsim fillor të papërfunduar), **anëtarët e komunitetit rom (64,7%)**, personat **me të ardhura më të ulta** (72,2% e atyre me të ardhura nga 2 001 deri në 5 000 lekë në muaj) dhe **banorët e Tiranës (49,7%)** që kishin mbetur më të pakënaqur.


### Vendimi përfundimtar rivendosi plotësisht gjendjen time fillestare



## Vendimi përfundimtar rivendosi plotësisht gjendjen time fillestare - PLOTËSISHT




## Vendimi përfundimtar nuk rivendosi gjendjen time fillestare




Vendimi përfundimtar u ishte shpjeguar qartë 40,6% të anketuarve, ndërsa gati një e katërta (24,8%) mendonin se shpjegimi kishte qenë i dobët. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë për anëtarët e komunitetit rom (52,9%), personat me nivel arsimor më të ulët (35% e atyre me arsim fillor të papërfunduar, përkundër 18,3% të atyre me arsim universitar), ata me paga më të ulta (50% e atyre me të ardhura nga 2 001 në 5 000 lekë në muaj, krahasuar me 10% e atyre me të ardhura nga 50 001 në 100 000 lekë) dhe banorët e Tiranës (31,9%).

## Vendimi përfundimtar m'u shpjegua plotësisht

### Niveli arsimor




### Të ardhurat mujore në lek




Rezultatet tregojnë se **më pak se gjysma e vendimeve përfundimtare janë zbatuar plotësisht (45,3%), ndërsa gati një e katërta (25,6%) nuk janë zbatuar aspak**. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë për romët, 44,1% e të cilëve thanë se vendimet përfundimtare në rastet e tyre nuk ishin zbatuar aspak. Kjo ishte gjithashtu e vërtetë për personat me të ardhura më të ulta dhe me kualifikime arsimore më të ulta. Mungesa e zbatimit shtrihet gjithashtu edhe tek disa prej personave që kishin përfituar kompensim ose zhdëmtim: me fjalë të tjera, ndonëse 34,7% e atyre që kishin kërkuar kompensim ose zhdëmtim e kishin fituar atë, vetëm 9,5% e kishin marrë atë të plotë.

**Vendimi përfundimtar nuk është zbatuar aspak**



**Vendimi përfundimtar nuk është zbatuar aspak**



Një ndër njëzet (5%) persona që dhanë përgjigje, ose 1,8% e kampionit total, kishin bërë pagesa shtesë për të siguruar zbatimin e vendimit. Pagesa më e lartë e shënuar ishte 100 000 lekë.

## KAPITULLI 4.5 – PËRMBLEDHJE E TRAJKTOREVE TË NDJEKURA PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE

Rrjedhojat kryesore nga rezultatet e studimit përshkruar në kapitujt pararendës janë si vijon:

- 1) **Përpyekjet e qytetarëve shqiptarë për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet janë kryesisht të pasuksesshme – vetëm 21,8% e personave të anketuar arritën t'i zgjidhnin ato. Përveç kësaj, 43% e të anketuarve – dhe shumica e personave me të ardhura të ulta, ata me nivel të ulët arsimor dhe anëtarët e komunitetit rom, mendojnë se rezultatet e procesit ishin shumë të padrejta. Faktorët e mëposhtëm përbëjnë pengesë për qytetarët shqiptarë që përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre:**
  - a) Komunikimi i dobët dhe qëndrimi jo i hapur;
  - b) Mungesa e respektit për ta nga ana e institucioneve dhe punonjësve në sistemin e drejtësisë;
  - c) Mungesa e drejtësisë dhe paanshmërisë si në proces ashtu edhe në rezultat;
  - d) Kostoja e lartë e aksesit në një shërbim me cilësi më të mirë dhe më të drejtë – si në gjykata;
  - e) Koha e gjatë që kërkohet për të pasur akses në drejtësi.

Të gjitha këto çështje duhet të gjejnë zgjidhje që shqiptarët të kenë mundësi të vërteta për të pasur akses në drejtësi përmes sistemit formal dhe informal të drejtësisë. Ato mund të trajtohen gjatë reformimit të sistemit të drejtësisë, si përmes forcimit të sistemit të ndërmjetësimit për t'i nxitur qytetarët t'i zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore.


- 2) **Zgjidhja e një mosmarrëveshje në mënyrë të drejtë e të paanshme kërkon këmbëngulje dhe xhepin plot.** Në pjesën dërrmuese të rasteve, përpyekjet e para të shumë shqiptarëve për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet duke iu drejtuar qeverisë vendore ishin të pakënaqshme. Zakonisht, ata që nuk kanë sukses, heqin dorë në këtë fazë, ndërsa individët me të ardhura më të larta kanë më shumë gjasa të vazhdojnë dhe t'i zgjidhin me sukses mosmarrëveshjet e tyre. Pra, në thelb, "sa më larg të shkosh në sistemin e drejtësisë, aq më mirë do të dalësh", sepse duhet të arrish deri tek sistemi gjyqësor për arritur një farë niveli kënaqësie me shërbimin. Megjithatë, kjo kërkon ta kesh xhepin plot për të paguar kosto si tarifat e avokatëve dhe ato gjyqësore, që është arsyeja pse shumë individë asnjëherë nuk arrijnë të kenë akses me plot kuptimin e fjalës në drejtësi.
- 3) **Mundësitë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë të drejtë janë ndjeshëm më të ulta për katër grupe: personat me të ardhura më të ulta, me nivel arsimor më të ulët, romët dhe banorët e Tiranës.** Përkatësia në njërin prej këtyre grupeve është pengesë për të pasur akses në drejtësi në Shqipëri. Përkatësia njëkohësisht në një apo më shumë prej këtyre grupeve përbën pengesë të konsiderueshme dhe gjasat janë që nevojat për drejtësi të këtyre personave të mbeten të paplotësuara.
- 4) **Ka mangësi të mëdha në njohuritë dhe njohjen e ligjit, çka i pengon shqiptarët të kenë akses në drejtësi.** Nëse dikush nuk e di çfarë thuhet në ligj, atëherë ai ose ajo as nuk mund ta perceptojë se mund të kërkojë një të drejtë. Nëse dikush nuk e di si funksionon ligji, atëherë nuk do të dijë as se kujt t'i drejtohet për ta kërkuar një të drejtë të caktuar. Ndaj është shumë e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi për ligjin tek popullata në përgjithësi, dhe tek katër grupet e sipërpërmendura në veçanti. **Është gjithashtu shumë e rëndësishme që këto mangësi në njohuritë për ligjin të korrigjohen përmes zbatimit të një sistemi të ndihmës juridike të përbalueshëm nga pikëpamja financiare.** Rezultatet e mësipërme tregojnë se, ndonëse të anketuarit ishin në përgjithësi të kënaqur me cilësinë e përfaqësimit ligjor që kishin marrë, kostot e sigurimit të një avokati apo për të kërkuar drejtësi në gjykatë mund ta përballonin vetëm personat me të ardhura më të larta. Kjo duhet të ndryshojë – përmes zbatimit të një sistemi gjithëpërfshirës të ndihmës juridike – për të garantuar kushte të barabarta veprimi dhe barazi të forcave.
- 5) **Rezultatet e studimit sasiore theksojnë nevojën e krijimit të një sistemi parësor të ndihmës juridike me cilësi të lartë dhe të aksesueshëm nga të gjithë qytetarët.** Kjo do t'i barazonte kushtet, të paktë deri në një farë mase, për anëtarët e grupeve të pafavorizuara. Megjithatë, kërkohet një sistem efektiv ndihme juridike, i cili të veprojë në mënyrë pro-aktive për të arritur tek përfuturit, sepse gjetjet tregojnë që njerëzit me mjete më të pakta financiare janë mësuar dhe piren t'u drejtohen drejtpërsëdrejti autoriteteve, pa kërkuar asistencën ligjore që ekziston.



# AKSESI NË DREJTËSI PËR GRUPET E PAFAVORIZUARA

Ky kapitull përqendrohet në përvojat e disa grupeve të veçanta të pafavorizuara lidhur me aksesin në drejtësi. Ashtu siç u shpjegua në hyrje, instrumenti kryesor i përdorur në studim – pyetësi që u përdor me 1758 persona në të gjithë Shqipërinë – nuk ishte i mjaftueshëm për të kuptuar përvojat e grupeve të veçanta që mund të jenë të vogla në numër, që mund të ngurrojnë t'i diskutojnë problemet e tyre me anketues anonimë, apo që mund të jetë e vështirë të kontaktohen.

Si rezultat, ekipi kërkimor përzgjodhi disa grupe të caktuara me këto karakteristika dhe përdori instrumente kërkimore shtesë, si intervistat dhe grupet e fokusit, për të kuptuar më mirë vështirësitë me të cilat përballen ato zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe përdorimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.





## KAPITULLI 5.1 – POPULLATA LGBTI

Popullata LGBTI përballet me pengesa të panumërta në aksesin e saj në drejtësi. Një nga më të rëndësishmet është mungesa e mbrojtjes nga dhuna e përhapur dhe sistematike nga organet e policisë dhe sistemi i drejtësisë. Anëtarët e komunitetit LGBTI shprehin fuqimisht bindjen e tyre se po persekutohen nga drejtoritë e policisë të cilat ose nuk duan t'ia dinë për fatin e tyre, ose janë haptazi armiqësore ndaj tyre.

Të intervistuarit dhe pjesëmarrësit në grupet e fokusit sollën shembuj të panumërt **se si ishin trajtuar në mënyrë joprofesionale, të paligjshme, dhe degraduese nga policia**. Për shembull, një pjesëmarrës në një grup fokusi në Tiranë tha:

*“Drejtoritë e policisë na persekutojnë. Ata [punonjësit e policisë] na shohin sikur të jemi krijesa të ndryshme. Edhe kur mundohen të na marrin me të mirë, nuk bëjnë asgjë. Ka pasur madje raste kur u kanë thënë autorëve “Bravo ju qoftë për atë që keni bërë.””<sup>26</sup>*

Një tjetër anëtar në të njëjtin grup fokusi tregoi një histori kur punonjësit e policisë e kishin shpëtuar nga një rrahje e mundshme, por më vonë ai kishte parë si oficerët e policisë i nxisnin agresorët, gjë që e bëri të humbte besimin tek forca e policisë:

*Shkova në drejtorinë e policisë për t'u ankuar se pata një grindje me gjashtë djem. Po kthehesha në shtëpi dhe ata më bërtitën. U nxeha dhe ngrita gishtin e mesit. Dy nga ata u bënë gati të më rrihnin, por pata shumë fat se patrulla e policisë ishte shumë afër. Shkova në stacionin e policisë për të dhënë dëshmi dhe kur po dilja nga policia dëgjova një nga policët që u thoshte atyre që kishin dashur të më rrihnin: “Mos u mërzisni; mirë ia bëtë. Duhet të vini në deklaratë se ishit të dehur dhe kjo mund të përdoret si justifikim për veprimet tuaja”. U trondita shumë dhe që atëherë nuk kam më besim tek punonjësit e policisë.”<sup>27</sup>*

Pjesëmarrës të tjerë konfirmuan se **punonjësit e policisë e kanë zakon t'i poshtërojnë anëtarët e komunitetit LGBTI** që denoncojnë raste të dhunës ose kanosjes me dhunë. Nga përvoja e tyre, ata që duan të bëjnë ankim ose të ngrenë padi për vepër penale shpesh nuk merren seriozisht: *“Nëse shkon në drejtorinë e policisë, ata fillojnë të tallen me ty.”*<sup>28</sup> Të tjerë thonë se policia është e ngadaltë dhe aspak e gatshme të përgjigjet ndaj ankesave:

*“Si ka mundësi që, kur njerëzit ankohen për ne, policia reagon menjëherë dhe kur ankohemi ne, nuk vjen asnjë? Pse përdor policia standarde të dyfishta? [Me ton të ngritur]”<sup>29</sup>*

**Trajtimi që i bën policia i punëtorëve të seksit dhe transseksualëve është edhe më brutal.** Ata jo vetëm injorohen ose poshtërohen, siç ndodh shpesh me personat gei dhe biseksualë, por ndonjëherë janë edhe vetë viktimat e dhunës policore: *“Po ecja në rrugë dhe policët më kërkuan kartën e identitetit. Njëri nga policët e pa kartën dhe nuk besonte se isha unë. Më çoi në stacionin e policisë dhe më mbajti në stacion për dy orë dhe u tall me mua. Hahaha, qeshnin. Më pyetën: Burrë je ti? Njëri nga policët tha: “E ke gjoksin më të madh se timin.” Kur më liruan njëri nga oficerët tha: “Ik qërohu, pederast, ndyrësirë.””<sup>30</sup>*

Personave LGBTI **shpesh u shkelet e drejta e privatësisë, si mënyrë për t'i bindur të heqin dorë** nga aktivizmi dhe që të mos vazhdojnë më tej me ankesat e tyre. Policët *“i nxjerrin të dhënat e tua në media; nuk e çajnë kokën se ke një familje që mund të lëndohet nga ky informacion”*.<sup>31</sup> Siç deklaroi një person tjetër LGBTI, *“Sa më të dukshëm jemi, aq më shumë dhunë*

26. Grup fokusi me persona LGBT tek Aleanca; Tiranë, 23 shkurt 2017.

27. Po aty.

28. Po aty.

29. Po aty.

30. Po aty.

31. Grup fokusi me persona LGBT tek Aleanca; Tiranë, 23 shkurt 2017.



pësojmë. Nëse më del emri dy herë në media, nuk më jep njeri shtëpi me qira.”<sup>32</sup>

Një praktikë tjetër e zakonshme që theksohet nga të intervistuarit nga komuniteti LGBTI është **fajësimi i viktimës** nga persona si punonjësit e policisë. Një anëtar në një grup fokusi solli një shembull. Kur kishte bërë denoncimin e një sulmi fizik në polici, polici e kishte pyetur:

“Pse vishesh kështu? Unë i thashë: ‘Shih punën tënde. Unë vishem si të dua.’ Pastaj ai tha: ‘po u veshe kështu, duhet të marrësh parasysh pasojat. Do të të rrahin njerëzit.’”<sup>33</sup>

Këto qëndrime diskriminuese të shfaqura nga policia janë të përhapura në sistemin e drejtësisë dhe në shoqëri në përgjithësi. Një nga personat e intervistuar tha: “institucionet dhe aktorët institucionalë janë homofobikë”,<sup>34</sup> ndërsa një tjetër e diagnostikoi homofobinë si një problem të shoqërisë: “diskriminimi është i institucionalizuar; ai gjendet kudo.”<sup>35</sup> Për shembull, diskriminimi i personave LGBTI për sa i përket strehimit është mjaft i përhapur. Pronarët “i refuzojnë personat transgjinjorë” që aplikojnë për shtëpi.<sup>36</sup>

Qëndrime të tilla, si në sistemin e drejtësisë ashtu edhe në mbarë shoqërinë, **i dekurajojnë qytetarët LGBTI nga përdorimi i sistemit të drejtësisë** për të mbrojtur të drejtat e tyre. Një nga pjesëmarrësit reflektonte kështu:

“Një herë gati sa s’më vranë tre persona që po ngisnin një makinë. Më goditën dhe më pështynë në fytyrë. Ku mund të shkoja për ndihmë?”<sup>37</sup>

Për personat LGBTI që nuk i ndihmon policia, rrallëherë ka rrugë të tjera për të kërkuar drejtësi. Rrjetet e tyre mbështetëse janë të kufizuara dhe shoqëria dhe familja shpesh nuk i pranojnë: “Nëse policët nuk reagojnë, nuk bëjmë dot asgjë. Familja nuk të ndihmon; as shoqëria.”<sup>38</sup>

Anëtarët e komunitetit LGBTI rrallë ngrenë padi në gjykatë, sepse besojnë që diskriminimi ndaj tyre është shumë i përhapur tek avokatët dhe gjykatësit. Si rezultat i barrierave të ndryshme me të cilat përballen personat LGBTI që janë viktimat të dhunës:

“Ligji është gjëja e fundit që iu shkon ndër mend. Ata nuk kanë informacion të mjaftueshëm [për të përdorur ligjin ose institucionet e drejtësisë në mënyrë efikase]. Gjithashtu, ata nuk e kuptojnë diskriminimin. Ata mund të thonë ‘më foli shumë keq’, por nuk e denoncojnë personin që i ka diskriminuar.”<sup>39</sup>

Përveç këtyre, qytetarët LGBTI **përballen edhe me pengesat e tjera të zakonshme për individë të tjerë që duan të përdorin sistemin e drejtësisë**. Ato përfshijnë:<sup>40</sup>

- **Kostot e larta gjyqësore dhe tarifatat e larta** për ekspertët, që personat e pafavorizuar ekonomikisht nuk mund t’i përballojnë.

- **Mungesa e një sistemi funksional të ndihmës juridike**. Kjo ndikon veçanërisht tek qytetarët dhe anëtarët e komunitetit LGBTI jashtë Tiranës, sepse në Tiranë të paktën ka disa grupe të shoqërisë civile që mund t’i ndihmojnë (me gjithë burimet e kufizuara).

32. Po aty.

33. Po aty.

34. Intervistë me PRO LGBT dhe Aleancën kundër diskriminimit të LGBT; Tiranë, 1 mars 2017.

35. Intervistë me një punonës të Strehës LGBT; Tiranë, 27 shkurt 2017.

36. Intervistë me Gruaja tek Gruaja; Shkodër, 3 mars 2017.

37. Po aty.

38. Po aty.

39. Intervistë me një punonës të Strehës LGBT; Tiranë, 27 shkurt 2017.

40. Intervistë me një ofrues të ndihmës ligjore; Tiranë, 31 mars 2017. Intervistë me juristë të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare (QNLQ); Tiranë, 4 prill 2017. Intervistë me avokatët në Res Publica; Tiranë, 13 prill 2017.

- **Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore** shpesh ndikon që anëtarët e komunitetit LGBTI dhe të tjerë viktime të dhunës të mos e përdorin sistemin e drejtësisë.

- **Perceptimi se sistemi i drejtësisë është i korruptuar** dhe i hapur ndaj ndikimeve të jashtme (siç u dokumentua në gjetjet e komponentit sasior të studimit).

## Gjetjet kryesore për aksesin në drejtësi të personave LGBTI

### Studimi tregon se:

- Për shkak të diskriminimit të përhapur ndaj komunitetit LGBTI, si në sistemin e drejtësisë ashtu edhe në mbarë shoqërinë, **komuniteti LGBTI nuk mund t'i përdorë shërbimet e sistemit të drejtësisë ose të ushtrisë të drejtat e veta sipas ligjit.**
- **Personat LGBTI nuk mbështeten tek policia për të gjetur mbrojtje nga dhuna sistematike.** Kjo ndodh për shkak të vetë praktikave dhe qëndrimeve diskriminuese të policisë, dhe të trajtimit që ajo i bën personave LGBTI, që ndonjëherë mund të përfshijë edhe nxitjen ose përdorimin e dhunës nga vetë policia.
- **Trajtimi i punëtorëve të seksit dhe transseksualëve nga policia është edhe më brutal se trajtimi që ajo i bën personave të tjerë LGBTI.**
- **Duhet të ndryshojnë qëndrimet dhe praktikave të policisë dhe të aktorëve të tjerë në sistemin e drejtësisë që personat LGBTI të gëzojnë të drejtat e tyre të garantuara në kushtetutë.**

### Sugjerime për masa që mund të përmirësojnë aksesin e personave LGBTI në drejtësi

- **Fuqizimi i sistemit të ndihmës ligjore;** sistemi i tanishëm është i papërshtatshëm dhe nuk ka ofruar asistencë efektive ligjore për grupet e varfëra dhe të pafavorizuara, si anëtarët e komunitetit LGBTI.
- **Rritja e ndërgjegjësimit të punonjësve të sistemit të drejtësisë (avokatëve, gjykatësve, oficerëve të policisë, prokurorëve dhe të tjerëve) për të drejtat e LGBTI.** Këto diskutime duhet ta zgjerojnë fokusin e tyre nga liria e tubimit dhe e organizimit në të drejta të tjera të komunitetit LGBTI (të drejtat e punës dhe punësimit, e drejta për strehim, mos-diskriminimi, dhe të tjera) që shkelen sistematikisht.
- **Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit LGBTI për të drejtat e tyre dhe se si të kenë akses në to.**

## KAPITULLI 5.2 – PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Personat me aftësi të kufizuara përballen me një gamë të gjerë pengesash që nuk i lejojnë të gëzojnë të drejtat e tyre kushtetuese në nivel të barabartë me pjesën tjetër të popullatës.

Ata e pranojnë edhe vetë se **nuk janë të mirë-informuar** për të drejtat e tyre sipas ligjit. Ndërsa disa kanë dijeni për legjislacionin lidhur me përfitimet financiare, ata nuk janë të mirë-informuar për të drejtat të tjera, si mos-diskriminimi, e drejta e arsimimit, e drejta e aksesit, dhe të tjera. Është e kuptueshme që kjo e bën shumë të vështirë ngritjen e ndërgjegjësimit për ligjin dhe të drejtat e tyre në bazë të tij.

Besohet gjithashtu se edhe **autoritetet nuk i zbatojnë të drejtat e tyre, sepse nuk e njohin mirë legjislacionin lidhur me aftësitë e kufizuara**. Për shembull, një anëtar i një grupi fokusi kishte të drejtën, sipas ligjit, të mos paguante tarifat në universitetin e tij, por personeli i universitetit, që nuk kishte dijeni për dispozitat përkatëse, nuk e kishte njoftuar për këtë.<sup>41</sup> Për më tepër, ligji shqiptar nuk e njeh dëmtimin e dëgjimit si një formë të aftësisë së kufizuar për qëllimet e përfitimit të ndihmës sociale.<sup>42</sup> Si rezultat, personat me dëmtim të dëgjimit nuk kanë përfituar nga skemat financiare dhe shërbime të tjera që u ofrohen personave me lloje të tjera aftësish të kufizuara.

Personat me aftësi të kufizuara kanë plot vështirësi dhe përvoja negative me sistemin e drejtësisë, ku aftësia kufizuar ka luajtur një rol të rëndësishëm.

**Një vështirësi që përmendet shpesh lidhur me aksesin në drejtësi është mungesa e aksesueshmërisë fizike** në infrastrukturën e gjykatave dhe ndërtesave të tjera për personat me aftësi të kufizuara fizike. Pjesëmarrësit treguan shembuj kur pjesëtarë të familjes ishin detyruar t'i ngrinin në krahë për t'i futur në ndërtesat e gjykatave, çka i kishte bërë të ndiheshin të poshtëruar dhe jo të mirëpritur. Kjo i ka bërë shumë persona me aftësi të kufizuara të heqin dorë nga përdorimi i sistemit të drejtësisë, duke i privuar kështu nga mundësia për të kërkuar dhe gjetur drejtësi. Ndër vështirësitë e tjera përfshihen disa që hasen shpesh edhe nga anëtarët e grupeve të tjera të pafavorizuara:

- **Mungesa e ndihmës ligjore falas** për proceset civile dhe administrative për personat me aftësi të kufizuara. Edhe në proceset penale, kur personat me aftësi të kufizuara përfitojnë përfaqësim ligjor falas, "avokatët e tyre nuk e njohin legjislacionin dhe kërkesat specifike për përshtatjen e arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara."<sup>43</sup>
- **Mungesa e besimit në sistemin e drejtësisë nga personat me aftësi të kufizuara**, që rrjedh nga moskuptimi i vështirësive të tyre nga sistemi gjyqësor dhe institucionet e tjera, së bashku me mjedisin jo mikpritës në këto institucione, çka nuk ndihmon në krijimin e besimit.
- **Kostot e larta gjyqësore, përfshirë tarifat për noterët dhe ekspertët**, që i dekurajojnë personat me aftësi të kufizuara, të cilët shpesh kanë burime të kufizuara, të kërkojnë drejtësi në gjykatë. Këtu përfshihet shembulli i një personi me aftësi të kufizuara i përfaqësuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, i cili u përjashtua nga pagimi i shpenzimeve të gjykatës, por nuk mund të përballonte pagesën e ekspertit prej afërsisht 800 euro dhe iu desh të merrte hua për të financuar çështjen e tij.<sup>44</sup>
- Punonjësit e **sistemit gjyqësor shqiptar i shohin personat me aftësi të kufizuara "si raste bamirësie, dhe jo sipas qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të**

41. Grup fokusi me personat me aftësi të kufizuara; Tiranë, 31 mars 2017.

42. Është miratuar një ligj i ri në përputhje me Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara që i njeh personave me dëmtim të dëgjimit se kanë aftësi të kufizuara për qëllimet e përfitimit të ndihmës sociale; megjithatë, këto dispozita ende nuk po zbatohen në praktikë.

43. Intervistë me Fondacionin Shqiptar të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, Tiranë, 24 shkurt 2017.

44. Po aty.

**Kufizuara.**<sup>45</sup> Ky lloj trajtimi shkel dinjitetin e personave me aftësi të kufizuara të cilët "nuk duan bamirësi dhe solidaritet – ata duan që gjyqësori të garantojë të drejtat e tyre të njeriut siç njihen nga Shteti."<sup>46</sup>

**Personat me aftësi të kufizuara me dëmtim të dëgjimit** përballen me një varg vështirësish të tjera për aksesin në drejtësi. Deri para ndryshimeve të kohëve të fundit në Kodin e Procedurës Penale, miratuar në maj 2017, gjatë procedurave penale shteti nuk garantonte përdorimin e gjuhës së shenjave, të drejtën për një përkthyes të gjuhës së shenjave, si dhe nuk mbulonte pagesat për përkthyesit.<sup>47</sup> Këto të drejta ende nuk garantoohen në procedurat civile. Kjo ua vështirëson shumë jetën personave me dëmtim të dëgjimit, 98% e të cilëve janë analfabetë ose kanë aftësi shumë të kufizuara në shkrim dhe lexim.<sup>48</sup>

Përvojat e personave me aftësi të kufizuara me dëmtim të dëgjimit ilustronë vështirësitë që hasin personat me aftësi të kufizuara për të pasur akses në drejtësi. Një anëtar i grupit të fokusit tregon se kishte shkuar,

*"tek autoritetet bashkiake në Sarandë, por komunikimi me ta ishte i vështirë ose gati i pamundur. Asnjë nuk mund të më ndihmonte në komunikim përveç prindërve të mi, por unë konfliktin e kisha me ta, kështu që s'kishte si të më ndihmonin. Po kështu, unë di shumë pak shkrim e lexim, kështu që nuk mund t'i përdorja si mjet komunikimi."<sup>49</sup>*

Një pjesëmarrëse në grupin e fokusit tregoi për një përvojë kur familja e saj, të cilët të gjithë nuk dëgjojnë, mori pjesë në një seancë gjyqësore gjatë të cilës asnjë prej tyre nuk kuptonte çfarë po thuhej, çka praktikisht i kualifikoi ata nga procesi gjyqësor.<sup>50</sup> Një pjesëmarrës tjetër që ishte dënuar disa herë për vjedhje tha se,

*"vetëm një herë, para disa vitesh, më ofruan përkthyes të gjuhës së shenjave për të më ndihmuar në procesin gjyqësor. Më kërkuan të firmos dokumente që as nuk i kuptoja dhe mora pjesë në procedura gjyqësore ku nuk merrja vesh asgjë çfarë thonin gjyqtarët dhe prokurorët."<sup>51</sup>*

Barriera ligjore ndaj aksesit në drejtësi ekzistojnë edhe për personat me aftësi të kufizuara mendore dhe intelektuale.<sup>52</sup> Konkretisht, ligji shqiptar përmban dispozita që lejojnë heqjen e kapacitetit ligjor të këtyre personave; megjithatë, mbrojtësit e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara thonë se këto dispozita të ligjit shqiptar, si ato në Kodin Civil dhe në Kodin e Procedurës Civile nuk janë në përputhje me Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara që konsideron se dispozitat për heqjen e kapacitetit ligjor të personave me dëmtim mendor dhe të dëgjimit janë në kundërshtim me të drejtën për barazi para ligjit. Këto dispozita krijojnë barriera serioze për aksesin në drejtësi të kësaj kategorie njerëzish.

45. Po aty.

46. Po aty.

47. Këto të drejta tani parashikohen në nenin 8 të Kodit të Procedurës Penale.

48. Intervistë me Shoqatën Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë; Tiranë, 27 shkurt 2017.

49. Grup fokusi me persona me aftësi të kufizuara me dëmtim të dëgjimit, Tiranë, 9 mars 2017.

50. Po aty.

51. Po aty.

52. Grup fokusi me personat me aftësi të kufizuara; Tiranë, 31 mars 2017.

## Gjetjet kryesore lidhur me aksesin në drejtësi të personave me aftësi të kufizuara

### Studimi tregon se:

- **Personat me aftësi të kufizuara nuk janë të mirë-informuar për të drejtat e tyre**, çka përbën një pengesë serioze për përpjekjet e tyre për të pasur akses në drejtësi.
- **Shpesh edhe autoritetet janë po aq të keqinformuara për ligjin** dhe nuk i njohin të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë pagesat e ndryshme dhe përfitimet e tjera sociale që u takon të marrin.
- **Mungesa e aksesit në infrastrukturë** përbën një pengesë të konsiderueshme për aksesin në drejtësi; po kështu edhe **mungesa e besimit të personave me aftësi të kufizuara në sistem**, si dhe **kostot e larta gjyqësore**.
- Grupe të caktuara personash me aftësi të kufizuara përballen me vështirësi edhe më të mëdha. Këtu përfshihen **personat me dëmtim të dëgjimit** të cilët thonë se kanë vështirësi në ndjekjen e procedurave gjyqësore, aksesin në dokumentacione zyrtare (për shkak të nivelit të lartë të analfabetizimit në radhët e tyre) dhe një varg problemesh të tjera; si edhe personat të cilëve iu është hequr kapaciteti ligjor në kundërshtim me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në të cilën Shqipëria është palë që në vitin 2012.

### Sugjerime për masat që do të përmirësonin aksesin në drejtësi të personave me aftësi të kufizuara

- Rritja e ndërgjegjësimit të komuniteteve të personave me aftësi të kufizuara për të drejtat e tyre dhe legjislacionin ekzistues.
- Rritja e ndërgjegjësimit të punonjësve të sistemit të drejtësisë për legjislacionin përkatës dhe masat e përshtatshme që duhen marrë për t'i bërë procedurat gjyqësore të aksesueshme. Këto përpjekje duhet të kenë si grupe të synuara gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe administratën. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara duhet të përfshihen në programin mësimor të magjistratëve në Shkollën e Magjistraturës.
- Realizimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore për të siguruar përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar me KNDPAK, si ndryshime në Kodin Civil lidhur me heqjen e kapacitetit ligjor të personave me aftësi të kufizuara.
- Përdorimi i gjuhës së shenjave në procedurat gjyqësore.

## KAPITULLI 5.3 – VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE

Viktimat e dhunës në familje përballen me vështirësi të panumërta lidhur me aksesin e tyre në drejtësi.

Një prej tyre, që u theksua në mënyrë të përsëritur në intervistat dhe grupet e fokusit, është se **viktimave të dhunës në familje shpesh u mungojnë mjetet ekonomike**. Siç u shpreh një aktiviste, *“Gratë kanë të ardhura të ulta prandaj nuk i sjellin çështjet e tyre (të dhunës në familje) në gjykatë.”*<sup>53</sup>

Duke mos pasur fonde të mjaftueshme, viktimat nuk mund të jenë ekonomikisht të pavarura dhe, për pasojë, e kanë të vështirë t’u shkojë ndër mend që t’u ikin abuzuesve të tyre. Përveç kësaj, kjo mungesë mjetesh ekonomike mund t’i bëjë viktimat e dhunës në familje të mos jenë në gjendje të financojnë kostot ligjore të llojeve të ndryshme dhe, si rezultat, gjasat janë më të mëdha që ato të vuajnë pafundësisht dhe të mos i përdorin shërbimet e sistemit të drejtësisë.<sup>54</sup> Vendimi për të bërë padi bëhet edhe më i vështirë nga ngadalësia e sistemit gjyqësor.

Gjithashtu, viktimat shpesh **nuk kanë informacion për të drejtat që u takojnë sipas ligjit dhe për funksionimin e sistemit të urdhrave të mbrojtjes – ndonëse ligji thotë se ato duhet të marrin informacion** nga autoritetet ligjzbatuese mbi statusin e tyre ligjor si viktimat, si dhe për shërbimet e ndryshme që u takojnë të marrin.<sup>55</sup> Siç u shpreh një psikologe, *“Gratë nuk i njohin të drejtat e tyre. Atyre u mungon informacioni. Ato e firmosin urdhrin e mbrojtjes pa e lexuar.”*<sup>56</sup> Një nga viktimat e intervistuar për këtë studim tha se, kur më në fund vendosi të mos e durojë më dhunën e ushtruar nga burri i saj (pasi ai e kishte lënë pa ndjenja), ajo *“nuk kishte asnjë lloj informacioni”* se çfarë hapash ligjorë të ndërmerre.<sup>57</sup> Në fund ajo kishte kërkuar ndihmë nga një OJQ e specializuar në fushën e ndihmës për viktimat e dhunës në familje.

Po kështu, edhe një viktimë tjetër tha se nuk dinte ku të kërkonte ndihmë. *“Madje as nuk e dija se ekzistojnë masa që mund të merren nga autoritetet shtetërore për të mbrojtur gra si unë nga dhuna në familje.”*<sup>58</sup> Pas ca kohësh, i vëllai kishte mbledhur informacione që i dhanë mundësi të gjente strehë për vete dhe fëmijët e saj, së bashku me ndihmën juridike që i dha mundësinë të vazhdonte me proceset gjyqësore.

Sipas juristëve që u ofrojnë ndihmë ligjore viktimave të dhunës në familje, ka disa arsye pse gratë viktimat të dhunës në familje ose të trafikimit të qenieve njerëzore, nuk marrin informacionin e duhur nga autoritetet.<sup>59</sup> Ato përfshijnë:

- **Mungesa të njohurive të punonjësve të policisë** për detyrimet që kanë sipas ligjit, shkaktuar nga ndryshimet e mëdha në personel. (për më shumë, shih më poshtë në këtë seksion).<sup>60</sup>
- **Mungesa e burimeve njerëzore**; “numri i kufizuar i punonjësve të policisë”<sup>61</sup> pengon efikasitetin e tyre dhe nuk u jep kohë të mjaftueshme t’i informojnë viktimat e dhunës në familje në hollësi të mjaftueshme për të drejtat e tyre.
- Deri kohët e fundit, ligji ishte i paqartë cilat organe shtetërore dhe të gjyqësorit kishin detyrimin e informimit të viktimave të dhunës në familje dhe të trafikimit të qenieve njerëzore për të drejtat e tyre. Megjithatë, ndryshimet e kohëve të fundit në Kodin e Procedurës Penale ofrojnë një kuadër më të qartë për rolin e saktë të policisë dhe zyrës së prokurorisë në këtë drejtim.<sup>62</sup>

53. Intervistë me “Gruaja tek Gruaja”; Shkodër, 3 mars 2017.

54. Intervistë me një punonjëse të “Hapa të Lehtë; Shkodër”, 13 mars 2017.

55. Intervistë me juristë të qendrës Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNLQ); Tiranë, 4 prill 2017.

56. Intervistë me “Gruaja tek Gruaja”; Shkodër, 3 mars 2017.

57. Intervistë me viktimën nr. 2; Vlorë, 10 mars 2017.

58. Intervistë me viktimën nr. 1; Shkodër, 19 mars 2017.

59. Intervistë me juristët tek Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNLQ); Tiranë, 4 prill 2017.

60. Po aty.

61. Po aty.

62. Po aty.

- **Mungesa e llogaridhënies** nga autoritetet për moszbatimin e detyrimeve të tyre ligjore. Një ofruese e ndihmës ligjore, e intervistuar në kuadër të studimit, ishte përpjekur t'i vinte punonjësit e policisë dhe ata ligjzbatues para përgjegjësisë që nuk u kishin dhënë viktimave të dhunës në familje dhe të trafikimit informacione specifike, por këto përpjekje rrallë kishin rezultuar në ndëshkime dhe masa konkrete për përmirësimin e llogaridhënies në sistem.<sup>63</sup>

Nuk janë vetëm viktimat që kanë mungesë njohurish për ligjin; sipas aktivisteve dhe viktimave, **ndonjëherë edhe vetë punonjësit e sistemit të drejtësisë nuk i njohin mirë dispozitat e ligjit për dhunën në familje**. Në fillim, thotë një eksperte, *“gjykata dhe punonjësit e policisë nuk e dinin si funksiononin urdhrat e mbrojtjes.”*<sup>64</sup> Megjithëse, sipas disave, gjendja është përmirësuar, ka të tjerë që vazhdojnë të mendojnë se policia *“nuk ka njohuri për ligjin e dhunës në familje.”*<sup>65</sup>

Në Pukë, një tjetër person që punon për të luftuar dhunën në familje thotë,

*“autorët futen në burg. Grave nuk u jepen urdhra të mbrojtjes. Ekziston një ide e gabuar se është më mirë që autorët të futen në burg, sepse në këtë mënyrë ata ‘do ta kuptojnë gabimin që kanë bërë.’”*<sup>66</sup>

**Ndodh që punonjësit në fushën e drejtësisë të shfaqin qëndrime mospërfillëse dhe poshtëruese ndaj viktimave të dhunës në familje.**

*“Kur flasim me gratë, oficerët e policisë tallen ose ua venë fajin atyre. Për shembull, u thonë: ‘Pse do që ta lesh burrin? Mirë ta bën që të rreh. Të kishe qenë gruaja ime do të të kisha rrahur më shpesh.’ Ky reagim është shumë i shpeshtë.”*<sup>67</sup>

Po kështu, ka pasur raste kur gjyqtarët u kanë thënë të miturve: *“Ne i rrahim gratë në shtëpi dhe [ti thua] mos të të rrahim ty?”*<sup>68</sup> Ky është produkt i një qëndrimi që e konsideron dhunën në familje si diçka ‘normale’.

Vitet e fundit janë bërë përpjekje për t'i njohur profesionistët e fushës me ligjin për dhunën në familje dhe zbatimin e tij. Janë investuar burime për të trajnuar punonjësit e policisë, gjyqtarët, prokurorët dhe punonjës të tjerë për natyrën e dhunës në familje, funksionimin e sistemit, rolin e urdhrave të mbrojtjes dhe strehave, dhe të tjera. Megjithatë, aktivistet vënë në dukje se, *“ne kemi punuar me punonjësit policisë, juristët dhe gjyqtarët, por ajo që ndodh është se, pasi trajnohen apo mësojnë për përvojat e grave, ata zëvendësohen me profesionistë të tjerë.”*<sup>69</sup> Me fjalë të tjera, **ndryshimet e mëdha të personelit në radhët e punonjësve të trajnuar për goditjen e dhunës në familje i zhvlerësojnë këto përpjekje dhe e bëjnë aksesin në drejtësi edhe më të vështirë.**<sup>70</sup> Përveç këtyre, viktimat e dhunës në familje dhe të trafikimit të qenieve njerëzore përballen edhe me disa nga **barrierat e sipërpërmendura që i kanë edhe individë të tjerë, veçanërisht anëtarët e grupeve të pafavorizuara që duan të përdorin sistemin e drejtësisë.** Këtu përfshihen:<sup>71</sup> mungesa e një sistemi funksional të ndihmës juridike; zgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore që i dekurajon përdoruesit e mundshëm të sistemit të drejtësisë; perceptimi se sistemi është i korruptuar; dhe tarifatat e larta gjyqësore dhe të ekspertëve. Këto të fundit janë veçanërisht të theksuara për viktimat e dhunës në familje dhe të trafikimit të qenieve njerëzore, sepse zakonisht në çështjet e tyre kërkohet dëshmia e një eksperti psikoterapist, dhe tarifatat e tyre janë shumë të larta. Megjithëse avokatët që ofrojnë ndihmë ligjore për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit njerëzor përipiqen të bashkëpunojnë me organizatat që ofrojnë mbështetje psikologjike falas, ata *“jo gjithmonë arrijnë të angazhojnë ekspertë falas.”*<sup>72</sup>

63. Po aty.

64. Intervistë me Gruaja tek Gruaja; Shkodër, 3 mars 2017.

65. Intervistë me psikologun tek Gruaja tek Gruaja; Shkodër, 3 mars 2017.

66. Intervistë me punonjës social tek Hapa të Lehtë; Shkodër, 13 mars 2017.

67. Intervistë me psikologun e organizatës Gruaja tek Gruaja; Shkodër, 3 mars 2017.

68. Po aty.

69. Intervistë me punonjës social tek “Hapa të Lehtë”; Shkodër, 13 mars 2017.

70. Intervistë me juristet e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare (QNLQ); Tiranë, 4 prill 2017.

71. Intervistë me ofrues të ndihmës ligjore; Tiranë, 31 mars 2017. Intervistë me juristet e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare; Tiranë, 4 prill 2017. Intervistë me juristet e Res Publica; Tiranë, 13 prill 2017.

72. Intervistë me juristet e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare (QNLQ); Tiranë, 4 prill 2017.

## Gjetjet kryesore lidhur me aksesin në drejtësi të viktimave të dhunës në familje

### Studimi tregon:

- **Viktimave të dhunës në familje shpesh u mungojnë mjetet ekonomike, që është faktor shkrajues për kërkimin e drejtësisë.**
- **Viktimave gjithashtu u mungon informacioni për të drejtat e tyre sipas ligjit dhe për funksionimin e sistemit të urdhrave të mbrojtjes. Po kështu, punonjësve të drejtësisë u mungon informacioni dhe jo gjithmonë e zbatojnë ligjin për dhunën në familje.**
- **Ka raste kur punonjësit e drejtësisë mund të kenë qëndrime mospërfillëse dhe poshtëruese ndaj viktimave të dhunës në familje.**
- **Ndryshimet e mëdha të personelit në radhët e punonjësve të trajnuar për të goditur dhunën në familje i zhvlerësojnë këto përpjekje dhe e bëjnë më të vështirë aksesin në drejtësi.**

### Sugjerime për masat që do të përmirësonin aksesin në drejtësi të viktimave të dhunës në familje

- Përmirësimi i njohurive ligjore të grave, fëmijëve dhe viktimave (ose viktimave të mundshme) të dhunës në familje. Ky informacion duhet të shpërndahet nga grupe bërthamë në komunitet dhe duhet të përfshihen edhe qendrat shëndetësore.
- Rritja e ndërgjegjësimit të punonjësve për ligjin e dhunës në familje, funksionimin e urdhrave të mbrojtjes, rolin e strehave, dhe kështu me radhë.
- Ofrimi i shërbimeve lëvizëse për viktimat e dhunës në familje.
- Ngritja e një sistemi funksional të ndihmës juridike falas.



## KAPITULLI 5.4 – FËMIJËT NË INSTITUCIONE REZIDENCIALE

Ky kapitull shqyrton pengesat që hasin fëmijët në institucionet rezidenciale për të pasur akses në drejtësi.

Një nga vështirësitë kryesore që hasin fëmijët dhe institucionet rezidenciale është **balancimi i të drejtave të fëmijës dhe interesit të tij ose të saj më të lartë, me nevojën për jetë familjare**. Ky akt balancimi mund të çojë në vendime të vështira lidhur me transferimin e kujdestarisë nga prindi tek institucionet, kthimin e kujdestarisë përsëri tek prindi, si dhe lidhur me çështje të birësimit të fëmijëve në institucione rezidenciale.<sup>73</sup>

Një vështirësi e madhe për të garantuar që fëmijët në institucionet rezidenciale të gëzojnë të drejtat ndodh në rastet kur nuk ekziston rreziku i shfrytëzimit apo abuzimit, por familja nuk mundet ta përballojë financiarisht mbajtjen e një fëmije. Në raste të tilla, **legjisllacioni dhe procedurat e ndjekura nga gjykata** kanë mangësi, sepse gjyqtarët pothuaj gjithmonë vendosin t'i heqin fëmijët nga kujdestaria e familjes pa shqyrtuar alternativa të tjera, si përfshirja e shërbimeve sociale për të ofruar përkrahje dhe lloje të tjera ndihmash për mbështetjen e familjes. Pasi është marrë një vendim i tillë, gjykatat ngurrojnë shumë t'ia kthejnë fëmijën familjes dhe t'i ri-japin familjes kujdestarinë. Shpresohet që ndryshimet ligjore të kohëve të fundit, që parashikojnë parimin se fëmija nuk duhet vendosur në institucion rezidencial për arsye ekonomike, do t'i japin fund kësaj praktike.<sup>74</sup>

Në të njëjtën kohë, **fëmijët rrezikojnë të vuajnë nga abuzimi i vazhdueshëm kur prindërve u jepen të drejtat e vizitës në institucionet rezidenciale që kanë kujdestarinë**. Në raste të tilla, gjykatat i lejojnë prindërit t'i marrin fëmijët herë pas here në shtëpi për periudha të shkurtra kohore, gjatë të cilave ndonjëherë ata vazhdojnë t'i shfrytëzojnë fëmijët duke i detyruar të lypin.<sup>75</sup>

Prandaj, sipas punonjësve të institucioneve rezidenciale, është shumë e rëndësishme të **bëhen ndryshime në legjisllacionin** përkatës, veçanërisht në kontekstin e reformës së tanishme të deinstitutionalizimit e cila synon që, kur është e mundur, t'i mbështesë familjet të kujdesen për fëmijët e tyre dhe jo t'i vendosin ata në institucione rezidenciale.

Një vështirësi tjetër, përveç mangësive në legjisllacion, është **ndryshimi i qëndrimeve të gjyqësorit** për të rënjosur tek ta njohjen e së drejtës së fëmijës për të qëndruar me familjen e tij ose të saj biologjike, kur kjo është në interesin më të lartë të fëmijës. Miratimi i ligjit të ri për mbrojtjen e fëmijës, që vë interesin më të lartë të fëmijës si parimin kryesor drejtues në përcaktimin e fatit të fëmijëve, ofron arsye për optimizëm.<sup>76</sup>

Një barrierë tjetër ndaj aksesit në drejtësi është se **prindërve dhe anëtarëve të familjes nuk u jepet informacion për procedurat përkatëse ligjore** për rimarrjen e kujdestarisë së fëmijës. Për më tepër, duke qenë se shpesh këta fëmijë vijnë nga familje të varfra dhe grupe të pafavorizuara, prindërit e tyre **shpesh nuk kanë mjetet financiare për të përballuar kostot e avokatëve privatë dhe kostot gjyqësore**, duke e theksuar edhe më nevojën për një sistem funksional të ndihmës juridike. Një shembull që u has gjatë studimit ishte ai i një nëne që e kishte lënë fëmijën në një institucion rezidencial që nga lindja, pa asnjë dokumentacion. Kur u kthye pas disa vitesh dhe kërkoi fëmijën, e informuan se gjykata kërkonte rezultatet e analizës së ADN-së për të përcaktuar se ajo ishte nëna. Por, duke qenë se testi është shumë i shtrenjtë, ajo nuk mundi ta paguajë dhe fëmija ende nuk mund të ribashkohet me nënën, me gjithë interesin më të lartë të fëmijës.<sup>77</sup>

Ashtu si grupet e tjera të pafavorizuara, edhe fëmijët në institucionet rezidenciale përballen gjithashtu me **pengesat e sipërpërmendura në përdorimin e sistemit të drejtësisë**, përfshirë mungesën e një sistemi funksional të ndihmës juridike; zgjatjen e tepruar të procedurave gjyqësore; perceptimin se sistemi është i korruptuar; dhe kostot e larta gjyqësore dhe për ekspertët.

73. Grup fokusi, institucion rezidencial për fëmijët; Tiranë, 5 prill 2017.

74. Shihni Nenin 9(1) të Ligjit të ri për Mbrojtjen e Fëmijëve nr.18/2017.

75. Po aty.

76. Shih nenin 5/1 (Parimet) së bashku me nenin 6 (Interesi më i lartë i fëmijës) të ligjit të ri për mbrojtjen e fëmijës nr. 18/2017.

77. Po aty.

## Gjetjet kryesore lidhur me aksesin në drejtësi të fëmijëve në institucionet rezidenciale

### Studimi tregon se:

- Deri kohët e fundit, **legjislacioni dhe procedurat e ndjekura nga gjykata** kishin mangësi dhe nuk ishin të pajisura për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës në institucionet rezidenciale. Miratimi kohët e fundit i ligjit të ri për mbrojtjen e fëmijës (Ligji nr. 18/2017) duhet ta përmirësojë gjendjen, nëse zbatohet. Zbatimi i ligjit të ri duhet të rishikohet në periudhën e ardhshme.
- **Fëmijët rrezikohet të vuajnë nga abuzimi i vazhdueshëm kur prindërve u jepet e drejta për t'i vizituar në institucionet rezidenciale që kanë kujdestarinë e tyre.**
- Duhet **ndryshuar qëndrimet e gjyqësorit** për të nxitur të drejtën e fëmijës për të qëndruar me familjen biologjike, kur kjo është në interesin më të lartë të fëmijës.

### Sugjerime për masat që do të përmirësonin aksesin në drejtësi të fëmijëve në institucionet rezidenciale

- Ngritja e një sistemi funksional të ndihmës juridike.
- Trajnimi i gjyqtarëve në lidhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.
- Amendimi i legjislacionit me qëllim që të promovohet parimi i deinstitutionalizimit.




– KAPITULLI 7 –

# GJETJET KRYESORE

Njohja dhe njohuritë e kufizuara për ligjin dhe qëndrimet  
e diskutueshme ndaj tij paraqesin një kornizë të brishtë  
për aksesin në drejtësi





## Njohja dhe njohuritë e kufizuara për ligjin dhe qëndrimet e diskutueshme ndaj tij paraqesin një kornizë të brishtë për aksesin në drejtësi

Individët kanë një nivel mjaft të ulët ndërgjegjësimit për të drejtat e tyre. Nuk ka as edhe një të drejtë apo liri kushtetuese të vetme emrin e së cilës mund ta përmendin më shumë se një e katërta e 1758 personave të anketuar, dhe njohuritë e tyre për mënyrat se si zbatohen këto të drejta në praktikë janë të kufizuara. Për shembull, **ka mangësi në njohjen e të drejtave të grave**, ku më pak se gjysma e të anketuarve e dinin se gruaja mund të bëjë zgjidhjen e martesës pa miratimin e bashkëshortit, dhe pak më shumë se një e treta u shprehën se një grua e martuar që ka marrë pajë nuk ka të drejtë trashëgimie nga prindërit e saj pas martesës. Po kështu, personat e anketuar kishin nivel të ulët informimi për sa i përket të drejtës për një gjykim të drejtë.

Me gjithë këtë nivel të ulët njohurish dhe ndërgjegjësimit, pothuaj tri të katërtat e personave të anketuar nuk kanë kërkuar informacion për ligjin. Nga ata që kanë kërkuar informacione, numri i personave që nuk ishin të kënaqur me informacionin e marrë ishte më i madh se i atyre që kishin mbetur të kënaqur.

**Niveli i ulët i njohurive ligjore është më i theksuar në radhët e komunitetit rom, personat me nivel arsimor të ulët dhe me të ardhura të ulta.**

Opinionet e personave të anketuar për drejtësinë përfshijnë disa qëndrime të diskutueshme. Për shembull, **toleranca ndaj korrupsionit ka hedhur rrënjë të thella** (sidomos ndër të rinjtë, personat me nivel të lartë arsimor dhe ata me të ardhura të larta). Ekziston gjithashtu një nivel i ngjashëm **tolerance ndaj dhunës në familje**, ku 22,5% e personave të anketuar ishin të mendimit se “i takon bashkëshortit të dispijnojë bashkëshorten e tij”. Përveç kësaj, **diskriminimi i anëtarëve të komunitetit LGBT konsiderohet si i pranueshëm nga një shumicë e madhe njerëzish**, që besojnë se punëdhënësi duhet të jetë në gjendje ta heqë nga puna një homoseksual/e nëse nuk ndihet rehat me të.

**Pothuaj tri të katërtat e popullatës besojnë se sistemi shqiptar i drejtësisë nuk i mbron të drejtat e tyre.** Është për t'u shqetësuar se personat që kanë pasur përvoja me sistemin e drejtësisë kanë shumë më pak gjasa të besojnë se ai i mbron të drejtat e tyre, krahasuar me ata që nuk kanë pasur kontakte me të gjatë pesë viteve të fundit. Arsyeja kryesore për këtë mungesë besimi është korrupsioni në sistemin e drejtësisë, ku pothuaj gjysma e personave të anketuar e përmendën këtë arsye.

**Rrjedhoja e këtyre gjetjeve është se tre faktorë – niveli i ulët i njohjes me ligjin, qëndrimet e dyshimta se çfarë quhet e drejtë dhe çfarë jo, si dhe mungesa e besimit në sistemin e drejtësisë – krijojnë një kornizë të brishtë për aksesin në drejtësi në Shqipëri.** Mungesa e njohurive dhe njohjes së ligjit ndikon negativisht në aftësinë e qytetarëve për të kuptuar shkeljet e të drejtave të tyre dhe për të kërkuar drejtësi; opinionet e ngushta për drejtësinë, që përhapin qëndrime diskriminuese dhe tolerojnë korrupsionin, mund të bëjnë që viktimat e shkeljeve dhe abuzimeve nga radhët e grupeve të pafavorizuara dhe viktimat e korrupsionit të mos marrin mbështetjen e duhur nga familjet, miqtë dhe autoritetet kur kërkojnë drejtësi; dhe së fundi, mungesa e besimit në sistemin e drejtësisë i bën qytetarët të mos i ndjekin pretendimet e tyre në sistemin e drejtësisë, duke shkaktuar kështu mosmbrojtjen e të drejtave të tyre të ligjshme.

## Numri i madh i mosmarrëveshjeve bën që kërkesat për akses në drejtësi të jenë të mëdha

**Gati gjysma e popullatës (48,7%) ka pasur probleme gjatë pesë viteve të fundit.** Burrat dhe anëtarët e komunitetit rom njihen se kanë më shumë mosmarrëveshje se sa përkatësisht gratë dhe popullatat jo-pakicë, ndërsa banorët e zonave fshatare kanë më pak mosmarrëveshje se banorët e Tiranës dhe zona të tjera urbane.

**Mosmarrëveshjet kanë në qendër kryesisht çështje të pronësisë dhe tokës.** Dhjetë për qind e popullatës kishin pasur mosmarrëveshje për çështje të titujve të pronësisë mbi tokën/truallin dhe një grup tjetër prej 9% të popullatës kishin

mosmarrëveshje për çështje trualli/toke, qoftë me anëtarë të familjes, ose me shtetin. Mosmarrëveshje të tjera të zakonshme (8,2%) lidhen me marrjen e përfitimeve sociale (si ndihma ekonomike apo pagesat e aftësisë së kufizuar), ndërsa mosmarrëveshjet për të drejtat që lidhen me punën dhe punësimin dhe krimin janë më pak të zakonshme. Megjithatë, duhet vënë në dukje se ka gjasa që, ashtu si shifrat në studime të tjera, shifrat për krimin të jenë të nën-raportuara. Mosmarrëveshjet e qytetarëve në pjesën dërrmuese kanë si palë kundërshtarë, ose kanë të bëjnë, me shtetin. Këto gjetje në lidhje me mosmarrëveshjet nxjerrin në pah **kërkesën e madhe për akses në drejtësi tek individët në Shqipëri**. Duke qenë se gati gjysma e popullatës kanë pasur nevoja për çështje që lidhen me drejtësinë këto pesë vitet e fundit, është e nevojshme që në Shqipëri të ketë një sistem drejtësie që është i drejtë dhe i paanshëm dhe i përgjigjet këtyre nevojave, për t'i dhënë zgjidhje mosmarrëveshjeve.

## **Për të siguruar akses më të mirë në drejtësi duhet një sistem drejtësie më i mirë**

Në pjesën më të madhe, përpjekjet e qytetarëve shqiptarë për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre janë të pasuksesshme – vetëm 21,8% e personave të anketuar arritën t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre. Përveç kësaj, 43% e të intervistuarve – dhe shumica e atyre me të ardhura të ulta, me nivel arsimor më të ulët, si dhe anëtarët e komunitetit rom – besojnë se rezultati ishte shumë i padrejtë. Përpjekjet e qytetarëve shqiptarë për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre pengohen nga:

- **Komunikimi i dobët dhe mungesa e qëndrimeve të hapura** nga ana e punonjësve të ndryshëm në sistemin e drejtësisë në mënyrën se si i trajtojnë qytetarët që kërkojnë zgjidhje ligjore. Në të njëjtën kohë, gjetjet nxjerrin në pah të njëjtat pririje (pra të komunikimit të dobët dhe jo të hapur) nga ana e një numri të vogël qytetarësh, të cilët kërcënojnë me dhunë kur kontaktohen nga pala tjetër në mosmarrëveshje;
- **Mungesa e respektit për ta nga ana e institucioneve dhe punonjësve në sistemin e drejtësisë;** kjo është më e dukshme kur bëhet fjalë për organet e qeverisjes vendore dhe qendrore;
- **Mungesa e drejtësisë dhe paanshmërisë si në proces ashtu edhe në rezultat;**
- **Kostot e larta të aksesit në gjykata dhe tek avokatët** që ofrojnë shërbime të një cilësie më të mirë;
- **Koha e gjatë që kërkohet për të pasur akses** në drejtësi, ku zgjidhja e disa prej mosmarrëveshjeve të regjistruara në këtë studim kishin marrë më shumë se dhjetë vjet.

Për të përmirësuar qasjen në drejtësi duhet që të gjitha këtyre problemeve t'u jepet zgjidhje në mënyrë gjithëpërfshirëse.

**Mundësitë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë të drejtë e të paanshme pakësohen nëse personi është rom, me të ardhura të ulta, me nivel arsimor të ulët dhe nga Tirana.** Nëse dikush i përket dy ose më shumë prej këtyre grupeve në të njëjtën kohë, kjo përbën një pengesë edhe më e madhe për të pasur akses në drejtësi. Për sa i përket tri grupeve të para, shpjegimet për këto gjetje duken të vetëkuptueshme dhe të ndërlidhura: romët kanë më shumë gjasa të jenë të pafavorizuar nga ana ekonomike, kanë nivele më të ulta arsimore dhe përballen me diskriminim; personat me nivel arsimor më të ulët shpesh kanë të ardhura më të ulta dhe e njohin më pak ligjin dhe mënyrën si funksionon sistemi i drejtësisë. Së fundi, personat me të ardhura më të ulta nuk mund t'i përballojnë financiarisht rrugët më cilësore për akses në drejtësi, si gjykatat. Megjithatë, rezultatet nuk ofrojnë një përgjigje të qartë se pse qytetarët e Tiranës (përveç atyre në gjendje të mirë ekonomike) kishin më pak sukses në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

**Rezultatet tregojnë se përmirësimi i aksesit në drejtësi kërkon një sistem drejtësie më respektues, më të drejtë, më pak të kushtueshëm, më të aksesueshëm dhe efikas.**

## Grupet e pafavorizuara kanë vështirësi shtesë lidhur me aksesin në drejtësi

**Anëtarët e grupeve të pafavorizuara përballen me pengesa shtesë lidhur me aksesin e tyre në drejtësi.** Shumë anëtarë të grupeve të pafavorizuara, si ata të komunitetit LGBT, personat me aftësi të kufizuara dhe të tjerët, përballen me **diskriminim të përhapur, çka krijon pengesa madhore ndaj aksesit në sistemin e drejtësisë.** Kjo ua bën të vështirë të kenë mbrojtjen e policisë nga dhuna sistematike me të cilën përballen; madje, siç tregojnë edhe gjetjet e studimit, ndonjëherë janë vetë punonjësit e policisë që nxisin dhunën ndaj anëtarëve të komunitetit LGBT.

**Po kështu, anëtarët e grupeve të pafavorizuara shpesh janë të privuar nga ana ekonomike dhe, si rrjedhojë, nuk janë në gjendje të kenë akses në shërbime ligjore cilësore.** Kjo i dekurajon dhe i bën të mos bëjnë përpjekje për të pasur akses në drejtësi. Kjo është e vërtetë për ato viktime të dhunës në familje që janë të pafavorizuara nga ana ekonomike dhe, për këtë arsye, nuk janë në gjendje ose nuk janë të gatshme, t'i ndjekin pretendimet e tyre në sistemin e drejtësisë.

**Anëtarët e grupeve të pafavorizuara janë shpesh edhe të keqinformuar për ligjin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë për çështjet që lidhen me ta.** Për shembull, personat me aftësitë e kufizuara dhe mbrojtësit e të drejtave të tyre që morën pjesë në studim theksuan se anëtarët e këtij grupi shpesh nuk kanë dijeni për të drejtat e tyre, si ndihmat e ndryshme dhe të drejtat që u takojnë.

Përveç këtyre vështirësive dhe sfidave, anëtarët e grupeve të pafavorizuara kanë edhe pengesa të tjera ndaj aksesit në drejtësi, njësoj si pjesa tjetër e popullsisë: mungesa e besimit në sistem, tarifrat e larta gjyqësore dhe për ekspertët (që janë sidomos të rëndësishme për grupe të tilla si viktimat e dhunës në familje), mungesa e një sistemi funksional të ndihmës juridike, si dhe kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore.

## Arsye për optimizëm

Me gjithë pengesat e përvijuara më lart, ka arsye për optimizëm dhe arritje të cilat mund të shërbejnë si themel për akses më të mirë në drejtësi.

**Personat e anketuar e shikojnë punën e gjykatave nën një dritë mjaft pozitive.** Ndonëse gjykatat janë tepër të kushtueshme dhe të papërbalueshme për pjesën më të madhe të të anketuarve, kur ishte fjala për drejtësinë e procesit dhe të rezultatit, respektin e treguar për palët, dhe mundësitë që kishin palët për ta paraqitur çështjen e tyre, gjykatat arritën rezultate mjaft të mira. Kjo flet për aftësinë e gjykatave për të dhënë rezultate të drejta dhe thekson nevojën për t'i bërë gjykatat më të aksesueshme për personat me burime financiare më të pakta.

**Disa ndryshime legjislative të kohëve të fundit kanë bërë që drejtësia të jetë më e aksesueshme.** Shembuj të këtyre ndryshimeve janë ligji i ri për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës (Nr. 18/2017), i cili sanksionon me ligj parimin e veprimit në interesin më të lartë të fëmijës, si dhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, të cilat parashikojnë të drejtën e personave me dëmtim të dëgjimit për të pasur një përkthyes në gjuhën e shenjave gjatë procedurave gjyqësore.

**Pjesa më e madhe e mosmarrëveshjeve nuk janë shumë të kushtueshme për t'u zgjidhur.** Rezultatet kanë treguar se shumica e mosmarrëveshjeve u kushtojnë të anketuarve shumë pak ose aspak. Megjithatë, rezultatet e studimit kanë treguar edhe se cilësia e shërbimeve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në raste të tilla duhet të përmirësohet, në mënyrë që të ofrohen procese dhe rezultate më të drejta.

**Shumica dërrmuese e personave të anketuar ishin përpjekur t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre në mënyrë paqësore me palën tjetër.** Mungesa relative e suksesit nënvizon nevojën për një mbështetje të mëtejshme për rrugëzgjidhjet që nuk kanë nevojë për institucionet zyrtare.





# REKOMANDIME

Rekomandimet e përvijuara më poshtë kanë për qëllim realizimin e përmirësimeve praktike lidhur me aksesin në drejtësi në Shqipëri. Ato rrjedhin nga rezultatet e studimit dhe lidhen me synimet dhe veprimet e parashikuara në draftin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017-2020 (tani e tutje draft-Strategjia e Drejtësisë), planet e veprimit të lidhura me të, si dhe rekomandimet e përfshira në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016. Si të tilla, rekomandimet e paraqitura në këtë kapitull kanë për qëllim edhe përshtetimin e procesit të integritit evropian të Shqipërisë.





## Akses më i mirë në drejtësi

Gjetjet tregojnë se ekziston nevoja që popullata shqiptare të ketë akses më të mirë në drejtësi. Numri i personave të anketuar që kishin pasur përvoja negative me sistemin e drejtësisë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre ishte tepër i madh. Ata, dhe të tjerët si ata, kanë nevojë për rrugë më të drejta, më efikase dhe më pak të kushtueshme për vendosjen e drejtësisë. Ky rekomandim përputhet me pjesë të ndryshme të draft-Strategjisë së Drejtësisë, si Qëllimi i parë strategjik i projekt Planit të Veprimit të Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (tani e tutje projekt-Plani i Veprimit), që është 'Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe përgjegjshmërisë të institucioneve të sistemit të drejtësisë', Objektivi 1.4 i të cilit bën thirrje për më shumë akses në drejtësi, dhe Qëllimi i tretë strategjik, i cili bën thirrje për 'përmirësimin e operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe aksesueshmërinë e tij në përputhje me standardet evropiane.'

Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon të paktën disa prej veprimeve të mëposhtme:

**Krijimi i një sistemi funksional të ndihmës juridike.** Sistemi i ndihmës juridike është guri themeltar i një sistemi më të drejtë që u jep qytetarëve mundësinë të kenë akses në drejtësi (siç paraqitet edhe në objektivin 3.3 të projekt Planit të Veprimit). Ai duhet të trajtojë si çështjet penale, ashtu edhe ato civile sepse, siç tregohet edhe nga gjetjet e këtij studimi, vëllimi më i madh i çështjeve ligjore të qytetarëve janë mosmarrëveshje që kanë në qendër pronën dhe tokën. Po kështu, ai duhet të marrë parasysh edhe faktin që – siç e tregojnë edhe gjetjet e studimit - individët u drejtohen një shumëllojshmërie institucionesh për nevojat e tyre për drejtësi, dhe veçanërisht punonjësve të organeve të qeverisjes vendore dhe qendrore. Sistemi i ndihmës juridike duhet të jetë i tillë që të marrë parasysh këto modele të sjelljes së qytetarëve; për shembull pas krijimit të sistemit të ndihmës juridike, punonjësit e organeve vendore dhe qendrore duhet të kenë informacionin përkatës për ofruesit e shërbimeve të ndihmës ligjore, në mënyrë që t'i drejtojnë përfituesit tek këto shërbime. Kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme, sidomos për njësitë e vetëqeverisjes vendore, në kuadrin e reformës territoriale administrative të kohëve të fundit.

Ofruesit e ardhshëm të ndihmës juridike duhet të bëjnë **përpyqje që shërbimet e tyre të arrijnë tek personat që nuk zotërojnë njohuritë apo mjetet për të shkuar tek ta.** Siç e tregojnë gjetjet, një pakicë e konsiderueshme qytetarësh – ata me nivel të ulët arsimor dhe nivel të ulët të ardhurash – nuk janë të informuar sa duhet se cilit institucion duhet t'i drejtohen kur kanë nevojë për shërbime ligjore. Për të shmangur mundësinë që këta persona të pafavorizuar të mbeten jashtë vëmendjes së sistemit të ndihmës juridike, ofruesit e ndihmës juridike duhet të bëjnë përpyqje të shkojnë tek ata, qoftë përmes klinikave lëvizëse të ndihmës juridike, programeve të informimit dhe ndërgjegjësimit, caktimit të orareve të takimit në zona të varfëra, si në vendbanimet e romëve, dhe mjete të tjera. Këto metoda duhet të pilotohen dhe, në hartimin e tyre, ofruesit e ndihmës juridike duhet të shfrytëzojnë edhe mekanizmat e përdorura me sukses nga organizatat e shoqërisë civile.

**Rritje të aksesit në shërbimet e përfaqësimit dhe këshillimit ligjor.** Gjetjet tregojnë se ka vend për mjete më pak të kushtueshme dhe më pak të ngarkuara të dhënies së këshillave ligjore për personat që kanë nevojë për shërbime ligjore dhe ata të përfshirë në mosmarrëveshje. Ndër këto mund të përfshihen mjete të tilla si linja telefonike të këshillimit ligjor falas, faqe interneti dhe shërbimet ndërvepruese në internet. Për të pasur një sistem drejtësie të kompletuar, që ofron akses më efikas dhe më pak të kushtueshëm në drejtësi, këto mekanizma duhet të pilotohen për të testuar efektivitetin e tyre.

**Rritje e aksesit në sistemin e gjykatave.** Studimi ka dokumentuar gjerësisht ndikimin që kanë tarifat e larta gjyqësore dhe të ekspertëve në uljen e numrit të personave që zgjedhin rrugën e gjykatës për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre. Është shumë e rëndësishme që këto tarifa të ulen për të bërë të mundur që personat e pafavorizuar nga pikëpamja financiare të mund të marrin shërbim më të drejtë, më transparent dhe më të respektueshëm në sistemin e gjykatave. Kjo është në përputhje me objektivin 3.2 të projekt-Planit të Veprimit: 'Krijimi i një sistemi të arsyeshëm dhe proporcional të tarifave gjyqësore për të siguruar financimin e shërbimeve të drejtësisë si dhe garantimin e aksesit në gjykatë.'

**Aksesi në gjykatë duhet të përmirësohet edhe në drejtime të tjera;** për shembull, pozita e personave me aftësi të kufizuara mund të përmirësohet duke bërë përshtatje në infrastrukturën fizike dhe duke vënë në dispozicion përkthyes në gjuhën e shenjave në të gjithë rrjetin e gjykatave. Ky veprim do të ndihmonte në plotësimin e Objektivit 1.4 të projekt-Planit të

Veprimet,<sup>78</sup> i cili parashikon punime për përmirësime infrastrukturore në të gjitha ndërtesat e gjykatave të Shqipërisë.

**Ndërtimi i një sistemi efektiv ndërmjetësimi.** Siç u përmend në gjetjet e studimit, popullata shqiptare përpiqet t'i zgjidhë mosmarrëveshjet drejtpërsëdrejti, përmes bisedimeve me palën tjetër. Kjo është diçka e mirëpritur; megjithatë shkalla e suksesit të këtyre bisedimeve mund të përmirësohet përmes krijimit të një sistemi efektiv ndërmjetësimi, (siç kërkohet në Objektivin 8.9 të projekt-Planit të Veprimit: 'Forcimi i rolit të ndërmjetësve dhe përmirësimi i kuadrit ligjor për zbatimin e ndërmjetësimit në proceset civile, familjare, penale dhe administrative').

## Prezantimi i masave shtesë për sigurimin e një aksesit më të mirë në drejtësi për grupet e pafavorizuara

Përmirësimi i aksesit të grupeve të pafavorizuara në drejtësi nuk arrihet vetëm përmes veprimeve të mësipërme. Përveç tyre ekziston nevoja për veprime që venë në qendër nevojat e grupeve të pafavorizuara. Lista në vijim nuk është shteruese, por vë në pah një ose dy masa për secilin prej grupeve të pafavorizuara të profilizuara në këtë studim:

**Rritja e ndërgjegjësimit të punonjësve të sistemit të drejtësisë (avokatë, gjykatës, punonjës policie, prokurorë, dhe të tjerë) për të drejtat e personave LGBTI, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje, fëmijët në institucione rezidenciale, dhe të tjerë.** Studimi ka treguar se punonjësit kanë koncepte të ngushta se cilat të drejta janë të rëndësishme për grupe të caktuara (për shembull, e drejta e tubimit dhe organizimit për komunitetin LGBTI) por nuk kanë dijeni për disa të drejta të tjera (të drejtat e punës dhe punësimit, strehimit, mos-diskriminimit, e të tjera) të cilat dhunohen në mënyrë sistematike. Ngritja e ndërgjegjësimit publik është në përputhje me rekomandimet e dhëna në Raportin e Progresit të KE-së për Shqipërinë për vitin 2016.<sup>79</sup>

**Prezantimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore për të siguruar përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar me të drejtën ndërkombëtare.** Një shembull i spikatur janë ndryshimet që duhen bërë në legjislacionin shqiptar në përputhje me KDPAK (siç rekomandohet në Raportin e Progresit të KE për Shqipërinë për vitin 2016)<sup>80</sup> për shembull përmes ndryshimeve në Kodin Civil mbi heqjen e kapacitetit ligjor të personave me aftësi të kufizuara. Shembuj të tjerë përfshijnë nevojën e harmonizimit të legjislacionit shqiptar për dhunën në familje me Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Goditjen e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).

**Ofrimi i shërbimeve lëvizëse për anëtarët e grupeve të pafavorizuara.** Kjo është veçanërisht e rëndësishme për viktimat e dhunës në familje, disa persona me aftësi të kufizuara, dhe të tjerë, të cilët kanë pengesa në aksesin e tyre tek avokatët ose ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike. Organizatat e shoqërisë civile në rajon kanë pasur sukses në sigurimin e avokatëve që kanë kryer vizita në shtëpitë e personave me aftësi të kufizuara me probleme lëvizshmërie, ose përmes caktimit të orareve të vizitave një herë në javë në vendbanimet rome dhe krijimit të klinikave lëvizëse. Organi drejtues që do të ngrihet për të bërë mbikëqyrjen e sistemit të ndihmës juridike, dhe të gjithë ofruesit e ndihmës juridike që do të punojnë nën mbikëqyrjen e tij, duhet t'i testojnë këto metoda për të parë se cilat prej tyre funksionojnë më mirë në Shqipëri.

## Njohje më e mirë e ligjit dhe nivel më i mirë shërbimesh në sistemin e drejtësisë

Për një akses më të madh në drejtësi, duhen trajtuar çështje si mungesa e njohurive për ligjin dhe qëndrimet e diskutueshme të qytetarëve ndaj drejtësisë. Veprimet e mëposhtme do të ndihmonin në zbatimin e këtij rekomandimi:

**Ndërgjegjësim më i madh për ligjin dhe procedurat ligjore.** Nuk mund të ketë barazi "armësh" – apo kushte të barabarta

78. 'Riorganizimi i hartës gjyqësore dhe prokuroriale si dhe i policisë gjyqësore dhe shpërndarja e gjykatave në përputhje me ndarjen e re territoriale, numrin e banorëve dhe bllokimin e çështjeve gjyqësore, me qëllim forcimin e rolit dhe funksionimit të gjykatave dhe për të siguruar akses në drejtësi.'

79. Shih f. 67.

80. Po aty.

veprimi në sistemin e drejtësisë – në qoftë se disa qytetarë nuk kanë dijeni për të drejtat e tyre. Trajtimi i këtij problemi kërkon marrjen e një sërë masash, përfshirë programet e edukimit ligjor nëpër shkolla; veprimtaritë ndërgjegjësuëse dhe informuese në terren nga ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike, dhe ditët e hapura në gjykata, zyrat e prokurorëve dhe të avokatëve.

**Nxitja e të drejtave të grupeve të pafavorizuara.** Ky studim nxori në pak mangësitë që ekzistojnë në të gjithë popullatën për sa i përket njohjes së të drejtave të grave, dhe të komuniteteve romë dhe LGBT. Për ta korrigjuar këtë mangësi duhen bërë përpjekje - si fushata për ngritjen e ndërgjegjësimit dhe veprimtari informuese.

**Ndërtimi i kapaciteteve të punonjësve në sektorin e drejtësisë për të ofruar shërbime më të mira.** Gjetjet tregojnë se ofruesit e shërbimeve, si organet e qeverisjes vendore, nuk janë dhe aq respektuëse, të drejta, apo transparente, në komunikimet e tyre me qytetarët. Përveç kësaj, personat që kanë pasur përvoja me sistemin e drejtësisë në pjesën më të madhe të rasteve kanë mendime më të këqija për të se sa personat që nuk kanë pasur të bëjnë me të. Kjo gjendje duhet korrigjuar përmes ndërtimit të vazhdueshëm e sistematik të kapaciteteve, me veprimtari si trajnimet, këshillimet dhe shkëmbimet e përvojave me ofruesit e aksesit në drejtësi në vendet e rajonit.

## **Përdorimi i metodave novatore dhe empirike për ofrimin e një aksesit efikas në drejtësi**

**Realizimi i rekomandimeve të mësipërme kërkon përdorimin e mekanizmave novatore.** Aktorët në sistemin e drejtësisë nuk duhet të kenë frikë nga prezantimi i metodave të reja për ofrimin e një aksesit më të mirë në drejtësi. Disa prej tyre, si linjat telefonike të këshillimit, klinikat lëvizëse, dhe veprimtaritë ndërgjegjësuëse dhe informuese në terren, janë përshkruar më lart; me kalimin e kohës aktorët në sistemin e drejtësisë do të gjenerojnë edhe veprimtari të tjera.

**Megjithatë, ka rëndësi shumë të madhe që të bëhen matje empirike të efektivitetit si të mekanizmave të rinj, ashtu edhe të atyre ekzistues.** Në të ardhmen, mekanizmat e përdorur për ofrimin e aksesit në drejtësi duhet të shoqërohen me një model të shëndoshë metodologjik për matjen e efektivitetit të tyre. Më konkretisht, ato duhet të përfshijnë grupe të kontrollit, modele kërkimore të shëndosha, kampionë popullate të zgjedhura në mënyrë të rastësishme, dhe elementë të tjerë të kërkimeve sasiore dhe cilësore.

Është gjithashtu e rëndësishme që **shkalla e suksesit dhe e arritjeve të matet dhe të bëhet gjerësisht e njohur.** Kjo do të sjellë përmirësime në ofrimin e aksesit në drejtësi me kalimin e kohës. Së fundi, ka shumë rëndësi që **aktorët në sistemin e drejtësisë të njihen me praktikat më të mira në nivel global,** për t'u mundësuar atyre të përmirësojnë punën dhe të gjejnë mekanizma të tjerë efektivë për ofrimin e aksesit në drejtësi.



# SHTOJCA 1 – METODOLOGJIA

Përmes kombinimit të metodave cilësore dhe sasore, studimi bëri të mundur kryerjen e një analize të gjerë e të thelluar mbi aksesin në drejtësi dhe çështjet që lidhen me të. Komponentët sasiorë dhe cilësorë të studimit plotësuan njëri-tjetrin dhe prodhuan gjetjet e paraqitura në këtë raport.

## METODAT SASIORE

Boshti qendror për mbledhjen e të dhënave ishte anketimi i popullatës shqiptare. Studiuesit e rekrutuar nga PNUD-i përdorën një pyetësor (shih Shtojcën A) me një kampion të zgjedhur në mënyrë rastësore, të përbërë nga 1758 qytetarë shqiptarë (16 vjeç e lart). Përfaqësimi i burrave dhe grave në kampion ishte afërsisht i barabartë – 896 burra (51,1%) dhe 854 gra (48,7%).<sup>81</sup>

Kampioni prej 1758 personash u zgjodh nga Tirana, zonat e qendrave të mëdha jashtë Tiranës (Shkodra dhe Vlora) dhe zonat rurale. Shqipëria u nda në tre shtresëzime, të formuara në bazë të variabëlilit të pavarur të disponueshmërisë së mundësive për akses në drejtësi. Kështu, u vendos që Tirana, ku ka një shumëllojshmëri mundësish të ndryshme për asistencë ligjore, si për shembull OJQ-të që ofrojnë ndihmë juridike, do të përbënte njërin shtresëzim; zonat jashtë Tiranës, si Shkodra, Durrësi e të tjera, që janë seli të gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë dhe që kanë një përzierje popullore urbane dhe rurale, të përbënin shtresëzimin e dytë; dhe zonat e thella fshatare, të cilat janë më të shkëputura nga disa prej këtyre elementeve të sistemit zyrtar të drejtësisë, të formonin shtresëzimin e tretë.

Pasi u përcaktuan këto grupime, studiuesit i dhanë secilës prej minibashkive brenda Tiranës një numër në mënyrë rastësore dhe prej tyre u përzgjedhën dy ku do të zhvillohej anketimi. Po kështu, numra rastësorë iu dhanë edhe qendrave të mëdha jashtë Tiranës që janë seli gjykatash, dhe Shkodra dhe Vlora u përzgjedhën nga një gjenerues i rastësishëm numrash si qendrat ku do të bëhej anketimi (në mënyrë të ngjashme, edhe bashkitë brenda secilës prej këtyre zonave u përzgjedhën po ashtu në mënyrë rastësore). Në fund, bashkitë e Përmetit dhe Matit u përzgjedhën në mënyrë rastësore si përfaqësues të shtresëzimit të thellë rural.

Numri i të anketuarve u përcaktua me kujdes për të pasqyruar përqindjet e secilit shtresëzim brenda popullatës në përputhje me të dhënat e disponueshme publikisht. Kishte 595 të anketuar nga Tirana, 575 nga Shkodra e Vlora dhe 588 nga Përmeti e Mati.

Njësia bazë e kampionit ishte personi i rritur, por kontaktimi me ta u bë përmes familjeve. Personat që u intervistuan u nxorën nga një përzgjedhje e rastësishme e familjeve, dhe në çdo familje u intervistua një anëtar. Megjithëse kampioni u përzgjedh në mënyrë të rastësishme, u bë një përjashtim i vogël me përzgjedhje të qëllimshme (jo të rastësishme), sepse u mendua se ishte e rëndësishme që në kampion të kishte balancë gjinore. Prandaj, për çdo familje të përzgjedhur u bë një listë e të gjithë anëtarëve të rritur dhe një prej tyre u përzgjedh në mënyrë të rastësishme, duke pasur parasysh që gjinia e personit të përzgjedhur në një familje të ishte e ndryshme nga ajo e personit të përzgjedhur në familjen paraardhëse, nëse kjo ishte e mundur. Kjo garantoj që raporti mashkull-femër të mos largohej shumë nga 1:1.

Puna për anketimin sasior në terren u krye nga 12 numërues. Numëruesit u trajnuan për mbledhjen e të dhënave për përvojat vetjake të individëve lidhur me nevojat e tyre për drejtësi dhe njohuritë e perceptimet e tyre për drejtësinë. Pas trajnimit, ekipi i studimit dhe numëruesit pilotuan pyetësorin sasior, i cili pastaj u rishikua në përputhje me sugjerimet e marra gjatë kësaj faze.

Pasi filloi procesi i anketimit, numëruesit u monitoruan për të siguruar që të dhënat e mbledhura të ishin të gjitha njëtrajtësisht me cilësi të lartë. Studiuesit kryesorë u dhanë numëruesve mendime dhe komente të hollësishme, si për shembull shpjegime shtesë për pyetje të veçanta kur kishim dyshime se mund të ishin keqkuptuar.

81. Gjinia e tetë të anketuarve nuk u regjistrua.



Një nga vështirësitë kryesore me të cilat u përballën numëruesit ishte se personat e intervistuar në zonat urbane – dhe veçanërisht ata në gjendje të mirë ekonomike – kishin ndonjëherë dyshime dhe shqetësime për konfidencialitetin dhe qëllimin e këtij anketimi. Për këtë arsye, për të siguruar një kampion mjaftueshmërisht të madh në zonat urbane, u deshën përpjekje më të mëdha dhe një kohë më e gjatë. Nga ana tjetër, personat e anketuar në zonat rurale, si dhe personat me mjete më të pakta ekonomike, ishin më të gatshëm të merrnin pjesë në studim. Si rezultat, në zonat rurale nuk pati pothuajse asnjë refuzim.

Një vështirësi tjetër me të cilën u përballën studiuesit ishte mundësia e nën-raportimit të krimit dhe të të ardhurave. Siç u vu në dukje në raport, në shifrat e krimeve ka mospërputhje, çka mund të krijojë idenë se përvojat me krimin mund të jenë nën-raportuar në këtë anketim. Po ashtu, ekziston një pasiguri e mirë-dokumentuar për sa i përket raportimit të të ardhurave, që u ka nxjerrë pengesa anketimeve të këtij lloji.<sup>82</sup> Ekipi studimor i mbajti parasysh këto tendenca në analizimin e të dhënave dhe nxjerrjen e përfundimeve prej tyre.

## **Përbërja e kampionit në komponentin sasior të studimit**

- Në periudhën midis marsit dhe majit 2017 u intervistua një total prej 1758 individësh të moshës 16 vjeç e lart.
- Të anketuarit u intervistuan në zona të Tiranës, Shkodrës, Vlorës, Përmetit dhe Matit. 595 të anketuar (33,8%) ishin nga Tirana, 575 nga Shkodra dhe Vlora (32,7) dhe 588 nga Përmeti dhe Mati (33,4%). Nga këta 874 (49,7%) ishin nga zonat urbane dhe 884 (50,3%) nga ato rurale.
- 896 (51,1%) të anketuar ishin burra dhe 854 (48,7%) ishin gra.
- Pothuaj një në shtatë pjesëmarrës (13,6%) deklaruan se i përkisnin një prej grupeve të pakicave. Nga këta, 6% thanë se ishin anëtarë të komunitetit rom, 1,3% thanë se ishin egjiptianë, dhe 6,3% që u përkisnin pakicave të tjera.
- Për sa i përket kualifikimeve arsimore, përqindja më e madhe e pjesëmarrësve (39,4%) kishin përfunduar arsimin e mesëm; 27,1% kishin përfunduar arsimin fillor; 17,3% kishin përfunduar arsimin të lartë; 8,2% kishin diploma ose certifikata të formimit profesional; 5,7% nuk kishin përfunduar arsimin fillor; dhe 1,6% kishin kryer studime pasuniversitare.
- Pothuaj dy ndër pesë pjesëmarrës thanë se ishin në marrëdhënie pune, nga të cilët 21% u deklaruan si të vetëpunësuar, 12,3% punonin në sektorin privat dhe 6,4% në sektorin publik. Pjesa tjetër e popullatës së anketuar në këtë studim ishte e papunë, por në kërkim të një vendi pune (25,8%); ekonomikisht jo-aktive, sepse nuk ishin në kërkim aktiv të një vendi pune (23,7%); ose gra shtëpiake (10,2%).
- Pjesa më e madhe e personave të anketuar ishin të martuar/a (75,6%), ndërsa më pak se një ndër gjashtë persona (15,6%) ishin beqarë/e, 5,4% ishin të ve/veja, 2,1% të divorcuar/a dhe 1% në marrëdhënie bashkëjetese.
- Shumica e të anketuarve në studim (59,6%) nuk kishin fëmijë, 20% kishin një fëmijë, 15,8% kishin dy fëmijë, dhe vetëm 3,2% kishin tre ose më shumë fëmijë.
- Më shumë se një ndër dhjetë personat e intervistuar përfitonin ndihma nga shteti, nga të cilët 6,5% përfitonin ndihmë ekonomike dhe 4% merrnin pagesa të aftësisë së kufizuar.

82. Shih, për shembull, J. Moore, L. Stinson dhe E. Welniak, 'Income Measurement Error in Surveys: A Review' (Gabimi në matjen e të ardhurave në anketa: Rishikim), <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.39.6539&rep=rep1&type=pdf>, parë për herë të fundit më 25 korrik 2017.

## METODAT CILËSORE

Përveç anketimit, studimi mbledhi një numër të dhënash edhe me anë të përdorimit të metodave cilësore. Instrumentet kryesore të përdorura për këtë ishin skenarët e grupeve të fokusit dhe pyetësi i përdorur në intervistat gjysmë të strukturuar. Të dyja këto kishin si qëllim të hetonin në thellësi qëndrimet dhe njohuritë e të anketuarve për ligjin, si dhe përvojat e tyre me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Në grupin e personave të intervistuar u përfshinë të anketuar nga grupet e pafavorizuara, si personat LGBT, viktimat e dhunës në familje, e të tjerë. Përveç kësaj, u kryen intervista me ofrues të shërbimeve të drejtësisë si avokatë dhe gjyqtarë, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe të Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut.

## Përbërja e kampionit në komponentin cilësor të studimit

- Në grupet e fokusit, që u zhvilluan në periudhën midis muajve mars dhe maj 2017, morën pjesë gjithsej 55 individë.
- Si pjesë e punës kërkimore për studimin, gjatë së njëjtës periudhë u intervistuan edhe 32 persona të tjerë.
- Pjesëmarrësit në grupet e fokusit dhe personat e intervistuar ishin nga radhët e grupeve të pafavorizuara, si persona me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje, fëmijë në institucione rezidenciale, të mitur në konflikt me ligjin, anëtarë të komunitetit rom, dhe anëtarë të komunitetit LGBT. Po kështu u intervistuan edhe individë nga radhët e ofruesve të shërbimeve, si ofrues të shërbimeve ligjore, OJQ që ofrojnë ndihmë dhe mbrojnë të drejtat e viktimave të shkeljeve të të drejtave të njeriut, punonjës të shërbimit social, kryetarë gjykatash, personeli i institucioneve rezidenciale për fëmijë, si dhe zyrtarë nga institucionet e Avokatit të Popullit dhe të Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi.
- Intervistat me pjesëmarrësit u zhvilluan kryesisht në Tiranë, ku kanë selinë edhe shumë prej ofruesve të shërbimeve të përmendura më lart. Përveç këtyre, intervista u zhvilluan edhe me pjesëmarrës në Shkodër, Vlorë, dhe në zona rurale.

Përmes kombinimit të metodave sasore dhe cilësore të mbledhjes së të dhënave, metodologjia e përshkruar më lart ndihmoi për të krijuar një tablo gjithëpërfshirëse të pengesave me të cilat përballet popullata shqiptare për të pasur akses në drejtësi. Po kështu, ajo përcakton më qartë edhe sfidat me të cilat përballet shteti shqiptar dhe gjyqësori lidhur me ofrimin e aksesit në drejtësi dhe mjetet juridike në dispozicion të qytetarëve.



